

FALENDERIME

Ky studim u realizua si një nismë e përbashkët e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, e UNICEF-it, Shqipëri dhe e shoqërisë civile.

Falenderime të veçanta për grupin e ekspertëve të udhëhequr nga Mirela Muça dhe të përbërë nga Irena Mitro, Gladiola Musabelliu, Irena Qorlaze, Miranda Pashaj dhe Arda Lazareni.

Falenderime dhe për përfaqësuesit e administratës publike dhe të shoqërisë civile pa angazhimin dhe kontributin e të cilëve nuk do të ishte i mundur realizimi i këtij raporti vlerësimi për Strategjinë Kombëtare të Fëmijëve dhe Planit të Veprimit.

Së fundi, falenderime të veçanta për mbështetjen e vlefshme të siguruar nga Arlinda Ymeraj, përgjegjëse për politikën sociale në UNICEF, e cila mundësoi realizimin e këtij projekti.

PËRMBAJTJA

Falenderime.....	1
Lista e shkurtimeve.....	3
Lista e tabelave.....	4
Hyrje.....	5
Qëllimet e vlerësimit dhe metodologjia.....	7
Kapitulli I: Kuadri ligjor i të drejtave të fëmijëve.....	10
Kapitulli II: E drejta e mbrojtjes shoqërore.....	21
Kapitulli III: E drejta për arsim cilësor.....	40
Kapitulli IV: E drejta e mbijetesës dhe e kujdesit shëndetësor.....	53
Kapitulli V: E drejta e fëmijëve për pjesëmarrje.....	63
Vlerësime përfundimtare	71
Konkluzione	73
Shtojca 1.....	75
Shtojca 2.....	77
Shtojca 3.....	84

LISTA E SHKURTIMEVE

AKF	E Ardhura Kombëtare për Frymë
ADHS	Studim Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri
BB	Banka Botërore
DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale
DNA	Dispozitat Normative Arsimore
EDNJ	Edukata e të Drejtave të Njeriut
IEVP	Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale
IKT	Instituti i Kurrikulës dhe Trajnimeve
INSTAT	Instituti i Statistikave
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijëve
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MPÇSSHB	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
MSH	Ministria e Shëndetësisë
NJDF	Njësia për të Drejtat e Fëmijëve
NJMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
PAK	Persona me Aftësi të Kufizuar
PNUD	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
QN	Qeveria e Nxënësve
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
SKF	Strategjia Kombëtare për Fëmijët
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SPSHS	Standardet e Përgjithshme të Shërbimeve Sociale
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VSMJ	Vlerësim për Matjen e Nivelit të Jetesës
ZA	Zyrat Arsimore

LISTA E TABELAVE

<i>Tabela 2.1:</i>	Numri i personave me aftësi të kufizuar dhe i kujdestarëve të tyre që kanë përfituar pagesa në para gjatë periudhës 2006-2009.....	19
<i>Tabela 2.2:</i>	Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuar që kanë përfituar pagesa në para gjatë periudhës 2006-2009.....	20
<i>Tabela 2.3:</i>	Numri i fëmijëve në institucionet publike gjatë periudhës 2006-2009.....	21
<i>Tabela 2.4:</i>	Numri i fëmijëve në institucionet jo publike gjatë periudhës 2006-2009.....	21
<i>Tabela 2.5:</i>	Numri i përfituesve për kategorinë fëmijë dhe të rinj në rrezik dhe mbulimi me shërbime.....	25
<i>Tabela 2.6:</i>	Numri i fëmijëve përfitues të shërbimeve komunitare nga projekti i SHSSH.....	27
<i>Tabela 2.7:</i>	Fëmijë të identifikuar në rrezik.....	30
<i>Tabela 2.8:</i>	Ndryshimi i varfërisë absolute te gratë dhe fëmijët sipas shpërndarjes gjeografike.....	33
<i>Tabela 2.9:</i>	Të mitur të dëmtuar nga dhuna në familje, viti 2008.....	34
<i>Tabela 2.10:</i>	Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuar në institucionet jo-publike...	40
<i>Tabela 2.11:</i>	Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuar në institucionet publike	40
<i>Tabela 2.12:</i>	Fondet e akorduara të ndihmës ekonomike për familjet gjatë periudhës 2006-2009.....	41
<i>Tabela 2.13:</i>	Buxheti i akorduar në institucionet e përkujdesit publik për fëmijë dhe qendrat e zhvillimit (periudha 2005-2009).....	41
<i>Tabela 2.14:</i>	Shpenzimet publike për realizimin e të drejtës për kujdes të veçantë të fëmijëve të familjeve të varfëra, 2006-2008.....	41
<i>Tabela 3.1:</i>	Buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për periudhën 2004-2009.....	46
<i>Tabela 4.1:</i>	Buxheti për kujdesin shëndetësor parësor dhe atë spitalor, për vitet 2007–2008.....	60

HYRJE

Shqipëria, me një popullsi prej 3.1¹ milion banorë, është një nga vendet me popullsinë më të re në Europë (mosha mesatare e popullsisë është 32.2 vjeç, ndërsa numri i fëmijëve 0-19 vjeç është 1,091,509²). Prej vitit 1991, Shqipëria ka përjetuar një tranzicion të shpejtë dhe të thellë. Reformat makroekonomike kanë kontribuar në arritjen e një rritje ekonomike relativisht të qëndrueshme, reduktimin e varfërisë si edhe mbajtjen nën kontroll të inflacionit (3-6 përqind)³. Rritja ekonomike vjetore llogaritet rreth 6 % prej vitit 1998, ndërsa niveli i varfërisë është zvogëluar rreth 7 % gjatë tre viteve të fundit. Të ardhurat mesatare vjetore janë rritur nga \$1,390 në 2002 në \$2,930 në 2008⁴ (AKF), megjithatë Shqipëria mbetet një nga vendet me të ardhura më të ulta për frymë në Europë.

Shqipëria ka patur dhe vazhdon të ketë një angazhim të përhershëm, përta i përket përmirësimit të vazhdueshëm të standarteve, lidhur me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Shprehje e qartë e angazhimit të Shqipërisë është ratifikimi apo aderimi në pothuaj të gjitha konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës. Gjithashtu, Shqipëria ka aderuar në dy protokollat opsionale të Konventës për të Drejtat e Fëmijës: Protokollin Opsional “Mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë” (miratuar me Ligjin Nr.9834, datë 22.11.2007); Protokollin Opsional “Mbi përfshirjen e fëmijëve në konfliktet e armatosura (miratuar me Ligjin Nr.9833, datë 21.12.2007).

Shqipëria u pranua në Aleancën e Atlantikut Verior në Prill të vitit 2009. Në prill të të njëjtit vit, Shqipëria paraqiti, kërkesën e anëtarësimit në Bashkimin Europian. Qeveria Shqiptare, institucionet ligjvënëse, ekzekutive si edhe shoqëria civile, po përpiqen që të plotësojnë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga nënshkrimi i marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim. Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, (i miratuar me VKM nr. 463, datë 5.07.2006, ndryshuar me VKM nr.577, datë 5.09.2007 dhe VKM nr.1317, datë 1.10.2008) konsideron si pjesë të rëndësishme ndërmarrjen e reformave ligjore, institucionale, reformën në sistemin e drejtësisë për garantimin dhe realizimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit, sipas standarteve ndërkombëtare. Ky dokument përcakton dhe prioritetet e politikës së Qeverisë Shqiptare, lidhur me respektimin e të drejtave të të njeriut (përfshirë edhe të drejtat e fëmijës).

Si rezultat i zgjedhjeve parlamentare të qershorit 2009, koalicioni i ri qeveritar, paraqiti në Parlament programin e ri të punës, në të cilin ri-konfirmohet prioriteti strategjik i integritetit në Bashkimin Europian. Në programin e ri të qeverisë, të drejtat e fëmijëve trajtohen si një objektivi i rëndësishëm së veçantë, gjë e cila shprehet në thellimin e reformës

¹ INSTAT, Vjetari Statistikor, 2008

² INSTAT, Vlerësim, Burimi: Treguesit e Zhvillimit Botëror

³ Banka Qendrore e Shqipërisë, Raporti Vjetor 2004-2008

⁴ Vlerësim i Bankës Botërore, Burimi: <http://devdata.eorlbank.org>

legjislative dhe institucionale, për të krijuar një mjedis mbrojtës dhe gjithëpërfshirës për fëmijët, duke përfshirë mjedisin familiar, institucionet dhe shoqërinë.

Qeveria e vlerëson rëndësinë e orientimit të politikave të të drejtave të fëmijëve rreth përfshirjes sociale. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, që është dhe strategjia e fundit qeveritare, adapton një metodologji të re dhe gjithëpërfshirëse për të adresuar çështjet më kritike të kategorive të përjashtuara, përfshirë fëmijët. Gjithashtu është aprovuar një Strategji Kombëtare për Përfshirjen Sociale si dhe është adaptuar një Strategji Kombëtare dhe një Plan Veprimi për fëmijët. Po diskutohet një ligj mbi të drejtat e fëmijëve. Strategjia e re për ofrimin e shërbimeve sociale parashikon zgjerimin dhe krijimin e shërbimeve të përkujdesit social komunitar të integruara në kontekstin e strategjisë së decentralizimit. Qeveria është e përkushtuar të integrojë programin për arritjen e Objektivave të Mijëvjeçarit dhe Strategjinë për Zhvillim dhe Integrim në procesin e Marrëveshjes për Stabilizim e Asocim, e cila është nënshkruar më 12 qershor 2006.

QËLLIMET E VLERËSIMIT DHE METODOLOGJIA

Objektivat

Projekti “Vlerësimi i zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët dhe Planit Kombëtar të Veprimit për periudhën 2005-2010” synon të:

- a) analizojë nivelin e realizimit të SKF nëpërmjet matjes dhe vlerësimit të treguesve të përzgjedhur nga sektorët më të rëndësishëm me qëllim që të sigurohet një pasqyrë e situatës reale të zbatimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri;
- b) identifikojë çështjet më kritike në përmbajtjen e PKV si edhe në zbatimin e tij, me qëllim hartimin e rekomandimeve për përmirësime në politikat që lidhen me të drejtat e fëmijëve në të ardhmen;
- c) hartojë një raport i cili të përmbajë edhe propozimet për drejtimet në të cilat nevojitet mbështetje institucionale apo financiare, nga qeveria apo shoqëria civile.

Procedura dhe pjesëmarrësit e këtij studimi

Për zbatimin e këtij projekti u krijua një grup pune. Grupi i punës organizoi takime dhe diskutime me specialistë të institucioneve publike, përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave të kujdesit shëndetësor, arsimor dhe të mbrojtjes sociale. Gjithashtu, në këto takime morën pjesë aktive përfaqësues të shoqërisë civile, të institucioneve akademike si dhe të donatorëve të ndryshëm të cilët diskutuan dhe komentuan për të gjitha çështjet e paraqitura.

Grupi i punës përgatiti dy pyetësor. Pyetësori i parë për punonjësit e administratës publike përbëhej nga pesë seksione, konkretisht:

Seksioni I: Ndikimi i strategjisë në lidhje me realizimin e të drejtës për mbrojtjen shoqërore.

Seksioni II: E drejta për kujdes shëndetësor.

Seksioni III: E drejta për arsim cilësor.

Seksioni IV: E drejta e fëmijëve për pjesëmarrje.


Seksioni V: E drejta për mbrojtje ligjore.

Ndërsa pyetësori i dytë për përfaqësuesit e shoqërisë civile synoi në mbledhjen e një informacioni cilësor në lidhje me angazhimin e tyre në zbatimin e SKF.

Grupi i punës hartoi një listë pyetjesh dhe treguesish, të cilët do të mundësonin vlerësimin e nivelit të zbatimit të objektivave të strategjisë si edhe planit të veprimit. Lista e treguesve u diskutua gjerësisht në takimet e organizuara dhe pasi u miratua në parim u përfshi në këtë dokument. Informacioni që rezultoi pas analizës së të dhënave u përdor për analizën e nivelit të zbatimit të treguesve të përzgjedhur për plotësimin e tabelave.

Intervistat zgjatën nga 40 deri në 65 minuta dhe gjatë intervistimit u mbajtën shënime. Procesi i intervistimit zgjati për rreth dy muaj (nëntor–dhjetor 2009).

Pjesëmarrësit e këtij studimi ishin punonjës të administratës publike dhe përfaqësues të shoqërisë civile në disa prej qarqeve kryesore të Shqipërisë si Tirana, Shkodra, Durrësi, Kukësi dhe Elbasani. Për pyetëtorin e parë u intervistuan 23 punonjës të administratës publike, ndërsa për të dytin u intervistuan 11 përfaqësues të shoqërisë civile (shtojca 1). Në hartën e mëposhtme paraqitet numri i të intervistuarve si dhe shpërndarja e tyre sipas qarqeve përkatëse⁵.



⁵ *Shënim:* Numri i parë i referohet personave të intervistuar që janë punonjës të administratës publike ndërsa numri i dytë i referohet të intervistuarve që janë përfaqësues të shoqërisë civile. Gjithsej janë intervistuar 34 persona nga të cilët 23 janë punonjës të administratës publike dhe 11 janë përfaqësues të shoqërisë civile.

Përzgjedhja e këtyre qarqeve u bë duke marrë në konsideratë faktin nëse ekzistonin apo jo struktura për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Kështu në qarkun e Kukësit ekzistonte njësi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve ndërsa në Elbasan dhe Shkodër këto njësi ishin duke u krijuar. Gjithashtu në katër nga këto qarqe ishin ngritur observatorët për të drejtat e fëmijëve (struktura të shoqërisë civile) ndërsa në Tiranë planifikohej të ngrihej një e tillë në 2010.

Raporti i përgatitur si përmbledhje e rezultateve të analizave sipas metodologjisë të paraqitur më lart, nuk është një përsëritje e raporteve të paraqitura më parë apo përsëritje e raportit të ecurisë së strategjisë. Ky raport konsideron si një kontribut autentik dhe të një rëndësie të veçantë, hartimin e listës së treguesve të cilët mund të përdoren për vlerësimin e arritjeve në zbatimin e objektivave të strategjisë. Në raport analizohen vetëm ato të drejta, të cilat janë pjesë e strategjisë dhe planit të veprimit për fëmijë. Dokumenti përbëhet nga pesë kapituj si edhe nga hyrja dhe përmbledhja.

Në kapitullin e parë analizohet në mënyrë të përmbledhur kuadri ligjor i të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, si edhe përshkruhen mekanizmat institucionalë që vëzhgojnë dhe raportojnë mbi realizimin e të drejtave të fëmijëve.

Kapitulli i dytë, i tretë, i katërt dhe i pestë janë organizuar sipas të njëjtës strukturë. Pjesa e parë e secilit kapitull sjell informacion mbi nivelin e respektimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Pjesa e dytë e kapitujve i është kushtuar përshkrimit të nivelit të realizimit të secilit objektiv, nëpërmjet analizës së aktiviteteve të përshkuara në planin e veprimit duke përdorur sistemin e treguesve sasiorë dhe cilësorë të hartuar për këtë raport. Pjesa e tretë e këtyre kapitujve përfundon me identifikimin e disa çështjeve kritike që lidhen me zbatimin e të drejtës respektive në kuadrin e strategjisë dhe në raport me konventën për të drejtat e fëmijëve. Pjesa e fundit e secilit kapitull i kushtohet dhënies së rekomandimeve, të cilat nëse do të merren në konsideratë nga institucionet që hartojnë politika, do të krijojnë kushte më të përshtatshme për zbatimin e strategjisë dhe përafrimin e saj me konventën për të drejtat e fëmijëve.

KAPITULLI I: KUADRI LIGJOR I TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

1.1 Ndryshime në kuadrin ligjor qershor 2008 - maj 2009

Gjatë procesit të përmirësimit dhe përditësimit të politikave sociale në mbështetje të të drejtave të fëmijëve legjislacioni është një mënyrë efikase për të sjellë ndryshime thelbësore në realizimin e këtyre të drejtave në përputhje me parimet e të drejtave ndërkombëtare në përgjithësi dhe të drejtave të fëmijëve në veçanti. Gjatë periudhës qershor 2008 - maj 2009 janë miratuar një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore, të cilat synojnë respektimin e të drejtave të fëmijëve ku mund të përmendim:

Ligji Nr. 10 138, datë 11.05.2009, “Për Shëndetin Publik” është një ligj kuadër në fushën e shëndetit publik që ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe promovimin e jetesës së shëndetshme të popullatës. Në këtë ligj janë përcaktuar shërbimet bazë të shëndetit publik që garantohen nga shteti ku bën pjesë shëndeti riprodhues dhe shëndeti i nënës dhe fëmijës.

Ligji Nr. 10 071, datë 09.02.2009, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”. Ky ligj synon: (i) të parandalojë dhe të luftojë shfrytëzimin seksual dhe abuzimin seksual të fëmijëve; (ii) të mbrojë të drejtat e fëmijëve viktimat të shfrytëzimit seksual dhe të abuzimit seksual; (iii) të promovojë bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar kundër shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve.

Ligji Nr. 10 060, datë 26.01.2009, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8432, datë 14.12.1998”, “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”, në dispozitën e përkufizimeve jepet termi “të mitur të pashoqëruar”⁶.

Ligji Nr. 10 039, datë 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”, përcakton kushtet, llojin, mënyrën dhe procedurat për dhënien e ndihmës juridike nga shteti, për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të individit, si dhe të interesave të tjera të ligjshme të tij. Në këtë ligj është parashikuar dhënia e ndihmës juridike të miturve në konflikt me ligjin.

Ligji Nr. 10 024, datë 27.11.2008, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8331, datë 21.4.1998”, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, përcaktohet mekanizmi konkret i zbatimit të dënimeve alternative dhe raporteve që ai krijon me institucionet shtetërore dhe me gjykatën.

⁶ “Të mitur të pashoqëruar” janë shtetasit e huaj apo personat pa shtetësi nën 18 vjeç, të cilët vijnë në territorin e Republikës së Shqipërisë të pashoqëruar nga një person madhor përgjegjës për ta, sipas ligjit ose sipas traditës dhe për sa kohë ata nuk janë efektivisht nën kujdesin e një personi të tillë. Këtu përfshihen edhe të miturit, të cilët janë lënë të pashoqëruar, pasi kanë hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ligji Nr. 10 023, datë 27.11.2008, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995”, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”. Në Nenin 63 të Kodit Penal për punën në interes publik parashikohet pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik, të cilën e vendos për shkak të rrezikshmërisë së paketë të personit dhe të rrethanave të kryerjes së veprës penale. Në rastet kur është caktuar një dënim gjër në një vit burgim, mund të vendoset pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimi e tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik.

Ligji Nr. 9952, datë 14.07.2008, “Për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it”. Nëpërmjet këtij ligji synohet të mbrohen më mirë të prekurit nga këto sëmundje, por njëkohësisht të merren masa dhe hartohen politika për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it. Ligji flet për parandalimin e kontrollit të transmetimit të HIV/AIDS nga nëna tek fëmija dhe thekson detyrimin e institucioneve arsimore publike dhe private për arsimimin e nxënësit/studentit me HIV/AIDS. Ligji gjithashtu përcakton se personat nën 18 vjeç të infektuar me HIV/AIDS, përfitojnë ndihmë shoqërore në të holla, ose shërbime. Për fëmijët e infektuar me HIV/AIDS të cilët janë të braktisur dhe ata që kanë humbur lidhjet me familjet e tyre ose aftësinë për të punuar, merren në përkujdesje nga institucionet e shërbimeve sociale shtetërore (institucionet rezidenciale të përkujdesjes sociale) ose private.

Ligji Nr. 9942, datë 26.06.2008, “Për parandalimin e çrregullimeve nga pamjaftueshmëria jodike në organizmin e njeriut” Ky ligj ka për qëllim parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut, nëpërmjet jodizimit të përgjithshëm të kripës, të destinuar për konsum njerëzor e shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore.

Ligji Nr. 9928, datë 09.06.2008, “Për shërbimin shëndetësor stomatologjik”. Sipas këtij ligji: Në institucionet e shërbimit shëndetësor stomatologjik publik ofrohet falas shërbimi profilaktik dhe mjekues stomatologjik për: (i) personat nga mosha 0 deri 18 vjeç; (ii) të sëmurët e shtruar dhe ata që trajtohen në institucione spitalore publike, për mjekime urgjence; (iii) kategori të veçanta individësh që, me ligje dhe akte nënligjore të veçanta, përfitojnë shërbim shëndetësor stomatologjik falas.

Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Islandës, “Për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar” (ratifikuar me Ligjin Nr. 10015, datë 06.11.2008). Në bazë të kësaj marrëveshje, RSH-së do të ripranojë fëmijët e mitur dhe të pamartuar, pavarësisht vendlindjes ose kombësisë, nëse nuk kanë lejeqëndrimi të pavarur në Islandë.

Memorandumi i Bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për arsimimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale sipas programeve mësimore të miratuara nga MASH. Procesi mësimor do të realizohet me kohë të plotë ose të pjesshme në një ambient të veçantë të përshtatur për dhënie mësimi pranë IEVP-ve. Në këtë memorandum bashkëpunimi përcaktohet se me mbarimin e klasës apo shkollës i dënuari

përfiton dokumentin përkatës, i cili është i njëvlefshëm me ato të përfitur nga shkolla e të njëjtit nivel jashtë institucionit. Dokumenti i lëshuar nuk tregon statusin e personit si i dënuar.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 499, datë 06.05.2009, për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 384, datë 20.05.1996, “Për mbrojtjen e të miturve në punë” (i ndryshuar) parashikon kontrollin mjekësor për punëmarrësit nën moshën 18 vjeç.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 303, datë 25.03.2009, për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, e cila përcakton mënyrën e realizimit të drejtave dhe detyrimeve të burgosurve, qofshin të dënuar me burgim apo të paraburgosur, organizimin e jetës së tyre, mënyrën dhe kushtet e ekzekutimit të vendimeve penale me burgim, zhvillimin e aktivitetit të punës dhe shpërblimin për punën e kryer, si dhe mënyrën e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Rregullorja përcakton masa dhe rregulla të veçanta për realizimin e të drejtave dhe detyrimeve të të dënuarve të mitur, të cilët vuajnë kryerjen e dënimit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1205, datë 27.08.2008, për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës Ndërkombëtare të Punës, përfaqësuar nga Zyra Ndërkombëtare e Punës, “Për eliminimin e punës së fëmijëve”.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1104, datë 30.07.2008, për disa shtesa në VKM Nr. 80, datë 28.01.2008 “Për miratimin e strategjisë sektoriale të mbrojtjes sociale dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”, parashikon mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve jetimë, nëpërmjet përcaktimit të kriterëve të familjes kujdestare (Dokumenti i politikave për shërbimin e kujdestarisë).

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1083, datë 23.07.2008, “Për miratimin e strategjisë kombëtare të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, 2008-2010”, si dhe të dokumentit plotësues “Strategjia kombëtare për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, viktima të trafikimit” parashikon masat për bashkëpunimin, bashkërendimin mes të gjithë aktorëve, rolet dhe përgjegjësitë e tyre përkatëse, për të arritur në një qasje efikase, të harmonizuar kundër këtij fenomeni.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 786, datë 04.06.2008, “Për miratimin e Rregullores së Disiplinës së Policisë së Shtetit”, i cili parashikon detyrimin dhe normat e sjelljes gjatë detyrës/shërbimit, të punonjësit të policisë për trajtimin e veçantë të të miturve.

Urdhër i Ministrit të Drejtësisë Nr. 4763, datë 08.06.2009, “Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Komitetit Shqiptar të Birësimeve”, i cili parashikon rregulla mbi funksionimin dhe organizimin e brendshëm të Komitetit, në lidhje me mbarëvajtjen e zhvillimit të procedurave të birësimit.

Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë Nr. 981, datë 31.10.2008, për masat që do të merren nga Policia e Shtetit për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje, trajtimin e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare.

Aktualisht, pas konsultimit me të gjithë aktorët e interesit, është në proces shqyrtimi nga instancat përkatëse projekt-ligji kuadër për të drejtat e fëmijëve. Ky ligj parashikon ri-dimensionimin e strukturës administrative në nivel qendror, rajonal dhe lokal. Gjithashtu ky ligj do të reflektojë më mirë parimet, të drejtat dhe masat mbrojtëse si dhe është një transpozim i Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

1.2 Strategjia Kombëtare për Fëmijët dhe dimensionimi ndërsektorial i politikave sociale

Të drejtat e fëmijëve, përveçse në kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar duhen përfytyruar dhe realizuar si pjesë e platformave strategjike dhe dokumenteve të cilat kanë në qendër përfshirjen sociale në shoqëri. Vlen për t'u përmendur që Sekretariati Teknik për Fëmijët pranë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka një bashkëpunim të frytshëm me Sekretariatit Teknik për Romët, Sekretariatit Teknik për Personat me Aftësi të Kufizuar (PAK) si dhe me Sektorin e Analizës dhe Monitorimit të Varfërisë, sektorë monitorues të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për Strategjitë Ndërsektoriale përkatëse. Këta sektorë kanë për detyrë koordinimin dhe monitorimin e strategjive si dhe detajimin e objektivave për aktorë të ndryshëm në nivel qendror e vendor.

Informacioni i mbledhur nga monitorimi i strategjive të sipërpërmendura shërben për përgatitjen e analizave dhe raporteve të cilat shërbejnë për hartimin të politikave sa më efektive. Këta sektorë gjithashtu mbështesin dhe këshillojnë kombëtarë e grupet përkatëse të punës në përputhje me nevojat aktuale në fushat përkatëse.

Strategjia Kombëtare për Fëmijë është pjesë integrale e Strategjinë Ndërsektoriale për përfshirjen sociale (2007-2013). Përfshirja sociale është në fokusin kësaj strategjie e cila bashkërendon objektivat e saj me ato të SKZHI-së.

Pjesë e “Strategjisë së mbrojtjes sociale dhe planit të saj të veprimit” (2008-2013), VKM Nr. 80, datë 28.01.2008 janë dhe një sërë treguesish që shërbejnë për të vlerësuar politikën e mbrojtjes sociale. Strategjia parashikon politikën në mbrojtje të grupeve në nevojë dhe veçanërisht ndalet tek fëmijët jashtë kujdesit prindëror dhe ata me aftësi të kufizuar. Reformimi i sistemit të mbrojtjes sociale ka një ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien sociale të fëmijës.

Më tej, Strategjia Kombëtare për personat me aftësi të kufizuar dhe Plani i saj i Veprimit (VKM Nr. 8, datë 7.01.2005) parashikon masa të veçanta për fëmijët me aftësi të kufizuar në lidhje me shprehjen e mendimit, arsimin, shërbimin shëndetësor dhe argëtimin.

Megjithatë është e nevojshme që kjo strategji të ndalen veçanërisht në abuzimin, dhunën, neglizhimin apo shfrytëzimin duke përfshirë kështu edhe parimet e KDF-së.

Strategjia Kombëtare kundër trafikimit të qenieve njerëzore (2008-2010) si dhe dokumenti plotësues i Strategjisë Kombëtare kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjes së fëmijëve viktime të trafikimit (VKM Nr. 1083, datë 23.07.2008), synojnë në eliminimin e plotë të trafikimit dhe marim në konsideratë gjithashtu rritjen e mundësive për arsimim, përfshirjen, regjistrimin në gjendjen civile, eliminimin e punës së fëmijëve si dhe ndërtimin e rrjeteve në luftën kundër shfrytëzimit.

Plani Kombëtar për Dekadën Rome synon realizimin e të drejtës për arsim cilësor të fëmijëve rom. Në këtë plan objektivat janë tepër të detajuara dhe mund të përmëndim:

- (i) garantimi i të drejtës së fëmijëve dhe të rinjve të minoritetit rom për akses të barabartë në të gjitha nivelet e sistemit arsimor;
- (ii) eliminimi i qëndrimeve përjashtuese dhe inferiore ndaj romëve në komunitetin shkollor dhe transformimi i diversitetit kulturor në një burim njohurish dhe atmosfere të respektit reciprok, tolerancës dhe mirëkuptimit;
- (iii) ruajtja dhe zhvillimi i identitetit kulturor të nxënësve dhe studentëve të minoritetit rom.

Në këtë plan, të drejtat e fëmijëve janë të përfshira dhe në fusha të tjera prioritare, si ajo e punësimit, mbrojtjes sociale, shëndetit etj.

Politikat për Arsimin dhe Shëndetësinë (të reflektuara dhe në Strategjinë Kombëtare për Fëmijët) gjithashtu ofrojnë një sërë objektivash të lidhura me fëmijët të cilat janë udhërrëfyese në punën e institucioneve qendrore dhe atyre të varësisë si dhe bashkërendohen me arritjet e shoqërisë civile. Në fushën e arsimit këto objektivat synojnë sigurimin e një sistemi arsimor cilësor, futjen në programet shkollorë të të drejtave të fëmijës, përfshirjen e fëmijëve në vendimmarrje etj.. Në fushën e shëndetit, me anë të akteve të ndryshme ligjore, ato synojnë përmirësimin e shëndetit të nënës dhe fëmijës, përmirësimin dhe ndjekjen e shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve, fuqizimin e shërbimit publik dentar si dhe zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare të HIV/AIDS.

Së fundmi, në SKZHI, gjen shprehje vizioni kombëtar për zhvillimin në linjën e proceseve integruese me një sistem koordinimi të treguesve të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale. Një vend të veçantë në SKZHI zë dhe Strategjia Kombëtare për fëmijët.

Strategjia Kombëtare për Fëmijët mbulon të gjitha aspektet e jetës së fëmijës, duke i kushtuar vëmendje të veçantë uljes së varfërisë. Përveç reformës në lidhje me shërbimet për fëmijët, gjithashtu mund të përmendim dhe masat e tjera të cilat synojnë:

- Në fushën e drejtësisë: ndarjen e të miturve nga të rriturit gjatë trajtimit të çështjeve penale si dhe procedura apo kushte të përmirësuara për të miturit në burgjet për fëmijët; përdorimin e gjerë të punonjësve socialë; shërbime të piketuara që ofrohen nga gjykatat dhe ngritjen e Institutit të Riedukimit të të Miturve;
- Në fushën e shëndetësisë: menaxhimin e integruar të pacientit, ku përfshihen ekzaminimi, trajtimi dhe këshillimi për sëmundjet kryesore të fëmijërisë;
- Në fushën e arsimit: ngritjen e njësive shumë profesionale në nivelin e pushtetit lokal, të cilat do të trajtojnë problemet e ndryshme që pengojnë integrimin dhe zhvillimin e barazisë tek fëmijët, zbatimin e arsimit të detyrueshëm dhe krijimin e mundësive për formimin profesional, që parandalojnë punën e fëmijëve; si dhe
- ngritjen e strukturave në nivel vendor për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

1.3 Institucionet që monitorojnë të drejtat e fëmijëve

Komiteti Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijëve⁷: autoriteti më i lartë që vëzhgon zbatimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët dhe që garanton përfshirjen e politikave për respektimin e të drejtave të fëmijëve në politikat e zhvillimit.

Sekretariati Teknik për Fëmijët (STF)⁸, strukturë në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Misioni i STF është monitorimi dhe vlerësimi lidhur me ecurinë dhe çështjet kritike të vërejtura në respektimin e të drejtave të fëmijëve në përgjithësi dhe të drejtave të fëmijëve në nevojë në veçanti si dhe raportimi e informimi i strukturave shtetërore dhe opinionit publik.

Duke filluar nga dhjetori i vitit 2006, STF ka hartuar disa raporte vjetore dhe 6 mujore. Në to analizohet dhe vlerësohet ecuria për zbatimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët. Në qershor 2008, STF hartoi Raportin Vjetor për zbatimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët për periudhën qershor 2007-maj 2008, ndërsa në muajin shkurt 2008, STF hartoi raportin periodik 6 mujor qershor 2008 – dhjetor 2008. Raporti vjetor qershor 2007 – maj 2008 fillimisht u prezantua në Konferencën Vjetore të të Drejtave të Fëmijëve, e cila u mbajt më 1 qershor 2008. Në konferencë u nxitën rolet e strukturave monitoruese të strategjisë siç janë Komiteti Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijëve dhe Sekretariatit Teknik për Fëmijët. Gjithashtu

⁷ Ngritur me Urdhër të Kryeministrit, Nr. 24 datë 21.03.2007,

⁸ Ngritur me Urdhër të Kryeministrit, në nëntor 2006

në këtë konferencë u theksuan arritjet dhe problemet e vërejtura në realizimin e objektivave të strategjisë për periudhën 2007-2008 si dhe u dhanë rekomandime për përmirësime të mëtejshme të punës së institucioneve përgjegjëse për zbatimin e saj. Pas marrjes së rekomandimeve të fundit nga konferenca, raporti u botua dhe u shpërnda në të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e strategjisë në nivel qendror dhe vendor, në 12 prefektura, në 12 qarqe dhe 63 bashki e komuna.

Gjatë periudhës qershor 2008 – maj 2009, përveç detyrave të tij funksionale, Sekretariati Teknik për Fëmijët ka punuar për ngritjen e njësive të reja për të drejtat e fëmijëve në nivel qarku e bashkie, ka bashkëpunuar për hartimin e protokollit të punës të njësive për mbrojtjen e fëmijëve në nivel bashkie dhe ka mbështetur aktivitete dhe fushata sensibilizuese për të drejtat e fëmijëve.

Në Strategjinë Kombëtare për Fëmijët, theksohet se duhet të ngrihet mekanizmi institucional për monitorimin e realizimit dhe efektivitetin e politikave kombëtare dhe rajonale për realizimin e të drejtave të fëmijëve. Ky proces tashmë ka përfunduar në nivel qendror me ngritjen e Komitetit Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijëve dhe Sekretariatit Teknik për Fëmijët. Në bashkëpunim me pushtetin vendor dhe me mbështetjen e donatorëve të ndryshëm, në disa bashki dhe qarqe janë ngritur njësitë e të drejtave të fëmijëve, njësitë për mbrojtjen e fëmijëve dhe së fundmi edhe observatorët për të drejtat e fëmijëve duke synuar që dalëngadalë të plotësohet kuadri i plotë i mekanizmit institucional.

Njësia për të Drejtat e Fëmijëve (NJDF) është ngritur brenda strukturës administrative të qarkut dhe ka për detyrë të vëzhgojë situatën dhe të vlerësojë mënyrën e zbatimit të politikave për të drejtat e fëmijëve në nivel rajonal. Këto njësi funksionojnë në qarqet e Kukësit, Korçës dhe Elbasanit.

Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF) është ngritur brenda strukturës administrative të shërbimeve sociale në bashki. Ajo ka për detyrë të identifikojë, vlerësojë rastet e fëmijëve në nevojë dhe të koordinojë aktivitetet për mbrojtjen e fëmijës.

Observatori për të Drejtat e Fëmijës është strukturë e shoqërisë civile e cila synon të ngrejë mekanizmat për mbledhjen e informacionit dhe studimin e situatës së realizimit të drejtave të fëmijëve në nivel rajonal. Ato mbledhin informacion nga të gjitha institucionet shtetërore rajonale dhe që njëkohësisht ndihmojnë këto institucione me të dhëna të mbledhura nga studimet e ndryshme. Deri tani janë ngritur gjashtë observatorë përkatësisht në qarqet e Shkodrës, Kukësit, Dibrës, Durrësit, Elbasanit dhe Korçës. Plani i UNICEF-it në bashkëpunim dhe me Aleancën për Fëmijët është që të ngrejë dhe tre struktura të reja në qarqet e Tiranës, Fierit dhe Gjirokastrës.

Institucioni i Avokatit të Popullit⁹, mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Ai ka si mision të tij

⁹ Ligji përkatës Nr. 8454, datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" është plotësuar me Ligjin Nr. 8600, datë 10.04.2000, si dhe është ndryshuar edhe me Ligjin Nr. 9398, datë 12.05.2005.

parandalimin e konflikteve të mundshme midis administratës publike dhe individit. Avokati i Popullit vepron në bazë të ankesës apo kërkesës së paraqitur pranë tij. Ai vepron edhe me nismën e vet, për raste të veçanta, të bëra publike, por gjithmonë duhet të marrë më vonë pëlqimin e të interesuarit ose të dëmtuarit¹⁰.

Gjatë vitit 2008 u trajtuan 96 raste ankesash apo kërkesash me objekt shkeljen e të drejtave të fëmijëve. Disa prej tyre preknin të drejtat e një numri të konsiderueshëm fëmijësh. Nga këto, 36 raste kanë rezultuar jashtë juridiksionit apo kompetencës së Avokatit të Popullit, 33 ankesa apo kërkesa të pabazuara, 38 ankesa të zgjidhura në mënyrë pozitive, dhe për 11 ankesa janë dhënë rekomandime apo propozime të pranuar nga organet e administratës. Megjithëse ka patur një numër të konsiderueshëm të numrit të rasteve të trajtuara, përsëri numri i ankesave për fëmijët është i madh veçanërisht numri i ankesave që vijnë nga prindërit osë të afërmit e tyre.

Objekti i rasteve të trajtuara gjatë kësaj periudhe ka qenë i lidhur me trajtimin e veçantë të fëmijëve, me përmirësimin e kushteve në shkolla dhe trajtimin e nxënësve, mosdhënien e ndihmës ekonomike nga bashkia dhe përfitimin e statusit të jetimit, mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor të prindërve, vendosjen e fëmijëve jetimë në qendra rezidenciale, përmirësimin e kushteve të strehimit, shkeljen e të drejtave të fëmijëve nga organet e administratave të shteteve të huaja, mosregjistrimin e fëmijëve, dhe moszbatimin e procedurave ligjore për rastet e fëmijëve në konflikt me ligjin, apo ankesa për të drejtat e fëmijëve, prindërit e të cilëve vuajnë dënime me heqje lirie, etj.

Në Raportin e Veçantë të punës së Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, të paraqitur në parlament, është theksuar domosdoshmëria e krijimit të një institucioni të pavarur për të Drejtat e Fëmijëve (Ombudsman apo Komisioner për Fëmijët), puna e të cilit do të jetë e fokusuar në raportet mes problemeve të fëmijëve dhe interesit të zyrtarëve publikë.

Gjate vitit 2008, në funksion të përmbushjes së detyrimeve të tij insitucionale, Avokati i Popullit ka dërguar në Parlament si dhe në disa Ministri disa rekomandime për përmirësimin e legjislacionit dhe konkretisht:

- Rekomandim drejtuar Ministrin të Drejtësisë për marrjen e masave të nevojshme organizative, teknike, materiale dhe financiare për krijimin e institucionit të edukimit për vendosjen e të miturve që kanë kryer vepra penale, por nuk kanë mbushur moshën 14 vjeç.
- Rekomandim drejtuar MD dhe MPCSSHB për ndryshimin e nenit 352 të Ligjit Nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedures Civile i Republikës së Shqipërisë”, për të siguruar që të miturit të mund të kërkojnë vetë në gjykatë, për t’u vendosur në kujdestari kur të kenë mbushur moshën 14 vjeç.
- Rekomandim drejtuar Ministrin të Arsimit dhe Shkencës për marrjen e iniciativës për disa plotësime në Ligjin Nr. 7952, datë 21.06.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar” dhe në Dispozitat Normative për Arsimin, për garantimin sa më të plotë të të drejtave të fëmijëve.

¹⁰ <http://ëëë.avokatipopullit.gov.al/Organizimi.htm>

- Rekomandim drejtuar Ministrit të Drejtësisë për disa shtesa e ndryshime në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale, në favor të fëmijëve, edhe në kuadrin e Reformës në drejtësi.
- Në Dhjetor 2008 i është dërguar Ministrit të Arsimit dhe Shkencës një informacion lidhur me problematiken e konstatuar në zbatim të reformës në arsimin parauniversitar dhe disa rekomandime. Kjo me synimin e përmirësimit të kuadrit të nevojshëm ligjor si dhe në të njëjtën kohë, të përshpejtimin të këtij procesi, në përputhje me kërkesat që shtrohen në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Arsimin Parauniversitar 2004-2015.

Institucionet e nivelit qendror, të përfshira drejtpërsëdrejti në zbatimin e SKF janë: Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Këto institucione kanë detyrimin ligjor dhe institucional për të raportuar në qeveri për realizimin e të drejtave të fëmijëve.

Megjithëse zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Fëmijët shihet si detyrim ligjor i strukturave të qeverisjes qendrore, me decentralizimin e kompetencave, edhe pushteti vendor është përfshirë në procesin e institucionalizimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Strukturat e pushtetit vendor gradualisht po ndërmarrin dhe ushtrojnë përgjegjësitë e tyre për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Në nivel vendor, strukturat përgjegjëse për zbatimin e SKF janë: Drejtoritë Arsimore Rajonale/Zyra Arsimore, Drejtoritë e Shërbimit Social Shtetëror Rajonal, Drejtoritë e Rajonale të Shëndetit Publik, Drejtoritë Rajonale të Policisë si dhe Njësitë e qeverisjes vendore (Qarqet, Bashkitë).

1.4 Gjetjet e vlerësimit

Në kuadrin e zhvillimit të legjislacionit i cili mbulon politikat sociale për fëmijët MPÇSSHB në bashkëpunim me UNICEF-in, kanë ndërmarrë inisiativën për përgatitjen dhe aprovimin në Parlament të Ligjit Kuadër për të Drejtat e Fëmijëve. Kjo inisiativë vjen si rezultat i nevojës për një kuadër institucional për të drejtat e fëmijëve si dhe detyrimin të Qeverisë për të përkufizuar disa nga konceptet kryesore për të drejtat e fëmijëve. Inisiativat ligjore janë pasqyruar dhe në ndryshimet e kuadrit ligjor për kohëzgjatjen e raportit por duhet theksuar se ka dhe inisiativa të tjera si ato për të cilat përgjigjen përfaqëuesit e Drejtorisë së Politikave të Shërbimeve Sociale, projekt VKM për dokumentacionin dhe masa e përfitimit të familjes kujdestare dhe projekt VKM për standartet e shërbimit të kujdestarisë të cilat synojnë që të sigurojnë dhe të përmirësojnë gjendjen dhe zhvillimin e mundësive për fëmijët dhe të rinjtë në përkujdesjen jashtë shtëpisë. Drafti përbëhet nga 23 standarde që janë të organizuar në bazë të tre seksioneve:

- Fëmijët dhe të rinjtë;
- Prindërit kujdestarë; dhe
- Institucionet dhe strukturat e përfshira në shërbimin e kujdestarisë.

Më tej edhe nga të anketuarit e Shërbimit Social Shtetëror ka informacion që projekt VKM-të parashikojnë njohje me legjislacionin, rregullime për diskriminimin dhe institucionalizimin e të drejtave.

Në kuadrin institucional, me ligjin kuadër do të ketë një institucionalizim të të drejtave, mënjanimin e fragmentarizimit të përpjekjeve të koordinuara ose jo në qendër dhe në terren.

Zgjerimi i tipologjisë së shërbimeve si "shtëpi-familje", dhe tipologjia e shërbimeve që karakterizojnë atë; shërbimi psikosocial si dhe decentralizimi duhet të jenë të shoqëruar me rregullimet e nevojshme ligjore në përputhje me nevojat që dalin nga studimet përkatëse, të cilat janë të nevojshme për vlerësimin e situatës.

Infrastruktura për shërbimet dhe mbrojtjen e fëmijëve mund të paraprihet edhe me rregullime ligjore/nënligjore, si p.sh. në zbatim të Ligjit Nr. 9669 do të ngrihet një Qendër Kombëtare për mbrojtjen e viktimave të dhunës.

Shpërndarja e legjislacionit aktorëve të interesit është faktor kyç në zbatimin e tij. Praktika të mira me shpërndarjen e legjislacionit dhe manuale pune ka nga Ministria e Brendshme por për të gjithë Ministrinë vlen fakti se në faqet zyrtare të internetit kanë legjislacionin bazë për të gjithë aktorët. Gjithashtu, informimi i publikut është i vazhdueshëm por vetinformimi është një proces dhe si i tillë duhet trajtuar në varësi të zhvillimeve dhe risive.

Pjesëmarrja e pushtetit vendor dhe sektorit joqeveritar në financimin dhe menaxhimin e shërbimeve sociale është një domodoshmëri në implementimin e legjislacionit dhe politikave sociale. Në nivel lokal kërkohet të bëhen më shumë për shtrirjen dhe financimin e këtyre shërbimeve si dhe ngritjen e kapaciteteve. Koordinimi mbetet i rëndësishëm në përpjekjet e të gjithë aktorëve. Plani i Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Fëmijë (i buxhetuar) është një njësi matëse në këtë aspekt për gjithë aktorët e përfshirë.

1.5 Rekomandime

Strategjia Kombëtare për Fëmijë 2005-2010 duhet të ketë një fazë përmbyllëse ku të bëhet një vlerësim cilësor dhe sasior i objektivave të strategjisë, krahasimisht bazuar dhe në raportet e progresit të çdo viti.

Vlerësimi i nevojave që lindin nga zbatimi i strategjisë të shërbejë si pikënisje për fushat ku do të përqëndrohet Strategjia.

Strategjia në të ardhmen duhet të ketë edhe elementë të një vendi që synon integrimin europian si dhe një përjasje që u referohet dhe eksperiencave të vendeve të rajonit në proceset integruese.

Në Planin e Veprimit duhet të dalë qartë roli i autoritetit përgjegjës, aktorit monitorues. Gjithashtu duhet që të caktohen afate të qarta dhe të mbahet parasysh procesi i buxhetimit të Planit të Veprimit në përputhje me udhëzimet përkatëse dhe projekt buxhetin afatmesëm, si dhe të monitorohet ndikimi që procesi i decentralizmit mund të ketë në realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe ofrimin e shërbimeve për fëmijë.

KAPITULLI II: E DREJTA E MBROJTJES SHOQËRORE

Vlerësimi i zbatimit të objektivave të strategjisë kombëtare për fëmijët në lidhje me të drejtën për mbrojtje shoqërore.

2.1 Vlerësimi i përgjithshëm

Shqipëria ka patur dhe vazhdon të ketë një angazhim të përhershëm, përse i përket përmirësimit të vazhdueshëm të standarteve, lidhur me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve.

Kuadri ligjor për mbrojtje dhe kujdes social gjatë periudhës 2005-2009 është përmirësuar dhe plotësuar vazhdimisht. Promovimi dhe garantimi i të drejtave të fëmijëve për mbrojtje dhe kujdes social përbën një ndër prioritetet e politikave sociale të ndërmarra dhe të realizuara gjatë kësaj periudhe.

Kapitulli e Drejta për Mbrojtje dhe Kujdes Social pasqyron një vlerësim të Zbatimit të Strategjisë për Fëmijët dhe Planit të Veprimit për periudhën 2008-2009 dhe një vlerësim të përgjithshëm të strategjisë në lidhje me të drejtën e fëmijëve për mbrojtje dhe kujdes social. Analiza e mëposhtme vlerëson realizimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët dhe Planit të Veprimit, identifikon çështjet kritike dhe gjetjet në lidhje rolin e politikave sociale për mbrojtjen e fëmijëve nga varfëria dhe përjashtimi social si dhe rrjetet komunitare të cilat sigurojnë shërbime të qëndrueshme për fëmijët.

Objektivat e Strategjisë për Fëmijë në lidhje me të drejtën e mbrojtjes sociale janë:

Objekivi 1: Ngritja e një rrjeti të qëndrueshëm të shërbimeve komunitare për fëmijët.

Objekivi 2: Mbrojtja e fëmijëve nga varfëria dhe përjashtimi social/mbrojtja sociale dhe mbijetesa e fëmijëve.

2.2 Vlerësimi i realizimit të objektivave që synojnë realizimin e të drejtës së fëmijëve për mbrojtje sociale

Shteti mbetet faktori kryesor për kujdesin në para dhe shërbime përkujdesi për familjet dhe fëmijët në nevojë. Problemet sociale dhe nevojat për ndërhyrje/përkujdes social janë në zgjerim, ndërsa kapacitetet institucionale, burimet financiare dhe profesionale mbeten të kufizuara.

Përmirësimi i kuadrit ligjor për ndihmën dhe shërbimet sociale përbën një nga komponentët e rëndësishëm të projektit të SHSSH në Shqipëri. Këto përmirësime janë bërë në kuadrin e përmirësimit të politikave, përmendim këtu Strategjinë e Shërbimeve

Sociale (SSHS) të miratuar me VKM Nr. 265, datë 28.04.2005 si dhe një sërë strategjish të tjera të targetuara për grupe të veçanta. Aktiviteti me i rëndësishëm në këtë drejtim ka qënë hartimi dhe miratimi Ligjit Nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”. Ky ligj i zgjeron kufijtë e përfitimit për të gjithë grupet në nevojë, krijon hapësirat e nevojshme për decentralizimin dhe rritjen e kompetencave të qeverisjes vendore si dhe për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Në kuadrin e kësaj pakete bëhet e mundur që për herë të parë (i) të krijohen hapësirat ligjore që pushteti lokal të marrë përgjegjësi për të kushtëzuar ndihmën ekonomike me punë e shërbime në komunitet; (ii) njësitë e qeverisjes vendore të kenë hapësira ligjore për të mbështetur familjet e varfëra me burimet e veta financiare nga taksat lokale duke caktuar kritere specifike; (iii) u zgjeruan kufijtë e përfitimit të ndihmës ekonomike për fëmijët që lindin si trenjakë e më shumë; kjo kategori mbështetet financiarisht deri sa mbarojnë arsimin e detyrueshëm.- ky është një element i ri i rëndësishëm i ligjit sepse në këtë rast trajtohet fëmija si individ me një gjendje sociale të caktuar dhe jo si një anëtar i familjes së varfër; (iv) jetimët që dalin nga institucionet rezidenciale trajtohen me të ardhura dhe shërbime të veçanta; (v) rritet kufiri maksimal i ndihmës ekonomike – ndryshim sasior i rëndësishëm që sjell ligji; (vi) u rivlerësuan të ardhurat nga disa sektorë (bujqësia, blegtoria etj.) gjë që sjell një targetim më të drejtë të ndihmës ekonomike.

Gjithashtu edhe Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale ka si qëllim të realizojë, sipas prioriteteve strategjike, objektivat e mëposhtme: (i) zbutjen e varfërisë; (ii) reduktimin e shkallës së varfërisë absolute për frymë në 10% deri në 2013 sipas rezultateve të vëzhgimit të nivelit të jetesës së familjes; (iii) rritjen e buxhetit për programin e ndihmës ekonomike; (iv) rritjen e mbulimit të familjeve të varfëra me ndihmë ekonomike sipas rezultateve të vëzhgimit të nivelit të jetesës së familjes; (v) reduktimin e numrit të familjeve jo të varfra që marrin ndihmë ekonomike; (vi) rritjen e pagesës mesatare të ndihmës ekonomike; (vii) shtrirjen e kushtëzimit të përfitimit të ndihmës ekonomike nëpërmjet punës, në një numër sa më të madh bashkish dhe komunash; (viii) reformimin e sistemit të shërbimeve shoqërore; (ix) mbështetjen e grupeve në rrezik përsa i takon përjashtimit social.

Legjislacioni i ndihmës ekonomike është përmirësuar vazhdimisht duke synuar gjithnjë e më shumë përfshirjen në skemë të individëve dhe familjeve në kushte më të vëshira ekonomike dhe sociale.

Duke iu referuar të dhënave administrative, aktualisht rreth 200,000 fëmijë janë në përbërje të familjeve përfituese të NE, ose rreth 69% e familjeve të varfëra përfituese të ndihmës ekonomike kanë në përbërje fëmijë (shih tabelën 2.1).

Tabela 2.1: Numri i familjeve dhe masa e ndihmës ekonomike mujore në vite.

Përshkrimi	2006	2007	2008	2009
Nr. i familjeve në Ndhmë Ekonomike	119.000	115.000	110.000	93,500
Masa mesatare mujore e ndihmës ekonomike për familje	2,029	1,970	3,091	4,400

Burimi: SHSSH, 2009

Aktualisht MPCSSHB ka përgatitur disa propozime për përmirësimin e Ligjit Nr. 9355 për të lehtësuar përfshirjen në skemën e NE të grupeve në nevojë si fëmijë jashtë kujdesit prindëror dhe që nuk trajtohen në institucione rezidenciale si edhe viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror.

Tabela 2.2 paraqit informacion statistikor mbi fëmijët me aftësi të kufizuar.

Tabela Nr. 2.2: Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuar që kanë përfituar pagesa në para gjatë periudhës 2006-2009

Përshkrimi	Viti 2006	Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009
Persona gjithsej	53,380	55,754	57,333	60,439
Fëmijë me aftësi të kufizuar			17,397	18,122
Fëmijë jetimë dhe me probleme sociale				280
Fëmijë me aftësi të kufizuar në institucione				130
Përfitues (fëmijë)në shërbimet rezidenciale				347
Përfitues (fëmijë)në shërbimet ditore				2,950
Gjithsej				3,297

Burimi: SHSSH 2009

Nga analiza e të dhënave rezulton se në rrjetin e institucioneve publike dhe jopublike gjatë vitit 2009 në total janë trajtuar rreth 3,700 fëmijë prej të cilëve rreth 80% në shërbimet jorezidenciale. Ky tregues dëshmon për vijimin e tendencës pozitive të deinstitutionalizimit të shërbimeve dhe rritjen graduale të peshës specifike të kujdesit jorezidencial.

Nga vlerësimi i shpërndarjes gjeografike të shërbimeve për fëmijë vihet re një përqëndrim më i madh i shërbimeve të OJF-ve kryesisht në Qarkun e Tiranës dhe në disa qendra urbane, ndërsa zonat periferike dhe rurale kanë akses të kufizuar ose janë të pambuluara me shërbime mbështetëse për fëmijët në nevojë.

Nga të dhënat statistikore rezulton se rreth 87% e fëmijëve në institucionet e përkujdesit shoqëror vijnë nga familje me probleme social-ekonomike.

Deri tani ka përfunduar procesi i kalimit të institucioneve publike rezidenciale në varësi të njësisive të qeverisjes vendore. Institucionet e decentralizuara vazhdojnë të mbështeten me fonde nga buxheti i shtetit sipas një skeme për transferimin gradual të përgjegjësive financiare, pasi njësitë e qeverisjes vendore për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme dhe mundësive të kufizuara financiare, nuk i përgjigjen kërkesave për reformimin e institucioneve rezidenciale dhe ngritjen e shërbimeve të reja në përputhje me dinamikën e nevojave të fëmijëve në nevojë.

Decentralizimi kompetencave drejt pushtetit vendor nënkupton marrjen e përgjegjësive edhe në drejtim të vlerësimit të nevojave dhe komisionimin e klientëve, por konstatohet se procesi i ngritjes së Komisioneve të Vlerësimit të kërkesave për sistemimin e klientëve në institucionet rezidenciale pranë njësisive të qeverisjes vendore po ecën ngadalë.

Përveç punës për transferimin e qendrave, përpjekjet janë shtuar në nxitjen e formave të shërbimeve alternative në strukturat rezidenciale të përkujdesit për fëmijë, dhe konkretisht shërbime ditore, shtëpi-familje, dhe shërbime në komunitet.

Procedura e sistemimit të fëmijës në familjen kujdestare, organizohet dhe mbikqyret nga organet e qeverisjes vendore, të cilat ngrenë pranë tyre komisionet multidisiplinare për vlerësimin paraprak të rasteve. Organizimi dhe funksionimi i komisioneve multidisiplinare, përcaktohet në rregulloren e miratuar nga organet e qeverisjes vendore. Kriteret, dokumentacioni, procedura dhe masën e financimit të shërbimit të kujdestarisë përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nxjerr udhëzim për procedurat dhe zbatimin e standarteve të shërbimeve.

Funksionet e sektorit të shërbimeve sociale pranë Qarkut janë të mirëpërcaktuara në VKM Nr. 563. Këto funksione lidhen kryesisht me krijimin e një sistemi vlerësimi e monitorimi të nivelit të varfërisë në nivel qarku, krijimin e një baze të dhënash për grupet në nevojë, familjet e varfëra dhe individët që kanë nevojë për shërbime shoqërore, llojin e shërbimeve shoqërore që ofrohen nga personat juridikë, publikë, privatë si dhe OJF-të që veprojnë në nivel qarku, duke bërë vlerësimin e nevojave dhe me pas në varësi të tyre ngritjen e shërbimeve të reja në përputhje me mundësitë dhe burimet.

Analiza e realizimit të së drejtës së fëmijëve për mbrojtje sociale tregon se vëmëndja e institucioneve dhe zbatuesve të politikave po rritet ndaj sigurimit të shërbimeve cilësore komunitare.

Tabela Nr. 2.3: Numri i përfituesve për kategorinë fëmijë dhe të rinj në rrezik dhe mbulimi me shërbime

Lloji i shërbimit	Kategoria (përfituese) e fëmijëve në rrezik	Përfituesit në % ndaj totalit të përfituesëve	Mbulesa
Shërbime informimi dhe këshillimi për fëmijë dhe të rinj.	<ul style="list-style-type: none"> - Fëmijë të abuzuar, keqtrajtuar; - Fëmijë të familjeve të varfëra; - Fëmijë që punojnë; - Fëmijë të rrugës; - Fëmijë të rrezikuar nga trafikimi dhe shfrytëzimi; - Fëmijë të komunitetit rom; - Fëmijë me AK. 	85%	Bashkia Tiranë Bashkia Shkodër Bashkia Fushë Krujë Komuna Krrabë Bashkia Orikum Bashkia Vlorë Komuna Qendër Fier Bashkia Durrës Bashkia Memaliaj Bashkia Kukës Bashkia Vau i Dejës Bashkia Pukë Bashkia Poliçan Bashkia Delvinë Komuna Ksamil Bashkia Berat
Shërbime advokimi	<ul style="list-style-type: none"> - Fëmijë jetim social 	15%	Bashkia Tiranë Bashkia Shkodër Bashkia Vlorë
Shërbime rekreacioni	<ul style="list-style-type: none"> - Fëmijë të familjeve të varfëra; - Fëmijë që kanë braktisur arsimin e detyrueshëm. 	42%	Bashkia Tiranë Bashkia Shkodër Bashkia Orikum Bashkia Vlorë Komuna Qendër Fier Bashkia Durrës Bashkia Vau i Dejës Bashkia Pukë Bashkia Berat
Shërbime arsimimi	<ul style="list-style-type: none"> - Fëmijë të familjeve të varfëra; - Fëmijë që kanë braktisur arsimin e detyrueshëm; - Fëmijë që punojnë; - Fëmijë të rrezikuar nga trafikimi; - Fëmijë të kthyer nga trafikimi. 	28%	Bashkia Tiranë Bashkia Shkodër Bashkia Fushë Krujë Bashkia Vlorë Komuna Qendër Fier Bashkia Durrës Bashkia Memaliaj Bashkia Kukës Bashkia Poliçan Bashkia Berat
Shërbime shëndetësore,	<ul style="list-style-type: none"> - Fëmijë me aftësi të kufizuar; 	65%	Bashkia Tiranë (Every Child, APRAD)

parandaluese dhe diagnostikuese	<ul style="list-style-type: none"> - Fëmijë të familjeve të varfëra; - Fëmijë të kthyer nga trafikimi. 		<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Shkodër (The door) Bashkia Fushë Krujë (dëmtimet e armëve) Bashkia Vlorë Komuna Qendër Fier Bashkia Durrës (Biblioteka audio) Bashkia Maminas Bashkia Kukës Bashkia Vau i Dejës Bashkia Laç Bashkia Rrogozhinë Bashkia Delvinë Bashkia Berat Bashkia Gjirokastrë
Foster Care	<ul style="list-style-type: none"> - Jetim biologjik dhe social; - Fëmijë të familjeve që jetojnë në varfëri ekstreme 	10%	<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Tiranë Bashkia Shkodër (Every child)
Birësime	<ul style="list-style-type: none"> - Jetim biologjik 	0%	
Shërbime psiko-sociale	<ul style="list-style-type: none"> - Fëmijë të abuzuar 	25%	<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Tiranë Bashkia Shkodër Bashkia Vlorë Bashkia Durrës Bashkia Berat
Shërbime trajnimi	<ul style="list-style-type: none"> - Të rinj të kthyer nga emigracioni; - Vajza dhe djem të rrezikuara nga trafikimi dhe shfrytëzimi; - Të rinj me rekorde kriminaliteti. 	15%	<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Tiranë Bashkia Vlorë Bashkia Vau i Dejës

Burimi i informacionit: Projekti i shpërndarjes së shërbimeve sociale, 2008

Nga pikëpamja sasiore rezultatet e vlerësimit për këtë kategori tregojnë se 72% e fëmijëve dhe të rinjve që kanë përfituar shërbime nga nënprojektet e ngritura në kuadër të projektit SHSSH, janë të varfër¹¹. Ndërsa 46% e tyre janë fëmijë të familjeve që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike ose pagesës së papunësisë. Gjithashtu vlerësimi gjeti se rreth 92% e përfituesëve të kësaj kategorie jetojnë në zona urbane ose periurbane, dhe vetëm 8% në zona rurale. 22% e fëmijëve dhe të rinjve përfitues banojnë në zona informale.

¹¹ Të pyetur për gjendjen ekonomike të familjeve të tyre ato deklarojnë se janë të varfër.

Tabela Nr. 2.4: Numri i fëmijëve përfitues të shërbimeve komunitare nga projekti i SHSSH

Kategoria	Gjithsej	Faza e parë	Faza e dytë
Fëmijë	3012	1515	1479
Të rinj	6058	1069	4989
PAK	950	-	950
Gratë dhe familjet	7405	1700	5705
Të moshuar	6175	1455	4720
Të tjerë	1800	850	950
Gjithsej	25400	6589	18811

Burimi i informacionit: Projekti shpërndarja e shërbimeve sociale, 2008

Në Bashkinë e Tiranës prej 3 vjetësh ka një buxhet të planifikuar për shërbime sociale dhe qendrat rezidenciale në varësi të saj, gjë që tregon jo vetëm "de-jure" por edhe "de-facto" se menaxhimi i shërbimeve sociale bëhet nga pushteti lokal.

Shërbimi më i ri komunitar për fëmijët, në ndihmë të realizimit të së drejtës së tyre për mbrojtje shoqërore është Linja kombëtare e telefonit për fëmijët (116).

"Linja kombëtare e telefonit për fëmijët në Shqipëri" është një nismë e UNICEF-it, Shqipëri dhe Qendrës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA/DCI Shqipëri). Kjo linjë ka si qëllim që të ofrojë këshillim psiko-social për fëmijët nëpërmjet telefonit, referimin e çdo problemi të fëmijës pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve në Bashki dhe OJF, si dhe të dëgjojë ankesat e çdo fëmije i cili nuk ka mundësi t'i shprehë ato në një formë tjetër.

Linja kombëtare për fëmijët ka vendosur në përdorim aktiv numrin 116. Ky numër është mundësuar nga AKEP (Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare) me vendim Nr. 207/3 datë 25.02.2009. Numri 116 është një numër pan-europian dhe gëzon cilësitë numrit të policisë apo urgjencës. Linja ofron shërbim falas 24 orë/ditë në 7 ditë të javës për fëmijët.

Në vijim paraqitet vlerësimi i arritjeve në lidhje me realizimin e të drejtës për mbrojtje sociale sipas grupeve shoqërore të konsideruara të përjashtuara ose në rrezik përjashtimi.

2.2.1 Fëmijët e familjeve të varfëra

Shkalla e prekshmërisë së fëmijëve nga varfëria dhe pasojat e saj sociale diferencohet në varësi të vendbanimit, tipologjisë së familjes, statusit etnik dhe shëndetësor të fëmijëve, etj. Sipas të dhënave të LSMS në vitin 2002 rreth 32.8 % e fëmijëve (293,000 fëmijë) jetonin nën nivelet minimale të jetesës¹², ndërsa sipas të dhënave të LSMS 2005, rreth 245,000 ose 24.7 % e fëmijëve jetonin në varfëri. Megjithatë treguesit mbeten ende të lartë dhe ulja e treguesve të varfërisë është shoqëruar me uljen e numrit të fëmijëve të prekur nga varfëria.

¹² LSMS-INSTAT -2002

Një studim i kryer nga një grup specialistësh të INSTAT-it, PNUD-it dhe Bankës Botërore, (publikuar në prill 2009) nxori rezultatin se Shqipëria vazhdon të provojë ulje të ndjeshme të varfërisë në periudhën 2005-2008. Studimi bazohet në të dhënat e mbledhura nëpërmjet Vlerësimit për Matjen e Nivelit të Jetesës nga një kampion familjesh përfaqësuese për gjithë popullsinë. Në anketat e kryera në periudhat prill-qershor të vitit 2002, maj-qershor 2005 dhe qershor-gusht 2008, u intervistuan afërsisht 3,600 familje. Rezultatet për 2008 tregojnë se 12.4% e popullsisë është e varfër kundrejt 18.5% në 2005, dhe 25.4% në 2002. Kjo tregon se rreth 200,000 persona nga rreth 575,000 që ishin të varfër në 2005 kanë dalë nga varfëria vetëm gjatë periudhës 2005 deri në 2008. Varfëria është përkufizuar si pamundësia e personave për të shpenzuar të paktën 5722 lekë në muaj për frymë në vitin 2008 (ose 4891 lekë për frymë në muaj në 2002).

Niveli i lartë i rritjes ekonomike që ka përjetuar Shqipëria në 11 vitet e fundit është mesatarisht 7.1% rritje në vit që nga 1998, së bashku me një rritje mesatare të pagave (në terma reale) prej 36.5 % në vitet 2005-2008 dhe të pensioneve në vitet 2005-2007 me 17.4 %, ka kontribuar në këto rezultate. Si rezultat, konsumi mesatar për frymë në terma reale është rritur me 7.0 % që nga 2005. Rezultatet e anketës tregojnë një ulje të ndjeshme të varfërisë në zonat rurale në periudhën 2005-2008. Zvogëlimi i shpejtë i varfërisë në zonat rurale nënkupton që varfëria mund të mos përbëjë më një problem kryesisht rural. Zona të tjera të Shqipërisë vazhdojnë të provojnë ulje të rëndësishme të nivelit të varfërisë. Zonat qendrore kanë patur uljen më të madhe të nivelit të varfërisë që nga viti 2005. Sidoqoftë, të dhënat tregojnë një ngadalësim të dukshëm të reduktimit të varfërisë në zonat malore, ku varfëria vazhdon të shfaqë nivelin më të lartë si dhe ulje jo të rëndësishme që nga 2005. Përafërsisht, 3.5 përqind e shqiptarëve vazhdojnë të jetojnë në varfëri ekstreme (me më pak se një USD në ditë) dhe ekzistojnë pabarazi të dukshme midis zonave rurale dhe atyre urbane. Roli i rëndësishëm i rritjes së qëndrueshme ekonomike si dhe i reformave ekonomike, që kanë çuar në qëndrueshmërinë makroekonomike, qeverisjen e përmirësuar, zhvillimin e investimeve në sektorin privat, përfitim të shërbimeve sociale publike (arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale), si dhe infrastrukturën e zgjeruar duhet të vazhdojnë të mbahen në të njëjtat nivele në mënyrë që të mbahen të ulëta edhe nivelet e varfërisë. Duke i drejtuar përpjekjet në zgjidhjen e problemeve të Zonës Malore, do të arrihet një ulje më e shpejtë e varfërisë në të ardhmen.

Analiza e treguesve të varfërisë në raportet fshat/qytet nxjerr në pah se varfëria është më e thellë tek fëmijët që jetojnë në zonat e thella rurale, fëmijët me prindër të papunë dhe tek fëmijët e familjeve me kryefamiljare gra ose familje me më shumë se tre fëmijë¹³.

¹³ INSTAT-Vëzhgimi për Matjen e Standarteve të Jetesës, Tiranë 2002

Qeveria po adreson pabarazitë rajonale dhe nevojat e grupeve të brishta përmes strategjive, duke shënuar arritje të dukshme në lidhje me programet për varfërinë.

Tabela Nr. 2.5: Ndryshimi i varfërisë absolute të gratë dhe fëmijët sipas shpërndarjes gjeografike

	Viti 2002			Viti 2005			Ndryshimi në %		
	Totali	Gra	Fëmijë	Totali	Gra	Fëmijë	Totali	Gra	Fëmijë
Shqipëria	25,4	22,0	32,1	18,5	16,1	24,7	-27	-27	-23
Zona Urbane	20,1	18,1	25,8	12,4	10,4	17,6	-38	-43	-32
Zona Rurale	29,6	25,8	36,1	24,2	22,0	30,2	-18	-15	-16

Burimi: Vlerësimi për Matjen e Nivelit të Jetesës, VSMJ, 2002-2005

2.2.2 Fëmijët e dhunuar dhe të abuzuar

Në zbatim të Ligjit Nr. 9669 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, gjatë vitit 2008 janë mbajtur të dhëna statistikore të veçanta për viktimat e dhunës në familje, përfshirë edhe të miturit. Nga të dhënat e raportuara nga Policia e Shtetit rezulton se gjatë vitit 2008 janë evidentuar rreth 822 raste dhune në familje, ku 76 raste kanë qenë nën moshën 18 vjeç.

Tabela Nr. 2.6: Të mitur të dëmtuar nga dhuna në familje, viti 2008

Të mitur të dëmtuar nga dhuna në familje , viti 2008													
Vrasje	Shkaktim vetvrasje	Plagosje e rëndë me dashje	Plagosje e lehtë me dashje	Marredhenie seksuale	Vepra të turpshme	Braktisje	Mosdhënie e mjeteve për jetesë	Marrje e padrejtë e fëmijës	Shtërngim bashkjetese	Kanosje	Shkatërrim prone	Vepra të tjera (nenet 90; 91; 92;120;261;	Shuma
1	18	2	1	8	2	2	1	2	1	2	4	32	76

Burimi:

Me qëllim rritjen e kapaciteteve institucionale të punonjësve të policisë për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, duke zbatuar rigorozisht procedurat e shoqërimit, marrjes në pyetje, trajtimit nëpër ambjentet e policisë si dhe sensibilizimin për ti kushtuar vëmendjen e duhur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, në partneritet me “Klinikën Ligjore për të Mitur”, në shtator 2008 ka organizuar 2 sesione trajnuese me punonjës të policisë në qarqet Tiranë, Shkodër, Korçë, Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Lezhë, Elbasan, Dibër, Berat, Durrës.

Gjatë vitit 2008 janë trajnuar rreth 984 punonjës¹⁴ nga institucionet me përgjegjësi direkte për zbatimin e ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe SKBGJDHF, si psh: (i) punonjës të shëndetësisë (mjekë, infermierë, mami); (ii) punonjës të policisë; (iii) gjyqtarë e prokurorë. Trajnimi u realizua me mbështetjen financiare të UNDP-së.

Gjithashtu, gjatë vitit 2009-2010, UNFPA në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Qendrën Kombëtare për Studime Sociale, po përgatit manualin “Për viktimat e dhunës, me bazë gjinore” ku përfshihen dhe fëmijët, si dhe do të trajnojnë 1,800 punonjës të sistemit parësor shëndetësor në të gjithë vendin, për ndihmën ndaj viktimave të dhunës (gratë dhe fëmijët).

Një numër i madh studimesh ka vënë në dukje dhunën që ushtrohet ndaj fëmijëve në familje, shkollë apo edhe në institucione rezidenciale. Studimet në përgjithësi përdorin metodologji të ndryshme në përcaktimin e niveleve të dhunës ndaj fëmijëve, por ato vijjnë në një emërues të përbashkët kur konstatojnë se mjedisi ku rriten fëmijët është një mjedis i dhunshëm.

2.2.3 Fëmijët e minoritetit rom

Sapo është përfunduar Plani Kombëtar i Veprimit për zbatimin e deklaratës “Dekada e Romëve”. Hartimi i këtij dokumenti është rrjedhojë e një procesi të koordinuar dhe drejtuar nga Sekretariati Teknik për Romët, strukturë në MPCSSHB.

Gjithashtu është hartuar dhe publikuar për herë të parë në shqip dhe në anglisht raporti i progresit të Strategjisë Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom” dhe po shpërndahet në çdo njësi të qeverisjes qendrore dhe vendore. Për mbrojtjen e komunitetit rom në fushën sociale janë ndërmarrë disa masa si:

- Integrimi i fëmijëve rom në jetën normale duke ngritur qendra ditore të cilat do të shërbejnë si strehë dhe shkollë për ta;
- Kontrollë sistematike nga Inspektoriati Shtetëror i Punës lidhur me punën e zezë të fëmijëve romë;

¹⁴ Projekti i UNDP “Dhuna në familje, jo vetëm problem familjar”.

- Sensibilizim për njohjen e të drejtës së përfitimit të NE, pagesën e papunësisë, për barrë lindje, etj;
- Mbështetja e shoqatave romë nëpërmjet: (i) evidentimit dhe regjistrimit të OJF-ve romë që ushtrojnë aktivitete; (ii) krijimit të rrjetit të OJF-ve; (iii) bashkëpunimit të OJF-ve me organe të ndryshme vendimmarrëse të shtetit.

Vlerësimi konkludon që fëmijët e komunitetit rom kanë akses në të gjitha shërbimet sociale që ofrohen për fëmijët, por duhet më shumë punë sensibilizuese për ndergjegjësimin e tyre për të përfituar nga këto shërbime.

2.2.4 Fëmijë që janë të detyruar të punojnë

Inspektorati Shtetëror i Punës, i cili ka si qëllim të sigurojë zbatimin e legjislacionit të punës nga subjektet, mbi të cilat vepron ky ligj, në përputhje me procedurat e kryerjes së inspektimit në punë, ka kontrolluar punën e të miturve në subjekte të ndryshme shtetërore dhe private. Nga inspektimet në të gjithë territorin e RSH-së për vitin 2008, janë evidentuar 540 fëmijë që punojnë në sektorin formal, nën moshën 18 vjeç. Përqindja më e madhe e fëmijëve punojnë në ndërmarrjet prodhuese konkretisht: rreth 40% në ndërmarrjet e përpunimit të peshkut, në prodhimin e këpucëve rreth 30%, në rrobaqepsi 23% dhe në sektorin e ndërtimit rreth 7%. Në përgjithësi vërehet një numër i madh vajzash rreth 89.2% rreth 10.8% meshkujsh.

Vihet re një ndjeshmëri më e madhe e strukturave shtetërore, por edhe punëdhënësve për zbatimin e legjislacionit dhe mbrojtjen e të miturve të punësuar. ISHP ka organizuar edhe tryeza të rrumbullakëta për mbrojtjen e të miturve në punë, ku kanë marrë pjesë përfaqësues nga sindikatat dhe konfederatat e punëdhënësve, punëmarrësve.

Pjesë e rëndësishme e programit kombëtar për eliminimin e punës së fëmijëve, që po zbatohet në MPÇSSHB, është edhe Projekti “Sistemi i Monitorimit të Punës së Fëmijëve në Shqipëri”. Faza e dytë që u miratua në shkurt 2009. Projekti po zbatohet në Tiranë, Korçë, Berat, Elbasan dhe Shkodër duke ndërmarrë veprime dhe aktiviteteve konkrete për tërheqjen nga puna, ri-integrimin e fëmijëve dhe parandalimin e fenomenit. Projekti synon në eliminimin progresiv të formave më të këqija të punës së fëmijëve në Shqipëri duke i propozuar Qeverisë modelin “Sistemi i Monitorimit të Punës së Fëmijëve” i testuar më parë në pesë qytete. 315 fëmijë të përfshirë në format më të këqija të punës, veçanërisht fëmijë që punojnë në rrugë, në bujqësi, fëmijë viktime dhe në rrezik të trafikimit e shfrytëzimit seksual, do të tërhiqen nga puna. Fëmijët e targetuar do të monitorohen derisa të jetë siguruar integrimi i tyre. Në kuadrin e këtij projekti do të sigurohet:

- arsim formal dhe arsim jo-formal në klasa me mësues të specializuar si dhe mbështetje me mjete mësimore për 265 fëmijë;
- formim profesional për një periudhë 3-6 muaj duke i pajisuar me licencë përkatëse 50 fëmijë që kanë mbushur moshën;

- pajisje për 15 fëmijë që kanë ndjekur dhe përfunduar formimin profesional për fillimin e një aktiviteti në fushën e kualifikimit, duke ndihmuar kështu edhe familjet e tyre;
- mundësi formimi profesional për anëtarët e rritur dhe prindërit e fëmijëve që do të trajtohen nga ky projekt, përkundrejt kthimit të fëmijëve në shkollë dhe tërheqjes së tyre nga puna;
- informacion për 300 prindër mbi skemat ekzistuese të ndihmës sociale, ngritjes së vetëdijes mbi pasojat e punës së fëmijëve dhe nevojën e ndërmarrjes së veprimeve konkrete për mbrojtjen e fëmijëve të tyre;
- shërbime ndihme e këshillimi për çdo fëmijë si: këshillim psiko-social, këshillim ligjor, udhëzime për karrierë, aktivitete rikrijuese, mbështetje për të marrë përfitimet ligjore që u takojnë, trajtim mjekësor, etj.

Monitorimi i punës së fëmijëve....

Rezultate të inspektimeve nga Inspektoriati Shtetëror i Punës për punën e zezë të fëmijëve 2008-2009:

Sipas moshës rezulton se fëmijë të evidentuar në punë janë kryesisht ata të moshës:

- 17-vjeç me 54.3%
- 16-vjeç me 18.3%
- 15-vjeç me 1.9%

Nga fëmijët e evidentuar në punë rezulton se pjesa më e madhe është e seksit femër dhe konkretisht , 82.6% e të gjithë fëmijëve janë vajza.

Fëmijë të punësuar sipas llojit të aktivitetit:

- Bujqësi, pyje, peshkim - 23%
- Ndërmarrje prodhuese - 63.7% (Rrobaqepësi - 49.5, Faqe këpucësh -15.7%)
- Ndërtim - 1.8%
- Aktivitete të tjera - 11.5%

Nga këta fëmijë 5.4% janë me arsim fillor, 90% me arsim 8-vjeçar, 4.6% me arsim të mesëm.

86% e fëmijëve që punojnë ishin të siguar dhe 14% e tyre nuk ishin të siguar në momentin e kontrollit. Për fëmijët u morën masat për sigurimin e tyre pranë zyrave të tatim-taksave. Pjesa më e madhe e fëmijëve, rreth 54.3% , janë të moshës 17 vjeç, ndërsa vërehen më shumë vajza, rreth 82.6% që punojnë në sektorin ekonomik.

76% e fëmijëve të evidentuar kanë qënë të punësuar me atozimin e ISHP-së, që kontrollon nëse kushtet e punës janë konform legjislacionit në fuqi për punën e fëmijëve.

2.3 Shpenzimet publike në sektorin e mbrojtjes sociale, veçanërisht për fëmijët dhe tendenca e tij

Tabela Nr. 2.7: Fondet e akorduara të ndihmës ekonomike për familjet gjatë periudhës 2006-2009

Vitet	Fondet e programuara (në miliard lekë)
2006	2.8
2007	2.6
2008	3.4
2009	

Burimi: Përpunuar nga të dhënat administrative të MPCSSH

Tabela Nr. 2.8: Buxheti i akorduar në institucionet e kujdesit publik për fëmijë dhe qendrat e zhvillimit (periudha 2005-2009)

Buxheti sipas viteve (në 000/lekë)	2005	2006	2007	2008	2009
Institucionet publike për fëmijë	27,531	36,920	27,200	30,700	
Qendrat e zhvillimit	52,358	53,280	53,500	62,400	

Burimi: SHSSH

Tabela Nr. 2.9: Shpenzimet publike për realizimin e të drejtës për kujdes të veçantë të fëmijëve të familjeve të varfëra, 2006-2008

Vitet	Ndihma Ekonomike (në 000 lekë)	Nr. i familjeve përfituese	Nr. i personave në këto familje	Nr. i fëmijëve në këto familje	Buxheti për fëmijët (në 000 lekë)
A	b	c	d = c * 4.2	e = c * 2.2	f = (b / d) * e
2006	2,800,000	115,000	483,000	253,000	1,466,667
2007	2,600,000	110,000	462,000	242,000	1,361,905
2008	3,300,000	93,000	390,600	204,600	1,728,571

Burimi: Ministria e Financave, 2006-2008

Përveç shpenzimeve publike, financimi i shërbimeve sociale për fëmijë, është trajtuar me prioritet edhe nga donatorët. Në fushën e shërbimeve sociale është zbatuar projekti: “Shpërndarja e shërbimeve sociale në komunitete”, që synonte ngritjen e shërbimeve komunitare për grupe në nevojë si; fëmijët, gratë, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuar, etj. Ky projekt u financua me: (i) 10 milion USD kredi nga Banka Botërore; (ii)

2.5 milion USD Grant nga Qeveria Britanike (DFID);(iii) dhe 2.5 milion USD nga Qeveria Shqiptare.

Bashkëpunimi me Fondacionin Terre Des Hommes. Duke filluar që nga viti 2001 e deri tani Fondacioni Terre Des Hommes ka filluar zbatimin e projektit TACT (Transnational Action Against Child Trafficking) në Shqipëri. Në vite projekti është mbështetur me fonde nga donatorë si USAID, UNICEF, Austrian Development Agency, Hellenic Aid, Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe Oak Foundation, SIDA, etj.

Në periudhën qershor 2006 – shtator 2009 u zbatua projekti TACT III me një fond prej 3.3 milion USD. Drejtimet kryesore të ndërhyrjes së TACT III ishin:

- ndërhyrje direkte në rrugët dhe komunitetet në Shqipëri dhe në Greqi për të identifikuar fëmijët viktime të trafikimit apo në rrezik trafikimi;
- ngritja e kapaciteteve të strukturave shtetërore në nivel qendror dhe vendor në lidhje me trafikimin e fëmijëve;
- forcimi i komuniteteve Rom dhe Egjyptianë për të frenuar fenomenin e trafikimit të fëmijëve brenda komuniteteve të tyre;
- këshillimi për përmirësimin e politikave shtetërore lidhur me mbrojtjen e fëmijëve.

Shpenzimet për mbështetje në mënyrë të drejtpërdrejtë të fëmijëve të trafikuar dhe në rrezik trafikimi dhe familjeve të tyre kanë qënë:

- 2006 68,264 USD;
- 2007 105,547 USD;
- 2008 82,719 USD.

1. Projekti: “Rritja e kapacitetit të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale në çështjen e luftës kundër punës së fëmijëve në Shqipëri”.

Kontributi i ILO/IPEC: 18.285 USD
Kontributi i MPÇSSHB: 14.000 USD (në natyrë)

2. Projekti: “Rritja e kapacitetit të inspektorëve të punës për të luftuar format më të këqia të punës së fëmijëve”.

Kontributi i ILO/IPEC: 22.700 USD
Kontributi i MPÇSSHB: 17.000 USD (në natyrë)

3. Projekti: “Mbi rishikimin e legjislacionit kombëtar lidhur me punën e fëmijëve, për harmonizimin e tij me standartet ndërkombëtare”

Kontributi i ILO/IPEC: 3.500 USD ILO/IPEC
UNICEF: 2.000 USD

4. Projekti: “Politikat kombëtare mbi luftën kundër punës së fëmijëve dhe eliminimin e formave më të këqia të saj”

Kontributi i ILO/IPEC: 20.000 USD
Kontributi i MPÇSSHB: 23.355 USD

5. Projekti: “Sistemi i Monitorimit të Punës së Fëmijëve”, faza e parë prill 2005 - shkurt 2007. Projekti synoi institucionalizimin e monitorimit të punës së fëmijëve, evidentimin, rishikimin dhe raportimin e arritjeve dhe pengesave në luftën kundër praktikave të rrezikshme dhe shfrytëzuese të punës së fëmijëve, forcimin e kapaciteteve në nivel qendror e lokal, pilotimin në bazë komuniteti në tre rajone Tiranë, Korçë, Berat dhe hartimin e praktikave të mira.

Kontributi i ILO/IPEC: 61.855 USD
Kontributi i MPÇSSHB: 59.000 USD (në natyrë)

6. Projekti: “Sistemi i Monitorimit të Punës së Fëmijëve”, faza e dytë shkurt – dhjetor 2009.

Kontributi i ILO/IPEC: 6.746.200 Lekë
Kontributi i MPÇSSHB: 1.127.000 Lekë (në natyrë)

Buxheti për shërbimin e kujdestarisë për fazën e pilotimit në rrethet Tiranë dhe Shkodër, llogaritet rreth 10 milion lekë çdo vit. Më pas zgjerimi i këtij shërbimi do të kërkojë kosto të tjera shtese. Masa për çdo person të vendosur në kujdestari është llogaritur 3 USD në ditë ose 50 % më shumë se vija e varfërisë.

2.4 Gjetjet e vlerësimit

Duke krahasuar risitë dhe përmirësimet e kuadrit ligjor me aktivitetet e parashikuara në matricën e planit të veprimit të SSHS, vërejmë se ka përputhje të kuadrit ligjor të përmirësuar me objektivat strategjike dhe prioritetet e vendosura në Strategjinë Kombëtare të Fëmijëve dhe Planit të Veprimit.

Evidentohen përmirësime në kuadrin institucional në nivel qendror, rajonal dhe lokal në lidhje me të drejtat e fëmijëve për mbrojtje dhe kujdes shoqëror. Janë krijuar struktura të reja për; (i) vlerësimin e nevojave për shërbime sociale të komunitetit; (ii) monitorimin e zbatimit të standarteve për shërbimet e ofruara; (iii) trajnimin e ofruesëve të shërbimeve.

Ligji për “Për ndihmën dhe shërbimin shoqëror”, i zgjeroi kufijtë e përfitimit për të gjitha grupet në nevojë, dhe krijoi hapësirat e nevojshme për decentralizimin, rritjen e kompetencave të qeverisjes vendore dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile në ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Gjithashtu, është përmirësuar kuadri ligjor për skemën e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale, për ti siguruar ndihmë dhe shërbime shoqërore individëve dhe

grupeve në nevojë, për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore, duke përfshirë edhe fëmijët.

Në kuadrin ligjor janë përfshirë një sërë parimesh të rëndësishme si decentralizimi dhe deinstitutionalizimi i shërbimeve shoqërore, në mënyrë që ai të prezantojë tipologji të reja shërbimesh dhe modele qëndrueshmërie dhe vazhdimësie të këtyre shërbimeve.

Në nivel qendror, janë krijuar struktura të përshtatshme për rregullimin dhe monitorimin e shërbimeve sociale si dhe struktura të përgjithshme menaxhuese për kontaktet me publikun, planifikimin e shërbimeve sociale dhe buxhetimin e tyre. Në nivel rajonal, zyrat rajonale të shërbimeve sociale aktualisht janë të afta të zhvillojnë planet rajonale të përkujdesit komunitar, administrimin efektiv të shërbimeve si dhe monitorimin e shërbimeve të ofruara nga operatorët publik dhe jo-publik.

Gjithashtu është institucionalizuar një sistem bashkëkohor i standarteve të shërbimeve sociale. Në periudhën 2005-2006 janë miratuar nga Keshilli i Ministrave, “Standardet e përgjithshme të shërbimeve Sociale” (SPSHS), si dhe standardet për kategoritë e veçanta si fëmijët, të moshuarit, gratë, personat me aftësi të kufizuara (PAK) etj.

Projekti SHSSH arriti të krijojë një model për shpërndarjen dhe shtrirjen e shërbimeve sociale në çdo komunitet me qëllim mbulimin gjeografik të gjithë rajoneve të Shqipërisë me këto shërbime.

Shoqëria civile dhe veçanërisht OJF-të janë bërë një subjekt i rëndësishëm në zbatimin e një shumëllojshmërie shërbimesh sociale në mbrojtje të fëmijëve. Vlerësimi gjeti që përvojat e tyre të jenë reflektuar jo vetëm në vendosjen e përparësive në strategjite për shërbimet sociale, por edhe në vendosjen e standarteve të këtyre shërbimeve duke krijuar modele të shkëlqyera shërbimesh për grupe të veçanta.

Nga analiza e të dhënave statistikore rezulton 80% e fëmijëve të trajtuar në rrjetin e institucioneve publike dhe jopublike janë trajtuar me shërbime jorezidenciale. Ky tregues dëshmon për përvijimin e tendencës pozitive të deinstitutionalizimit të shërbimeve dhe rritjen graduale të peshës specifike të kujdesit jorezidencial.

Sistemi i mbrojtjes sociale synon të sigurojë mbështetje me shërbime për të gjithë individët në nevojë, me qëllim integrimin e tyre në jetën shoqërore, dmth “Një sistem kombëtar të qëndrueshëm të shërbimeve të përkujdesit social”.

2.5 Rekomandime

Programi i ndihmës ekonomike duhet të adresojë nevojat e fëmijëve dhe të ketë impakt të dukshme në zbutjen e varfërisë dhe parandalimin e fenomeneve sociale negative që afektojnë fëmijët e varfër. Programi i Ndihmës ekonomike duhet ripare në mënyrë që të marrë në konsideratë nevojat e fëmijëve dhe të kushtëzohet me përmbushjen e këtyre nevojave nga familjet përfituese.

Njësitë e qeverisjes vendore duhet të itensifikojnë përpjekjet për marrjen e përgjegjësiwe financiare, reformimin e institucioneve rezidenciale dhe ngritjen e shërbimeve të reja në përputhje me dinamikën e nevojave të fëmijëve në nevojë në komunitet e tyre.

Duhet të vihen në funksionim funksionet e Sektorit të shërbimeve sociale pranë Qarkut, si një strukturë e domosdoshme që do të mundësojë krijimin e një sistemi vlerësimi e monitorimi të nivelit të varfërisë në nivel qarku, krijimin e një baze të dhënash për grupet në nevojë, familjet e varfëra dhe individët që kanë nevojë për shërbime shoqërore, duke bërë vlerësimin e nevojave dhe me pas në varësi të tyre ngritjen e shërbimeve të reja në përputhje me mundësitë dhe burimet.

Duhet të vazhdojë koordinimi ndërmejt pushtetit lokal, OJQ-ve dhe donatoreve për ngritjen e modelit të “shtëpive familje”, dhe sigurimit të vazhdueshmërisë së këtij modeli dhe shtrirjes së tij në të gjithë vendin.

Marrja e masave për të ulur numrin e veprave penale nënë 14 vjeç dhe shtimi i rasteve të dënimeve alternative.

Njësitë e qeverisjes vendore duhet të marrin përgjegjësi financiare për funksionimin e shërbimeve komunitare të ngritura nga projekti i Shpërndarjes së Shërbimeve Sociale, për të siguruar qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e këtyre shërbimeve.

Metodologjia DevInfo si një mekanizëm efektiv në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave social ekonomike të njësive administrative duhet të vazhdojë të shpëndahe edhe në rrethet e tjera të vendit.

Të ngrihen qendrat e specializuara, për viktimat e dhunës në familje (fëmijë, gra) nga pushteti vendor pasi shërbimet që ofrojnë OJF-të për këto raste, janë të pamjaftueshme dhe jo të shtrira në të gjithë territorin e vendit.

Planifikimi i burimeve financiare në nivel qendror dhe lokal për politikën e mbrojtjes dhe kujdesit social për fëmijët në rrezik duhet të mbështetet mbi analizën e nevojave.

Integrimi i femijeve të përjashtuar në jetën normale është objektiv i gjithë shoqërisë, që mund dhe duhet të arrihet. Për të arritur këtë, Qeveria dhe në mënyrë të veçantë MPÇSSHB duhet të punojë për sensibilizimin e të gjithë shoqërisë, vetëm në këtë mënyrë kostoja e ri-integrimit do të shëndrohet në përfitim shoqëror.

Të hartohen politika të veçanta kombëtare për të luftuar punën e detyruar dhe gjitha format e shfrytëzimit të fëmijëve, fenomen shumë shqetësues që cënon të gjitha të drejtat e fëmijës (mbijetesë, zhvillim, mbrojtje dhe pjesëmarrje).

Institucionalizmi i mekanizmit të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në nivel qendror dhe vendor me kalimin në parlamentet të Ligjit Kuadër për të Drejtat e Fëmijës.

Implementimi i shërbimit të kujdestarisë për fëmijët si një nga alternativat më të mira në interesin më të lartë të fëmijës.

Përmirësimi i shërbimeve të ofruara në qendrat rezidenciale për fëmijë.

Të shtrihen shërbimet e specializuara për fëmijët në zonat rurale për identifikimin e hershëm të fëmijëve me probleme (mendore, fizike, etj).

KAPITULLI III: E DREJTA PËR ARSIM CILËSOR

Drejtimi themelor politik afatgjatë për arsimimin në vendin tonë, i përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës është zhvillimi i një sistemi arsimor sipas standardeve arsimore europiane. Objektivat kryesor për arsimin parauniversitar janë formuluar në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2004-2015 (miratuar me VKM Nr. 538, datë 12. 08. 2004) ku theksohet garantimi i aksesit në të gjitha nivelet e arsimit dhe reforma kurrikulare e strukturore e arsimit parauniversitar, për zgjatjen e arsimit të detyruar nga 8 - 9 vjet. Këto janë në përputhje edhe me objektivat e SKF, sipas të cilës synohet sigurimi i funksionimit të një sistemi arsimor cilësor dhe gjithëpërfshirës.

Në vitin shkollor 2008-2009, u realizua kalimi nga arsimi bazë 8-vjeçar në atë 9-vjeçar dhe nga arsimi i mesëm 4-vjeçar në atë 3-vjeçar. Kjo masë kishte si qëllim të reflektonte realizimin e të drejtës për arsimim duke rritur kohën e arsimimit të detyruar. Kalimi në sistemin 9-vjeçar u shoqërua me reforma të reja si në sistemin e hartimit dhe përgatitjes së programeve të reja ashtu dhe në atë të liberalizimit të teksteve shkollore. Korniza e re e programeve mësimore reflektoi ndryshimet e nevojshme bazuar në sistemin 9-vjeçar të arsimit të detyruar si dhe krijoi hapësirë që 10% e programit mësimor të përgatitet në bazë shkolle, duke i dhënë shkollës dhe nxënësve mundësinë për të zhvilluar aktivitete vjetore në formë projektesh sipas nevojave dhe interesave të nxënësve. Kjo politikë e re kërkoi një trajnim intensiv të mësuesve, në vijim të një politike 3 vjeçare që tashmë po zbatohet nga MASH lidhur me kualifikimin e të gjithë mësuesve të të gjithë cikleve mësimorë.

Liberalizimi i teksteve shkollore, një reformë gjithashtu e re synon të nxisë konkurrencën e lartë në hartimin e teksteve shkollore, për rrjedhojë rritjen e cilësisë së tyre, duke siguruar alternativa tekstesh në treg të cilët përzgjidhen nga shkollat dhe mësuesit e lëndëve. I gjithë sistemi arsimor parauniversitar punon tashmë me tekste alternative në të gjitha lëndët. Procesi i liberalizimit të teksteve shkollore që shënon kalimin nga përdorimi i një teksti në përzgjedhjen e tekstit mësimor nga vetë mësuesi shënon një hap të rëndësishëm në rritjen cilësore të procesit mësimor edukativ, por njëkohësisht si çdo reformë kërkon monitorim dhe menaxhim të kujdesshëm nga MASH.

Niveli i regjistrimit në shkollë për arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar, në vitin 2008 është 94%, ndërsa për arsimin e mesëm 70%. Popullimi i klasave vazhdon të mbetet problem. Për vitin 2008 në arsimin e detyruar 9-vjeçar, raporti nxënës/klasë është 27 nga 22 që ishte në vitin 2007, ndërsa në arsimin e mesëm ky raport është 30. Raporti nxënës/mësues, në arsimin 9-vjeçar mbetet i pandryshuar 17 dhe ka shënuar përmirësim në arsimin e mesëm në 16 nxënës/mësues për vitin 2008 nga 20 që ishte në vitin 2007.

Investimet publike për rikonstruksion, ndërtim godinash të reja, pajisje me mjete didaktike, janë rritur në 6 miliard lekë nga 4 miliard lekë në 2008. Kjo tregon një tendencë pozitive në drejtim të ngritjes dhe rikonstruktimit të shkollave sipas standarteve të miratuara nga MASH, por jo në pak raste ka pasur shqetësime lidhur me kushtet e

këqija higjeno-sanitare dhe sigurinë fizike në disa shkolla dhe kopshte të vendit, sidomos me ato që ndodhen në zonat rurale dhe veriore.

Në vitin 2008, niveli i rregjistrimit të fëmijëve në arsimin parashkollor është 53%, një shifër jo shumë e lartë dhe pothuajse e njëjtë në 5 vitet e fundit. Politika e MASH për t'i dhënë përparësi klasave përgatitore në arsimin parashkollor për fëmijët 5-6 vjeç, ndonëse një politikë që u eksperimentua në disa shkolla të vendit gjatë vitit 2008, duket të ketë një tendencë pozitive në rritjen e nivelit të arsimimit të fëmijëve 5-6 vjeçarë duke i përgatitur më mirë dhe duke lehtësuar kalimin në ciklin e ulët të arsimit të detyruar. Implementimi i kësaj politike do të sjellë kohëzgjatje të arsimit të detyrueshëm dhe njëkohësisht kërkon përgatitjen dhe përshtatjen me të mirë të mësuesve, përmirësimin e mjediseve shkollore (klasave, banjave) sipas nevojave për zhvillimin dhe edukimin e 5-6 vjeçarëve .

Përfshirja e të gjithë fëmijëve në arsimin e detyrueshëm mbetet akoma një objektiv për realizimin e të cilit kërkohet shumë angazhim. Braktisja shkollore në shkallë vendi është 0.86%, dhe në zonat rurale llogaritet pak më e lartë rreth 1.1%.

Përfshirja e fëmijëve rom dhe me aftësi të kufizuar në sistemin arsimor të detyruar, megjithë përpjekjet e vazhdueshme të MASH, vazhdon të mbetet një çështje kritike. Niveli i arsimimit të tyre është shumë i ulët, përgatitja e mësuesve për trajtimin e këtyre kategorive është e pamjaftueshme dhe këta fëmijë vuajnë nga stigmatizimi.

Përmirësimi i aksesit të fëmijëve ndaj teknologjisë së informacionit është një objektiv shumë i rëndësishëm i Qeverisë, MASH dhe SKF. Në kuadër të projektit TIK (Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit), me një buxhet të konsiderueshëm prej 59 milion Euro, janë pajisur me kabinate informatikë të gjitha shkollat e mesme të vendit dhe po vazhdon puna në shkollat e arsimit bazë. Në vitin 2009, raporti nxënës/kompjuter është 25 kundrejt 61 që ka qënë në vitin 2007.

3.1 Shpenzimet buxhetore për të drejtën për arsim

Më poshtë jepet tabela për buxhetin e alokuar për MASH. Pjesa më e madhe e shpenzimeve të MASH shkon për arsimin parauniversitar. Nga të dhënat rezulton se buxheti i MASH ka pësuar një rritje graduale nga viti në vit, si në shifër absolute ashtu edhe në përqindje ndaj shpenzimeve të buxhetit të shtetit dhe PBB. Megjithatë shifra 3.5% e PBB-së, mbetet një shifër e ulët në krahasim me sfidat e MASH-it për të siguruar një sistem arsimor sipas standarteve evropiane.

Tabela Nr. 3.1: Buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për periudhën 2004-2009 (në lekë)

Programet buxhetore në arsim	Viti 2004	Viti 2005	Viti 2006	Viti 2007	Plani 2008	Plani 2009
Buxheti i MASH	23.976.857	25.440.000	26.188.115	29.752.145	37.008.924	41.464.211

Buxheti i arsimit parauniversitar	19.891.971	20.577.130	21.184.769	24.209.198	29.646.973	31.264.211
Buxheti i arsimit parauniversitar në % ndaj Buxhetit të MASH	83%	81%	81%	81%	80%	75%
Produkti i Brendshëm (në mijë lekë)	795.035.050	836.879.000	899.700.000	982.200.000		1.180.000.000
Buxheti i Shtetit (në mijë lekë)	220.722.050	232.339.000	266.751.000	300.303.000	354.760.000	384.834.000
Buxheti i MASH ndaj shpenzimeve të buxhetit shtetit (në %)	9,0%	8,9%	7,9%	8,1%	8,4%	10,8%
Buxheti i MASH ndaj PBB (në %)	3,0%	3,0%	2,9%	3,0%	3,4%	3,5%

3.2 Objektivat e Strategjisë Kombëtare për Fëmijët në lidhje me realizimin e të drejtës për arsim cilësor

Objektivi 1: Reformimi dhe fuqizimi i kapacitetit menaxhues të sistemit arsimor.

Objektivi 2: Përmirësimi i cilësisë së procesit mësimor (mësimdhënie dhe mësimnxënie).

3.3 Vlerësimi i zbatimit të objektivave të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët në lidhje me realizimin e të drejtës për arsim cilësor

Objektivi 1: Reformimi dhe fuqizimi i kapacitetit menaxhues të sistemit arsimor.

3.3.1 Sigurimi i funksionimit të një sistemi arsimor cilësor gjithëpërfshirës

Për identifikimin sa më të hershëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe trajtimin individual të tyre, MASH në bashkëpunim me Save the Children po punon në 6 DAR, përkatësisht në Tiranë, Elbasan, Berat, Shkodër, Vlorë, Gjirokastrë dhe Korçë. Projekti është shtrirë në 34 shkolla 9-vjeçare dhe në 27 kopshte. Në to trajtohen me plane edukative individuale 343 nxënës me aftësi të kufizuara dhe 219 fëmijë të kopshtit.

Këtë vit janë ngritur 4 shkolla dhe 4 kopshte të reja në Gjirokastrë, 3 shkolla dhe 3 kopshte të reja në Korçë dhe 5 shkolla dhe 5 kopshte të reja në Vlorë.

Ka përfunduar hartimi i programeve të reja mësimore për të gjitha klasat e arsimit të detyruar të minoriteteve.

Sipas studimit: “Situata arsimore e fëmijëve romë në Shqipëri”(2007), të Qendrës për Zhvillime Humane, vetëm 27% e fëmijëve romë në moshën 6 vjeç ndjekin klasën e parë dhe 13.5% e fëmijëve romë 3-5 vjeç ndjekin arsimin parashkollor. Aktualisht 54% e fëmijëve romë që janë aktualisht në moshën e detyrimit shkollor 6-16 vjeç nuk kanë përfunduar asnjë klasë shkollë. Niveli i regjistrimit të fëmijëve romë në shkollë në moshën e caktuar sipas ligjit është i ulët dhe cilësia e arsimit që fëmijët romë arrijnë të marrin është dukshëm më e ulët se ajo që marrin fëmijët joromë. Arsytet e mosfrekuentimit të rregullt të shkollës ose të braktisjes së saj nga fëmijët romë janë: mosregjistrimi i lindjeve në zyrat e gjendjes civile, emigrimi, përfshirja në punë ose në ndihmë të prindërve që punojnë, mosnjohja e gjuhës shqipe, rezultatet e pakënaqshme shkollore, turpi për ta rivazhduar shkollën pas ndërprerjeve, nevoja për t’i mbrojtur vajzat që hyjnë në adoleshencë, mbështetja e ulët prindërore për shkollimin, mungesat materiale.

Sipas këtyre të dhënave, por edhe sipas studimit të MASH “Situata arsimore e fëmijëve romë në Shqipëri” arsimimi i fëmijëve romë është në një gjendje aspak të kënaqshme. Për këtë arsye të gjitha DAR dhe ZA kanë programuar punën për përfshirjen me prioritet të fëmijëve romë në kopshte dhe shkolla.

Me fonde nga MASH dhe partnerët, janë hapur kopshte në Fier, Korçë, Berat si dhe po ndiqet në vazhdimësi ecuria dhe frekuentimi i fëmijëve romë në kopshte dhe shkolla. Në zbatim të Udhëzimit të MASH Nr.32, datë 28. 08. 2008, për vitin shkollor 2008–2009, “Ulja e numrit të nxënësve që kanë braktisur shkollën apo që kanë tendenca braktisjeje”, sektorët e kualifikimit në DAR/ZA kanë hartuar dhe po zbatojnë plane të veçanta trajnimi me mësuesit për punën me nxënësit e marginalizuar, bazuar në problemet specifike që ka gjithsecili. DAR/ZA informojnë dy herë në vit për kontingjentin e nxënësve braktisës ose që i janë rikthyer shkollës. Në këtë kuadër MASH mbështetet edhe nga organizatat Save the Children, UNICEF, “Ndihmë për fëmijët”, “Fëmijët e botës dhe të Shqipërisë”, etj..., të cilat kanë orientuar veprimtaritë e projekteve në drejtim të arsimimit të fëmijëve romë në të gjithë sistemin e edukimit parauniversitar.

Në zbatim të projektit “Shansi i Dytë”, MASH ka planifikuar në vazhdimësi buxhetin për mbështetjen e mësuesve që punojnë me nxënësit që kanë braktisur shkollën apo që kanë tendencë braktisjeje. Në të gjitha DAR/ZA funksionojnë klasat me nxënës që i janë rikthyer shkollës në kuadër të këtij projekti. Këto klasa ndiqen nga 513 nxënës të moshës 10–15 vjeç dhe janë të shtrira në të gjithë vendin.

Në planin ligjor, për mbrojtjen më të mirë të të drejtave të fëmijëve, MASH është në proces të rishikimit të Ligjit të Arsimit Parauniversitar dhe Dispozitave Normative të Shkollës.

3.3.2 Pasqyrimi i të drejtave të fëmijëve në veprimtarinë e shkollës

Veprimtaria e shkollave pilot të EDNJ në të 37 rrethet vazhdon dhe pasurohet vit pas viti. Përvojat e reja të krijuara gjatë zbatimit të projekteve dhe në përfundim të tyre vazhdojnë të zbatohen dhe të shtrihen edhe në shkolla të tjera siç është rasti i projektit “Edukimi për të Drejtat dhe Demokracinë”, projekt i mbështetur nga UNESCO.

EDNJ është përfshirë në kurrikulën e arsimit të detyruar, ç’ka do të thotë që në kurrikulat lëndore të edukatës shoqërore, edukatës qytetare, në gjuhën amtare, gjuhë e huaj, histori, gjeografi, biologji, arte, edukim fizik përfshihen natyrshëm të drejtat e fëmijëve. Gjatë këtij viti një mbështetje të fuqishme në zhvillimin e moduleve për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve kanë luajtur dhe orët e lira.

Instituti i Kurrikulave dhe Trajnimeve në mbështetje të rritjes dhe fuqizimit të pjesëmarrjes së fëmijëve në mbrojtjen e mjedisit, edhe në kuadër të projektit CLEEN, ka realizuar botimin “Edukimi mjedisor në ciklin fillor”. Në kuadër të këtij projekti vetë fëmijët janë bërë promotorë dhe zbatues të veprimtarive që ruajnë dhe mbrojnë mjedisin përreth shkollës dhe komunitetit.

Tashmë ka hyrë në traditën e DAR, ZA dhe drejtorive të shkollave, organizimi i konkurseve lokale me tematika të ndryshme, ndër të cilat dhe njohja, promovimi dhe zbatimi i të drejtave të fëmijëve.

Objektivi 2: Përmirësimi i cilësisë së procesit mësimor (mësimdhënie dhe mësimnxënie)

3.3.3 Përmirësimi i infrastrukturës shkollore

Në vitin 2009 buxheti i MASH për investime (rikonstruktim, ndërtim godinash të reja, pajisje) është rritur në 6 miliard lekë nga 4 miliard lekë në 2008. Gjatë vitit shkollor 2008-2009 përfundua së ndërtuari dhe rikonstruktuari 116 kopshte dhe shkolla dhe janë në proces përfundimi 63 objekte të tjera. Në vazhdimësi po zbatohen standardet e ndërtimit të objekteve shkollore dhe kopshteve, por jo në pak raste jemi ndeshur me cilësi të dobët në ndërtimin e këtyre objekteve.

Një risi, zbatimi i të cilës duhet të monitorohet nga organet kompetente, është respektimi i standardeve të ndërtimit në projektimin dhe zbatimin e projekteve e shkollave dhe kopshteve, për t’ju shërbyer fëmijëve me nevoja të veçanta.

Në raportin e hartuar nga grupi i fëmijëve 16+, të cilët synojnë të paraqesin situatën e realizimit të të drejtave të fëmijëve në shkollat e Elbasanit, Dibrës dhe Durrësit theksohet mungesa e terreneve sportive dhe e sistemeve të ngrohjes në shkolla. Vështirësi hasin edhe fëmijët që mbarojnë arsimin e detyruar në zonat rurale, pasi e kanë pamundur të vazhdojnë arsimin e mesëm për arsye të mungesës së shkollave të tilla në këto zona.

3.3.4 Përmirësimi i programeve arsimore

Në vitin shkollor 2008–2009 hyri në fuqi sistemi arsimor 9-vjeçar dhe po zbatohet kurrikula e re e arsimit të detyruar. Kurrikula e re përbëhet nga kurrikula bërthamë e detyrueshme për të gjithë nxënësit dhe ajo opsionale që përzgjidhet nga nxënësit. Kurrikula opsionale përbëhet nga lëndët me zgjedhje me dy nivele. Në nivelin e parë janë lëndët me zgjedhje dhe projektet kurrikulare, ndërsa në nivelin e dytë janë veprimtaritë ekstrakurrikulare si angazhime në komunitetin shkollor.

Përveç ndryshimeve të nevojshme në kornizën kurrikulare dhe përmbajtjen e saj, risia që solli kjo reformë ishte edhe krijimi i hapësirës që 10% e kurrikulës të programohet në bazë shkolle, duke i dhënë shkollës dhe nxënësve mundësinë për të zhvilluar aktivitete vjetore, në formë projektesh apo programesh, sipas nevojave dhe interesave të komunitetit të nxënësve. Zbatimi i kurrikulës së re është shoqëruar me trajnimin intensiv të mësuesve.

Në përfundim të këtij viti shkollor, për herë të parë do të zbatohet modeli i maturës në provimet e lirisimit duke siguruar një objektivitet dhe transparencë më të madhe në vlerësimin e njohurive të nxënësve në përfundim të arsimit të detyruar. Në kuadër të reformimit të gjimnazit dhe reformës kurrikulare, ka përfunduar hartimi i dokumenteve kryesorë që hedhin themelet e reformës si: “Korniza kurrikulare e gjimnazit”, “Standardet e fushave kurrikulare dhe lëndore” dhe “Programet e klasës së 10-të”.

Në zbatim të rekomandimeve të Komitetit të Gjenevës, të politikave të zhvillimit të arsimit parashkollor, dhe në veçanti të objektivit të përfshirjes me përparësi të fëmijëve 5-6 vjeçar në një vit përgatitor në sistemin e arsimit të detyruar, këtë vit po pilotohet funksionimi i 50 klasave përgatitore, pranë shkollave 9-vjeçare, në 13 DAR dhe në 2 ZA. Këto klasa frekuentohen nga 1300 fëmijë të moshës 5-6 vjeçare. Në vitin shkollor 2009 - 2010 është parashikuar të hapen dhe 50 klasa të tjera përgatitore. Aktualisht 63% të fëmijëve 5-6 vjeçar dhe 50% të grupmoshës 3-5 vjeç, ndjekin kopshtin.

3.3.5 Përmirësimi i aksesit të fëmijëve ndaj teknologjisë së informacionit

Në kuadër të projektit “Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit”, janë pajisur me kabinete informatikë të gjitha shkollat e mesme të vendit, gjithsej 379 kabinete. Ndërkohë, 37 shkolla të mesme funksionojnë me nga 2 kabinete.

Në vitin shkollor 2008-2009 janë instaluar 665 kabinete informatike në shkollat e arsimit bazë me 6600 kompjutera personalë. Në 1081 shkolla të arsimit parauniversitar po shpërndahen 2000 laboratorë të lëvizshëm (1 laptop +1 dixhital projektor + 1 CD me materiale multimediale mësimore) me vlerë afro 1 milionë Euro. Në vitin 2009, raporti nxënës / kompjuter është 25 kundrejt 61 që ka qënë në vitin 2007. Një nga synimet e MASH me këtë projekt është zgjerimi i përmbajtjes multimediale në shkolla, me qëllim

përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Do zgjerohet përmbajtja e programeve dixhitale me module të tjera arsimore të cilat do të jenë të shqipëruara dhe të moduluara në përputhje me kurrikulën mësimore.

Njëkohësisht po realizohet nga Instituti i Kurrikulës dhe Standardeve trajnimi i mësuesve mbi përdorimin e laboratorëve virtualë. Deri më sot nga ky Institut janë trajnuar mbi 700 mësues në Tiranë dhe rrethe të tjera.

3.3.6 Përfshirja e fëmijëve në vendimarrje në nivel shkollë

Qeveria e Nxënësve është organi nëpërmjet së cilit bëhet më i dëgjueshëm pjesëmarrja e nxënësve në vendimarrje. Në kuadër të realizimit të moduleve të ndryshme në orët e ekstrakurrikulare, mësuesit vlerësojnë mendimin e nxënësve për tematikat që trajtojnë.

Për të fuqizuar vendimarrjen e nxënësve në shkollë, në udhëzimin e vitit të ri shkollor është theksuar domosdoshmëria e funksionimit të Qeverive të Nxënësve dhe ndjekjen e tyre nga një specialist i DAR dhe ZA. Aktualisht janë në proces përpunimi Dispozitat Normative të arsimit parauniversitar, në të cilat do të shtohen nene të reja në fuqizim të QN dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë së tyre, mbështetur në projektet pilot të realizuara.

MASH në bashkëpunim me Save the Children vazhdon veprimtaritë kualifikuese me mësues koordinatorë, drejtues shkollash dhe përfaqësues të Qeverisë së Nxënësve, për fuqizimin e veprimtarisë së këtyre të fundit.

Në vitin 2009 vazhdoi zbatimi i fazës së dytë të Projektit Clean, projekt i përbashkët i MASH, Ministrisë së Mjedisit dhe UNICEF i financuar nga Ambasada e Mbretërisë Holandeze. Në projekt janë përfshirë 240 shkolla të rretheve Durrës, Shkodër, Lezhë, Tiranë, Korçë dhe janë trajnuar 650 mësues. Ka filluar faza në të cilën nxënësit, mësuesit dhe komunitetet në shkollat e mësipërme, po punojnë për zbatimin e një projekti të përbashkët për të mbajtur pastër mjedisin nëpërmjet riciklimit të mbeturinave. Zbatimi i këtij projekti po krijon modele të mira të rolit aktiv dhe pjesëmarrës të nxënësve në jetën e shkollës dhe komunitetit.

Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në shkolla përmes 57 qeverive të nxënësve ka nxitur përfshirjen në këto aktivitete të 15000 fëmijëve romë dhe me aftësi të kufizuara. Gjatë kësaj periudhe fëmijët janë bërë pjesë dhe janë përfshirë në procesin e vendimarrjes, në planet e shkollës, përmirësimin e ambientit, zgjidhjen e konflikteve, braktisjen shkollore dhe përfshirjen e fëmijëve romë në veprimtaritë ekstrakurrikulare.

Gjithashtu me mbështetjen e Save the Children është realizuar botimi i një gazete për fëmijët dhe të rinjtë si suplement i gazetës kombëtare “Mësuesi”. Në gazetën e tyre fëmijët adresojnë të drejtat, problemet që ndeshin dhe informojnë në lidhje me të drejtën e pjesëmarrjes çdo muaj.

3.3.7 Rritja e nivelit të formimit dhe trajnimit të mësuesve

Në vijim të zbatimit të kurrikulës së re në arsimin bazë dhe në gjimnaz, IKT ka zhvilluar një veprimtari të pasur trajnuese me mësuesit e të gjithë cikleve të arsimit parauniversitar. Në ndihmë të mësuesit për zbatimin e kurrikulës së re në arsimin parauniversitar, IKT ka realizuar gjatë këtij viti 32 botime, midis tyre: Modulet për trajnimin e drejtorëve të shkollave të arsimit parauniversitar; 17 botime për të gjitha lëndët e kurrikulës së arsimit parauniversitar; Korniza kurrikulare e gjimnazit; Standardet e nxënies në gjimnaz; etj.

Si botim i rëndësishëm për mësuesit është cilësuar edhe “Përvojat e mësimit nga vendet perëndimore”, një përmbledhje me plane mësimore nga të gjitha vendet e përparuara dhe në një mori lëndësh.

Procesi i reformimit të karrierës së mësuesit të arsimit parauniversitar është në vitin e tretë të zbatimit. Këtë vit janë miratuar procedurat sipas të cilave institucionalizohet trajnimi i mësuesve edhe në nivel lokal. Për çdo mësues është parashikuar një buxhet individual për trajnimin e tij duke përfshirë të gjithë ciklet. IKT dhe agjensi të tjera kanë hartuar programe trajnimi dhe module të detyruara kualifikimi. Këtë vit përfunduan procedurat për realizimin e këtij sistemi, sipas të cilit i jepet mundësi të gjithë mësuesve edhe në zonat më të thella të vendit të shprehin nevojat e tyre për trajnim dhe në bazë të tyre DAR dhe ZA të ofrojnë trajnimin e kërkuar.

Tashmë janë hartuar portofolet e mësuesve për të gjitha ciklet. Në mars është zhvilluar testimi për karrierë i 2436 mësuesve nga të gjitha ciklet e arsimit parauniversitar në 13 DAR. Në përfundim të vlerësimit, mësuesit që do të kalojnë me sukses këtë testim pajisen me çertifikatë e cila mbështet rritjen e pagës. Ky kualifikim siguron përshtatjen e profilit të mësuesve me kornizën kurrikulare sipas të cilës ato ushtrojnë mësimit.

Gjatë vitit 2008 janë trajnuar 400 mësues për metodat e mësimit me në qendër fëmijën, duke u fokusuar tek edukimi i fëmijëve me probleme dhe vështirësi në të nxënë. Si rezultat i trajnimeve, vlerësohet se 85000 fëmijë kanë përfituar nga metodat e reja të mësimit. Në bashkëpunim me Institutin e Kurrikulës dhe Standateve është organizuar një seminar me pjesëmarrje të drejtorëve, zv/drejtorëve dhe përfaqësues të qeverisë së nxënësve për hartimin e planit të zhvillimit të shkollave, me qëllim një menaxhim dhe drejtim efikas të shkollave.

MASH në bashkëpunim me MASH Kosovë, vazhdon edhe këtë vit procesin e trajnimit të mësuesve që punojnë me nxënës shqiptarë në diasporë si dhe po punon për hartimin e programeve mësimore dhe teksteve shkollore.

3.4 Gjetjet e vlerësimit

Reforma në arsimin 9-vjeçar, është bazuar në përmirësimin e kurrikulës, liberalizimin e teksteve shkollore, përmirësimin e infrastrukturës dhe kualifikimin e mësuesve. Të

intervistuarit vlerësojnë pozitivisht mënyrën e hartimit të kurrikuave të reja, pasi kjo i jep mundësi përfshirjes së fëmijëve, stafeve pedagogjike dhe komunitetit në hartimin e një pjese të kurrikulës, duke synuar të rrisë cilësinë e mësimdhënies si dhe duke i dhënë shkollës mundësi për të qënë më pranë nevojave të nxënësve dhe komunitetit që e rrethon. Mënyra e re e hartimit të kurrikulave është zbatuar për herë të parë këtë vit dhe sigurisht është një proces që ka nevojë të përmirësohet në vitet në vijim.

Sipas fëmijëve të intervistuar, ata e vlerësojnë këtë reformë, por gjithashtu shprehen se kurrikulat e reja janë shumë të ngarkuara dhe të mbushura me terma të vështirë për t'u kuptuar nga ata.

Zbatimi i ndryshimeve kurrikulare duhet të mbështetet edhe nga ndryshime të tjera brenda shkollës. Sipas të intervistuarve kurrikulat e reja nuk gjejnë hapësira për zbatim në infrastrukturën aktuale të shkollës, p.sh megjithëse në kurrikula janë vendosur module për lëndë profesionale këto nuk mund të zbatohen, pasi mungojnë kushtet dhe pajisjet në shkolla. Shkollat tashmë duhet të mendojnë për pasurimin me kabinete, biblioteka, mjedise pune, pajisje të tjera të reja për t'ju përshtatur kërkesave mësimore.

Sipas të dhënave të MASH, zëri buxhetor për përmirësimin e infrastrukturës shkollore është rritur edhe për vitin 2009. Shkollat e reja dhe shkollat që po rikonstruktohen duhet t'i nënshtrohen standarteve të reja të ndërtimit të miratuara nga MASH. Përmirësimi i infrastrukturës së shkollës prek në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të përditshme jetën e fëmijëve në shkolla dhe kjo është një pikë ku mësuesit dhe nxënësit shprehen se ka nevojë për përmirësim të mëtejshme thelbësore dhe cilësore.

Përmirësimi i kushteve higjienike, vendosja e funksionimi i sistemit të ngrohjes, ngritja e mjediseve sportive, mjediseve të gjelbra, janë kërkesat kryesore të të intervistuarve, të cilat i kanë bërë me dije edhe në nivelet drejtuese të shkollave, njësive të pushtetit vendor dhe strukturave qendrore.

Përmirësimi i aksesit në teknologjinë e informacionit shihet si një arritje pozitive. Kabinetet e informatikës janë shtrirë në një pjesë të madhe të shkollave dhe mbulojnë pothuajse të gjithë territorin e vendit, por aksesit i fëmijëve në to dhe përdorimi i teknologjisë mbetet i kufizuar. Lidhja e internetit sidomos në zonat rurale është e pjesshme, dhe mësuesve të informatikës i mungon përgatitja e duhur për këtë lëndë.

Reforma e Altertekstit (përzgjedhja e teksteve) ka ngjallur jo pak reagime në opinionin publik dhe në media, lidhur me cilësinë e disa teksteve të përzgjedhur. Për këtë arsye të intervistuarit theksojnë se përfshirja e specialistëve të lëndës duhet të jetë më e madhe në procesin e përzgjedhjes së teksteve dhe kjo të mos jetë vetëm në dorë të mësuesve të shkollës.

Të pyetur se çfarë ndikimi kanë pasur reformat arsimore në përmirësimin e cilësisë së mësim marrjes/dhënies gjatë periudhës 2006-2009, të intervistuarit janë shprehur se kualifikimi dhe trajnimi i mësuesve ka pasur një ndikim pozitiv. Është përshtatur profili i

mësuesve me kuadrin mësimdhënës, pra tashmë shumica e mësuesve janë brenda profilit të lëndës që ata japin në shkollë.

Këtë vit ka filluar institucionalizimi i kualifikimit të mësuesve edhe në nivel lokal. Për çdo mësues në vend është parashikuar një buxhet individual për trajnimin e tij. IKT dhe agjensi të tjera kanë hartuar programe trainimi dhe module të detyruar kualifikimi. Megjithatë mësuesit shprehen se kanë nevojë për trajnime të mëtejshme veçanërisht për hartimin e moduleve të lëndëve më zgjedhje apo hartimin e projekteve.

Nxënësit shprehen se përveç rritjes së kapacitetit profesional të mësuesve të lëndës, metoda e mësimdhënies duhet të jetë më tepër aktive duke e përfshirë nxënësin më tepër dhe duke u dhënë lirshmërinë dhe hapësirën e nevojshme për tu shprehur, duke mos i lënë ata vetëm në pozitën e dikujt që dëgjon në mënyrë pasive.

Problem për nxënësit mbetet pjesmarrja e tyre në kurset private që organizohen nga mësuesit e lëndës, pasi mosmarrja pjesë në këto kurse mund t'i penalizojë me nota jo të mira e jo objektive.

Dhuna verbale dhe emocionale ndeshet shpesh në shkolla, ndërsa ajo fizike më rrallë.

Shërbimi psikologjik në shkolla vlerësohet si një risi e mirëpritur si nga nxënësit ashtu edhe nga stafi pedagogjik i shkollës, por numri i profesionistëve në shkolla është i kufizuar. Një psikolog mbulon afërsisht 3 shkolla, duke e mbingarkuar atë dhe duke mos i dhënë mundësi të trajtojë çështjet e të gjithë fëmijëve, por të bëjë një përzgjedhje të rasteve të vështira të cilat kërkojnë më shumë vëmendje për tu trajtuar, dhe që kryesisht parashtrihen nga stafi pedagogjik dhe jo nga vetë fëmijët. Kjo bën që nxënësit të kërkojnë në mënyrë spontane ndihmën e psikologut për problemet e përditshme që mund t'i shqetësojnë. Në këtë mënyrë është e vështirë që të vendoset një ndjenjë besimi reciprok ndërmjet nxënësit dhe psikologut, ku nxënësit të përfitojnë më të vërtetë nga ky shërbim.

Në ndihmë të fëmijëve të neglizhuar apo që kanë braktisur më parë arsimin e detyruar, MASH ka ndërmarrë një iniciativë e re " Braktisje zero në arsimin 9 vjeçar". Aktualisht përveç projekteve të OJF-ve, nga MASH po zbatont edhe projektin "Shansi i Dyte", i cili vlerëson se ka pasur rritje të numrit të nxënësve që e frekuentojnë, por nuk është i shtrirë në të gjithë vendin dhe fëmijët që ndjekin këtë rrugë të edukimit nuk regjistrohen në amza dhe nuk pajisen me dëftesa. Ka raste të mësuesve pa kualifikimin e nevojshëm për të punuar me këtë kategori fëmijësh.

Për mbështetjen e fëmijëve romë është zbatuar Udhëzimi i MASH për pranimin në shkollë të këtyre fëmijëve edhe pa certifikata. Në bashkëpunim me disa bashki janë siguruar mjete edhe pajisje mësimore për këta fëmijë.

Për rastet e fëmijëve të abuzuar apo neglizhuar, të konstatuar nga shkollat, është bashkëpunuar me punonjësin e mbrojtjes së fëmijëve në bashki (në ato bashki ku tashmë është ngritur kjo strukturë). Në disa raste bashkia dhe shkollat kanë bashkëpunuar edhe

për organizimin e aktiviteteve sensibilizuese lidhur me zbatimin e të drejtave të fëmijëve duke shënuar një eksperiencë pozitive bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të ndryshme në nivel vendor .

Në përgjithësi të intervistuarit vlerësojnë se reforma në arsim është fokusuar në drejtimit e duhura dhe për të ardhmen rekomandojnë fuqizimin e këtyre elementëve.

Gjithashtu të intervistuarit vlerësojnë se drejtimit e përcaktuara në SKF, për realizimin e të drejtës për arsim cilësor, janë në përputhje të plotë me reformën në arsim, të ndërmarrë nga MASH. Reformat janë fokusuar në përmirësimin e programeve mësimore, infrastrukturës së shkollës, mundësinë e përdorimit të teknologjisë dhe rritjen e kualifikimit të mësuesve. Të intervistuarit mendojnë se këto janë drejtimit e duhura për përmirësimin e politikave arsimore dhe për të ardhmen rekomandohet fuqizimi i këtyre 4 elementëve.

3.5 Rekomandime

Politika për përfshirjen e fëmijëve në procesin e hartimit të kurrikulave vjetore duhet të parashikohet edhe nëpërmjet aktet nënligjore përkatëse duke siguruar që ata të jenë pjesë aktive e grupit të punës gjatë hartimit të kurrikulës dhe planeve të mësimi.

Rishikimi kurrikulave dhe teksteve shkollore duke i afuar më shumë me fëmijët.

Të përmirësohet mësimdhënia duke rritur nivelin e kualifikimit të mësuesve si profesionistë dhe respektues të të drejtave të fëmijëve.

Toleranca ndaj braktisjes shkollore të jetë zero, kjo me anë të programeve integruese në shkolla dhe programeve sociale në komunitet.

Politikat e reja të ndërmarrë në kuadër të reformës në arsim duhet të shoqërohen me ndryshimet e nevojshme në infrastrukturën shkollore, si dhe me përgatitjen e stafit pedagogjik në përshtatje me kurrikulat dhe mënyrat e reja të mësimdhënies.

Të forcohet komunikimi dhe transparenca e pushtetit vendor me fëmijët dhe grupet e interesit lidhur me politikat arsimore për fëmijët që do të zbatohen në nivel rajonal.

Të përmirësohet bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të ndryshme në nivel vendor për t'ju përgjigjur me mirë nevojave të fëmijë në përgjithësi dhe të fëmijëve në nevojë në veçanti, për të siguruar përfshirjen e të gjithë fëmijëve në sistemin e detyruar arsimor. Të nxiten forma të mbështetjes së fëmijëve romë e në nevojë si dhe të familjeve të tyre me qëllim arsimimin e tyre.

Në zonat rurale të sigurohet infrastruktura e nevojshme dhe e përshtatshme shkollore për të siguruar që procesi mësimdhënës të zhvillohet në cilësinë e duhur. Të sigurohet vazhdimësia e edukimit të fëmijëve edhe pas përfundimit të shkollës 9-vjeçare duke ngritur shkolla të mesme pranë komunitetit.

Në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës shkollore të ndërtohen palestra e terrene sportive në të gjitha shkollat për të siguruar një zhvillim normal të lëndës së edukimit fizik. Të përmirësohen kushtet higjeno-sanitare, të instalohet dhe të funksionojë sistemi i ngrohjes. Të monitorohet në mënyrë rigoroze zbatimi i standarteve të ndërtimit të shkollave, duke siguruar standarte edhe për nxënësit me aftësi të kufizuar.

Është e nevojshme të rritet numri i psikologëve të shkollave, të rishikohet ngarkesa, dhe të konsolidohet më tepër ky shërbim për t'u ardhur më shumë në ndihmë nxënësve.

Të vazhdojë procesi i reformimit të karrierës së mësuesit, proces i cili nxit cilësinë e mësidhënies.

3.11 Rekomandime të përgjithshme

Hartimi i politikave, strategjive të reja kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve është një domosdoshmëri për mbrojtjen e tyre nga çdo formë dhune, abuzimi apo shfrytëzimi.

Politikat kombëtare për mirëqënien e fëmijëve (politikat sociale, shëndetësore, edukimit, strehimit, etj.) duhet të synojnë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Këto politika duhet t'u japin prioritet uljes së varfërisë dhe marginalizimit, pabarazisë, mbështetjes së familjes, të adresojnë tolerancën dhe kohezionin social, të sigurojnë përfshirjen sociale dhe të nxisin bashkëpunimin e aktorëve të ndryshëm në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mbrojtjes së grupeve të fëmijëve vulnerabël si: fëmijëve me aftësi të kufizuar, fëmijëve të braktisur, fëmijëve në institucionet rezidenciale, fëmijëve të minoriteteve, fëmijëve që punojnë apo jetojnë në rrugë, fëmijëve të pashoqëruar, fëmijëve që jetojnë në kushtë varfërie apo varfërie ekstreme, fëmijëve në konflikt me ligjin, etj. Politikat e adresuara për këto grupe, që tashmë kanë mundësi të bazohen në studime të realitetit tonë apo eksperiencat e vetë fëmijëve, duhet të jenë të afta të parandalojnë, zbulojnë dhe përgjigjen formave të ndryshme të dhunës apo përjashtimit të fëmijëve.

Politikat për fëmijët nuk mund të ndahen nga politikat për familjet. Politikat për fëmijët dhe familjet duhet:

- Të mbrojnë fëmijën dhe familjen nga varfëria dhe përjashtimi social;
- Të mbështesin familjen në ushtrimin e përgjegjësive prindërore dhe kujdesit ndaj fëmijëve;
- Të parandalojnë sa më shumë të jetë e mundur ndarjen e fëmijëve nga familjet e tyre;
- Të promovojnë shërbimet me bazë komunitare dhe shërbimet alternative (shtëpi-familje, kujdestari) ndaj shërbimit rezidencial për fëmijë;

- Të promovojnë forma pozitive dhe jo të dhunshme të përkujdesit për fëmijët, prindërimin pozitiv.

Duhet të vazhdojnë përmirësimet ligjore të cilat i japin mundësi:

- Koordinimit të politikave ndërsektoriale që synojnë realizimin e të drejtave të fëmijëve;
- Krijimit të një agjencie shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;
- Ngritjes së rrjetit të strukturave, apo sistemit kombëtar për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në nivel vendor dhe qendror;
- Monitorimit të rregullt statistikor sipas një metodologjie të përcaktuar për mbledhjen e informacionit nga njësitë e qeverisjes vendore dhe institucionet e tjera në nivel qendror.

KAPITULLI IV: E DREJTA E MBIJETESËS DHE E KUJDESIT SHËNDETËSOR

E drejta për kujdes shëndetësor është një nga të drejtat themelore dhe prioritet i Qeverisë Shqiptare, e përkthyer në dokumenta strategjikë: (i) Strategjia për Zhvillim dhe Integrim dhe; (ii) Strategjia Kombëtare për Fëmijë. Rishikimi i Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët për vitet 2008-2010 mundësoi përcaktimin e treguesve të monitorueshëm të objektivave të Strategjisë Kombëtare për Fëmijë lidhur me zbatimin e të drejtës së mbijetesës dhe kujdesit shëndetësor.

E drejta për kujdes shëndetësor vlerësohet nëpërmjet realizimit të objektivave:

1. Reduktimin e nivelit të vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç në 10/1000 të gjalla derin në 2015.
2. 90% e popullsisë e edukuar mbi principet e kujdesit shëndetësor të gojës dhe 90% e grupmoshës 0-6 vjeç që do të përfitojë nga fluorizimi deri në vitin 2015.
3. Sigurimi me vaksina dhe imunizimi me vaksina të detyrueshme të mbajtur respektivisht në nivelet 100% dhe mbi 95%.

Vlerësimi i progresit në realizimin e objektivave për periudhën 2008-2009 në lidhje me të drejtën për kujdes shëndetësor tregon për përmirësim të ndjeshëm në ofrimin e shërbimit parësor. Ky përmirësim mund të shihet qartë jo vetëm në uljen e vdekshmërisë foshnjore apo në ndjekjen e shërbimeve të nënës dhe fëmijës por dhe në buxhetet e caktuara për periudhën 2008-2009 dhe në ngritjen në qarqe të strukturave të reja të monitorim-vlerësimit. Gjithashtu kanë përfunduar protokollat e planifikimit familjar për shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor.

Gjatë kësaj periudhe në kuadrin e vazhdimit të reformës për shërbimet shëndetësore dhe shtrirjes së skemës së sigurimit të kujdesit shëndetësor është miratuar financimi i Shërbimeve Shëndetësore Spitalore nga Skema e Detyrueshme e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor. Financimi nga skema e detyrueshme e sigurimeve shëndetësore të shërbimeve të ofruara në spitalet publike parashikon edhe shërbimin e pediatriisë së përgjithshme dhe të gjithë listën e specialiteteve për fëmijë.

Ka përfunduar Strategjia e Promocionit dhe Edukimit Shëndetësor, e cila përfshin objektivat dhe aktivitetet për promocionin dhe edukimin shëndetësor lidhur me shëndetin e nënës, fëmijës (aktualisht është në proces rishikimi dhe përditësimi). Politikat dhe strategjitë e Ministrisë së Shëndetësisë synojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të shëndetit të grave dhe fëmijëve dhe të cilësisë së jetës së tyre, duke ndikuar në uljen progresive të vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë së tyre. Gjatë kësaj periudhe ndërhyrjet kryesore për të garantuar një shëndet më të mirë për fëmijët kanë konsistuar në:

- përmirësimin dhe integrimin e strukturave të shërbimit shëndetësor të gruas dhe fëmijës në të tre nivelet e kujdesit;

- përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të nënës dhe fëmijës në tre nivelet e kujdesit, nëpërmjet unifikimit të protokolleve standart për ndjekjen e shëndetit të gruas dhe fëmijës;
- përmirësimin e nivelit shkencor dhe teknik të njohurive të personelit shëndetësor nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm të gjithë personelit shëndetësor që punon në këto shërbime;
- plotësimin dhe përforcimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e shëndetit të gruas dhe fëmijëve;
- sensibilizimin, edukimin dhe mobilizimin e gjithë shoqërisë, medias, etj.

Të gjitha këto ndërhyrje kanë shërbyer për të kuptuar se kujdesi për gruan dhe fëmijën përbën një nga prioritetet kryesore. Rekomandimet e Ministrisë së Shëndetësisë për kujdesin për fëmijën mbas lindjes, përqëndrohen si në kujdesin për nënën ashtu dhe në atë për foshnjën, duke përfshirë këshillimin rreth ushqyerjes me gji, ushqyerjen dhe planifikimin familjar.

Megjithëse hartimi i “Rekomandimeve për një ushqyerje të shëndetshme për popullatën shqiptare” i ka dhënë prioritet ushqyerjes së shëndetshme duke u ndalur veçanërisht në grupmoshat feminare dhe duke i parë ato me përparësi në raport me gjithë popullatën, përsëri ushqyerja e shëndetshme mbetet kritike.

Ligji i ri “Për shërbimin shëndetësor stomatologjik”, i cili siguron mjekimin stomatologjik falas të fëmijëve 0-18 vjeç ka ndikuar ndjeshëm në përmirësimin e infrastrukturës së shërbimit stomatologjik me aparatura te reja dhe kabinete dentare në të 12 qarqet e vendit.

Shqipëria është një ndër vendet e rajonit me shifrat më të larta të vaksinimit. Kjo bazuar dhe në studimin e bërë nga OBSH-ja. Për vitin 2009, në skemën e vaksinimit të detyrueshëm është shtuar vaksina polivalente e cila përmban 5 lloje vaksinash.

4.1 Vlerësimi i arritjeve në raport me objektivat e të drejtës për kujdes shëndetësor

Objektivi 1: Reduktimi i nivelit të vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç në 10/1000 lindje të gjalla deri në 2015

Ulja e nivelit të vdekshmërisë foshnjore tregon për mirëqenie, përmirësim të shërbimeve, rritje të njohurive për kujdesin shëndetësor të nënës dhe fëmijës. Treguesi i vdekshmërisë foshnjore monitorohet vazhdimisht nga Ministria e Shëndetësisë. Gjithashtu Komiteti Kombëtar i Shëndetit Riprodhues i ngritur me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë Nr.58, datë 15.02.2008, përfshin në detyrat e tij vlerësimin dhe analizimin e vazhdueshëm të situatës së shëndetit riprodhues në vend dhe në veçanti të shëndetit të gruas dhe fëmijës, pra i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë amtare dhe feminare. Ky Komitet i drejtuar nga Zëvendës Ministri i Shëndetësisë, ka në përbërjen e tij përfaqësues të institucioneve kryesore shëndetësore ku përfshihen ministritë e linjës që punojnë për të drejtat e fëmijëve, si Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe

Shanseve të Barabarta, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, si dhe organizata vendase apo ndërkombëtare si ato të Kombeve të Bashkuara p.sh OBSH, UNICEF, USAID, UNFPA, etj.

Nga të dhënat administrative rezulton se nga 12 vdekje për 1000 lindje të gjalla në vitin 2007 ky tregues u ul në 11.1 vdekje për 1000 lindje gjallë për vitin 2008. Ndërsa në të njëjtin vit vdekshmëria amtare ishte 20 për 100,000 lindje gjallë.

Sipas studimit të ADHS 2008-2009 rezulton një rënie neonatale, postnatale dhe vdekshmërisë foshnjore gjatë 15 viteve të fundit. Veçanërisht vdekshmëria foshnjore është përgjysmuar nga 35 për 1000 lindje gjallë në 18 për 1000 lindje gjallë vitet e fundit. Kjo shifër rezulton të jetë pak më e lartë krahasuar me disa vende të rajonit por shumë më e ulët se Armenia 26% për 1000 dhe Azerbaxhani 50% për 1000¹⁵.

Politikat dhe strategjitë e Ministrisë së Shëndetësisë e konsiderojnë shëndetin e gruas dhe të fëmijëve si një pjesë shumë të rëndësishme dhe e vendosin atë në qendër të shërbimeve të shëndetit riprodhues duke synuar të integrojnë shërbimet shëndetësore të shëndetit riprodhues në tre nivelet e kujdesit shëndetësor me prioritet kujdesin shëndetësor parësor.

Gjatë periudhës nëntor-dhjetor 2008 është hartuar paketa e shërbimit të promocionit dhe edukimit të shëndetit që duhet të ofrojë një qendër shëndetësore në vendin tonë. Paketa përmban dy programe:

- Programin e trajnimit të personelit shëndetësor për problemet e informimit, edukimit e këshillimit të nënës dhe fëmijës;
- Programin me tematikat që personeli i qëndrës shëndetësore duhet ti ofrojë prindërve, fëmijëve, nënave dhe komunitetit.

Sipas kësaj pakete në kujdesin parandalues dhe edukimin për fëmijën, personeli shëndetësor duhet të ofrojë informim, edukim e këshillim të nënës dhe fëmijës.

Në vitin 2008 përfundoi rishikimi i Strategjisë Kombëtare të Promocionit me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimit sidomos të shëndetit të nënës dhe fëmijës. Rishikimi i kësaj strategjie shërbeu si bazë për hartimin e draft strategjisë së promocionit të shëndetit riprodhues ku vend të veçantë zë:

- Rritja e njohurive të personelit shëndetësor mbi informimin, edukimin, këshillimin për ruajtjen apo përmirësimin e shëndetit të nënës dhe fëmijës;
- Rritja e njohurive të nënave e fëmijëve mbi informimin, edukimin dhe këshillimin për ruajtjen apo përmirësimin e shëndetit të tyre;
- Përfshirja në kurrikulën shkollore e tematikave për sjellje të shëndetshme të fëmijëve, etj;
- Trajnim të mësuesve për problemet e ruajtjes apo përmirësimit të shëndetit të fëmijëve;
- Riorientimin e shërbimeve shëndetësore, kryesisht të kujdesit parësor edhe në informimin, edukimin dhe këshillimin e pacientëve.

¹⁵ Studim Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri 2008-09

Në periudhën Qershor 2008 - Prill 2009 janë zhvilluar aktivitete promovionale nga Departamenti i Promocionit të Insitutit të Shëndetit Publik në rrethet Elbasan, Shkodër, Korçë dhe Tiranë lidhur me shëndetin e nënës, planifikimin familjar dhe shpërndarjen e broshurave për një shtatëzani të shëndetshme.

Nga të dhënat e studimit të ADHS rezulton se kujdesi për gruan shtatzanë ka ardhur në rritje, nga 81% e grave shtatzana që raportojnë për kontrollet mjekësore në 2002, në 97% në 2008-2009, shifër e lartë dhe në përputhje me vende e rajonit.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet buxheti i caktuar për shërbimin spitalor. Vihet re një rritje nga viti 2007 në vitin 2008.

Tabela Nr. 4.1: Buxheti për kujdesin shëndetësor parësor dhe atë spitalor, për vitet 2007 – 2008

	Viti 2007	Viti 2008
Kujdesi Shëndetësor Parësor	657,500	840,000
Kujdesi Shëndetësor Spitalor (kurativ)	1,972,000	2,160,000
Totali	2,630,000	3,000,000

Burimi: Ministria e Shëndetësisë

Gjithashtu përmirësimi i shërbimeve duket qartë në rritjen % të buxhetit të shpenzuar në shërbimin parandalues në raport me atë kurues. Raporti i këtyre shërbimeve ka qenë 46% për shërbimet parandaluese dhe 54% për shërbimet trajtuese (kuruese), por në periudhën 2008-2009 raporti është i barabartë .Buxheti i caktuar për shërbimin parandalues për vitin 2008 është 28% më i lartë sesa buxheti i caktuar për vitin 2007.

Në kuadrin e vazhdimet të reformës në shërbimet shëndetësore dhe shtrirjes së skemës së sigurimit shëndetësor është miratuar VKM datë 29.12.2008 “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”. Sipas kësaj VKM-je përcaktohet financimi i shërbimit të pediatriisë së përgjithshme të ofruar në spitalet publike nga skema e detyrueshme e sigurimeve shëndetësore. Aktualisht Ministria e Shëndetësisë është duke punuar për përgatitjen e paketës së shërbimeve spitalore që do të financohen nga kjo skemë, rishikimin e treguesve të matjes së performancës spitalore, standarteve të cilësisë, përcaktimin e sistemeve të referimit, përcaktimin e kategorive të shtetasve që do të kontribuojë shteti (personat e pasiguruar që nuk do të paguajnë marrjen e shërbimit në spital: si fëmijët deri në 18 vjeç, gratë shtatzëna, pensionistët, etj).

Gjatë periudhës qershor 2008 - prill 2009 janë trajnuar në kuadrin e Programit Manaxhimi Integruar i Sëmundjeve të Fëmijërisë (MISF), 40 mjek familje dhe infermiere në rrethin e Tropojës dhe ka filluar zbatimi i këtij programi në 15 fshatra dhe 5 komuna të

këtij rrethi duke punuar me skuadra vullnetare në familje, nënat lidhur me kujdesin për shëndetin dhe mirërritjen e fëmijës.

Në vitin 2008, Ministria e Shëndetësisë së bashku me Institutin e Shëndetit Publik, nën mbështetjen e UNFPA-së filluan botimin e Revistës së Shëndetit Riprodhues. Revista del çdo tre muaj dhe përmban artikuj të ndryshëm për shëndetin e nënës, fëmijës, shtatzaninë, ushqyerjen, zhvillimin e fëmijës, adoleshencën, etj.

Një projekt tjetër i Ministrisë së Shëndetësisë për periudhën 2008-2010 është dhe bashkëpunimi me Organizatën Botërore të Shëndetësisë dhe Agjencisë Spanjolle për “Reformën në Shëndetin e Nënës dhe Fëmijës”. Ky projekt konsiston në përmirësimin e gjëndjes shëndetësore të grave, foshnjave dhe fëmijëve shqiptare duke përfunduar:

- Kapacitetet dhe funksionin drejtues të Ministrisë së Shëndetësisë;
- Shërbimet e shëndetit të nënës dhe fëmijës në kujdesin shëndetësor parësor dhe dytësor;

Për arritjen e këtij objekti, ndërhyrjet dhe aktivitetet do të zbatohen në nivel kombëtar dhe rajonal dhe do të jenë të fokusuar kryesisht në:

- Reformimin dhe riorganizimin e shërbimeve të shëndetit të nënës dhe fëmijës;
- Përmirësimin e cilësisë dhe vazhdimësisë së kujdesit të shërbimeve të nënës dhe fëmijës;

Në nivel kombëtar ndërhyrje kryesore do të fokusohen në:

- Përfundimin e kapacitetit të Ministrisë së Shëndetësisë për të monitoruar dhe menaxhuar shëndetin e nënës dhe fëmijës;
- Rishikimin dhe zhvillimin e standarteve dhe udhëzuesve klinike për shëndetin e nënës dhe fëmijës;
- Rishikimin e kurrikulave universitare dhe pas universitare për shëndetin e fëmijës;
- Përfundimin e trajnimit dhe edukimit në vazhdim për punonjësit e kujdesit shëndetësor;
- Përfundimin e sistemit të informacionit për shëndetin e nënës dhe fëmijës të përfshirë në sistemin kombëtar të informacionit shëndetësor;

Në nivel rajonal Ministria e Shëndetësisë ka përzgjedhur tre rajone ku do të zhvillohen ndërhyrjet pilote: Qarku Shkodër (Shkodër, Pukë, Malësi e Madhe,) Qarku Vlorë (Vlorë Sarandë, Delvinë), Qarku Korçë (Korçë, Pogradec, Kolonjë, Devoll). Aktivitetet kryesore që do të zhvillohen gjatë këtyre tre vjetëve do të fokusohen në:

- Vlerësimin e cilësisë së kujdesit të ofruar spitalor për nënën dhe fëmijën;
- Përfundimin e familjes dhe përfshirjes komunitare në shëndetin e nënës dhe fëmijës;
- Vlerësimin e ndikimit të faktorëve përcaktues social-ekonomik dhe gjinor në shëndetin e nënës dhe fëmijës;
- Përfundimin e shërbimeve të shëndetit në shkolla;
- Ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve të kujdesit shëndetësor; dhe
- Asistencën në sektorin shëndetësor për të përmirësuar funksionimin e sistemit referues nga kujdesi parësor në atë spitalor.

Bazuar në treguesit e mirëushqyerjes rezulton se ushqyerja e fëmijëve është përmirësuar ndjeshëm. Sipas studimit të ADHS numri i fëmijëve nën peshë nga 14% në vitin 2008 është ulur ndjeshëm në 6% në vitin 2009. Frenimi i shtuarjes në peshë është më i theksuar në grupmoshën e fëmijëve 6 muajsh me 33% ndjekur nga fëmijët 9-11 muajsh me 32%. Po ti referohemi standarteve botërore: gjatësi/moshë, gjatësi/peshë, peshë/moshë rezulton se vetëm 5% e fëmijëve ishin nën peshë, shifër që tregon për një përmirësim të ndjeshëm të ushqyerjes së fëmijëve. Megjithatë ushqyerja e fëmijëve dhe ushqyerja e shëndetshme e popullatës mbeten drejtime të rëndësishme mbi të cilat duhet të vazhdojë fushata sensibilizuese. Në prill 2009 përfundoi hartimi i rekomandimeve për një ushqyerje të shëndetshme, ku grupmoshat femënore janë parë me përparësi.

Në prill 2009 përfundoi hartimi i “Rekomandimeve për një ushqyerje të shëndetshme për popullatën shqiptare”, ku grupmoshat femënore janë trajtuar me detaje, parë me përparësi në raport me gjithë popullatën.

Instituti i Shëndetit Publik ka zbatuar me sukses një projekt pilot për informimin dhe edukimin për një ushqyerje të shëndetshme dhe të sigurt me fëmijët e klasave të 6-ta dhe të 7-ta në 5 shkolla 9-vjeçare të qytetit të Tiranës.

Objektivi 2: 90% e popullsisë e edukuar mbi principet e kujdesit shëndetësor të gojës dhe 90% e grupmoshës 0-6 vjeç që do të përfitojë nga fluorizimi deri në vitin 2015.

Me miratimin e Ligjit “Për shërbimin shëndetësor stomatologjik”, sigurohet mjekimi stomatologjik falas i fëmijëve 0-18 vjeç. Qëllimi i këtij ligji konsiston në parandalimin dhe përsosjen e teknikave për uljen e sëmundshërisë karioze tek fëmijët e këtyre grupmoshave në masën e rekomanduar nga OBSH-ja. Sipas të dhënave të Ministrisë së Shëndetësisë, 90% e shkollave janë mbuluar me shërbim dentar publik, ndërsa 10% e shkollave në zonat rurale nuk e kanë akoma këtë shërbim publik.

Duke synuar përmirësimin e infrastrukturës së shërbimit stomatologjik, janë pajisur me aparatura të reja 16 kabinete dentare në 12 qarqet e vendit. Për vitin 2008 buxheti i shpenzuar në infrastrukturë fizike është 65% më i lartë se 2007. Infrastruktura e shërbimeve stomatologjike është shumë e mirë edhe si pasojë e privatizimit të këtij shërbimi. Shërbimi stomatologjik dhe infrastruktura në rrethe nuk është e nivelit që t’i përgjigjet me korrektsi shërbimit për trajtim terapeutik, por për shërbim diagnostikues e promociional është në nivele relativisht të mira. Ministria e Shëndetësisë edhe për periudhën 2008-2009 ka bërë blerjen dhe shpërndarjen e aparaturave të reja duke mundësuar që rrethet të kenë të paktën 2 deri 3 aparatura bashkëkohore për trajtim terapeutik të fëmijëve deri në moshën 18 vjeç.

Ka përfunduar faza e parë dhe e dytë e fluorizimit për fëmijët e grupmoshave 7- 9 vjeç (Lushnjë dhe Kombinat Tiranë). Për periudhën janar-prill 2009 filloi aplikimi i fluorizimit në të gjitha shkollat e Tiranës.

Objektivi 3. Sigurimi me vakcina dhe imunizimi me vakcina të detyrueshme të mbajtur respektivisht në nivelet 100% dhe mbi 95%.

Imunizimi është një nga drejtimet më të suksesshme dhe mbulesa vaksinale është ndër më të lartat në rajon raportuar jo vetëm nga të dhënat e Ministrisë së Shëndetësisë por dhe nga OBSH, dhe së fundmi dhe nga studimi i ADHS.

Sigurimi i vaksinave ka qenë në masën 100% dhe mbulesa vaksinale për vitin 2008 vazhdon të mbahet në nivelet mbi 95%. Nga studimi i ADHS rezulton i njëjti rezultat dhe vlen të përmendet sensibilizimi shumë i mirë i popullatës, me diferencim të vogël të zonave rurale në 93% (e lidhur kjo nivelin e ulët të edukimit të nënave). Të dhënat e këtij studimi i referohen librit të vaksinave, ku vaksinimi vlerësohet në shkallën 68%, informacionit gojor nëpërmjet intervistave dhe rregjistrimit të vaksinave në këshillimore, meqenëse të dhënat e imunizimit janë të larta.

Sipas MSH mbulesa me vakcina me disa nga antigenët kryesorë paraqitet si më poshtë:

1. Tuberkulozi (BCG)	97.5%
2. Hepatiti Viral B (doza e tretë)	98.6%
3. Difteri, Tetanoz, Pertus (doza e tretë)	97.9%
4. Poliomielit (doza e tretë)	97.9%
5. Fruth – Rubeolë (doza e parë)	97.3%.

ISHP, ka zhvilluar trajnime me pjesëmarrjen e epidemiologëve, kryevaksinatoreve dhe përgjegjësve të vaksinimit të të gjitha rretheve. Të gjitha konsultoreve të fëmijëve në të gjithë vendin, u janë siguruar pajisje të reja elektronike që rregjistrojnë temperaturat në frigoriferët që mbajnë vakcina.

Në gjashtëmujorin e dytë të 2008, u paraqitën rezultatet e studimit të bërë në Shqipëri nga ekspertë të OBSH-së lidhur me vaksinimin. Nga studimi ka rezultuar se vaksinimi në vendin tonë është në shifra të larta, krahasuar edhe me vendet e rajonit dhe se është në një shkallë më të lartë se sektorët e injeksioneve terapeutike në lidhje me menaxhimin e mbetjeve, pasi përdor me efikasitet kutitë e sigurisë të cilat sigurohen si paketë së bashku me vaksinat dhe pajisjet injektuese.

Gjatë vitit 2008 u miratua Plani Shumëvjeçar i Imunizimit 2009-2013, sipas të cilit janë planifikuar, futja e vaksinave të reja. Në fillim të vitit 2009 u fut në skemën e detyrueshme dhe filloi vaksinimi i fëmijëve me vaksinën pentavalente, e cila përmbledh në një vaksinë të vetme 5 vakcina (Difteri, Tetanoz, Pertus, Hepatiti Viral B, Poliomielit). Kjo vaksinë mbështetet me fonde për 5 vjet nga GAVI.

Fëmijët dhe të rinjtë me HIV/AIDS

Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, numri i përgjithshëm i personave që marrin mjekim me antiretrovirale pranë Departamentit të Pediatriisë në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” është 108 dhe 12 prej tyre janë fëmijë. Bazuar në këto shifra Shqipëria vazhdon të mbetet një vend me prevalencë të ulët të infeksionit HIV, me vlerë < 0.01%.

Në mënyrë që të parandalohet transmetimi i HIV/AIDS-it nga nëna te fëmija po synohet që dhe detyrimi i nënave për të bërë analizën e HIV të bëhet me ligj. Në Strategjinë e rishikuar të HIV/AIDS-it është vendosur që një nga Maternitetet të funksionojë edhe si qendër referimi për PMTCT (parandalimin e transmetimit nënë-fëmijë).

Në kuadër të parandalimit të përhapjes së virusit, një komponent i rëndësishëm kanë qënë trajnimet dhe fushatat sensibilizuese. Gjatë periudhës 2008 - tremujori i parë 2009, ISHP ka organizuar fushata sensibilizuese në kuadër të sensibilizimit të të gjithë popullatës, përfshirë gratë dhe fëmijët. Në gjashtëmujorine dytë të 2008 janë bërë këto trajnime për HIV/AIDS:

- këshillim vullnetar;
- mjek mikrobiologë, laborantë, 20 persona;
- këshillues (psikologë/punonjës socialë), 15 persona;
- trajnime me OJF: 3 trajnime me nga 20 persona (të ndryshëm).

Për fushatat promovionale gjatë vitit 2008, janë përgatitur dhe shpërndarë 15,000 fletëpalosje, 10,000 postera dhe 1000 kartolina. Shërbimet miqësore për rinj, që japin informacion lidhur me HIV/AIDS, janë krijuar në 4 rrethe: Shkodër, Vlorë, Korçë, Tiranë.

4.2 Gjetjet e vlerësimit

Cilësia e shërbimeve ka patur përmirësime në zonat e qytetit dhe të fshatit për të cilat ka të dhëna që e mbështesin këtë, si më poshtë:

- Mungesa e pranisë së disa sëmundjeve problematike epidemiologjike si: rubeola, difteria, rakiti, pertusi (kolla e mirë) si rrjedhojë e vaksinimit por edhe e përmirësimit të kushteve të jetesës;
- Niveli i lartë i vaksinimit të popullsisë;
- Nuk ka më sëmundje të cilat vinin si rrjedhojë e cilësisë së ulët të ujit pasi tani uji është më i mirë dhe më i pastër e i kontrolluar, por edhe cilësia e ushqimit ka ndryshuar dhe vetë prindërit janë bërë më të kujdesëshëm ndaj kësaj.

Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve për kujdesin e nënës dhe fëmijës është pjesë e strategjisë për reforma shëndetësore dhe është në vazhdimësi. Megjithatë për të ardhmen po punohet për një program të përbashkët MSH, MBO dhe donatorët OBSH, FAO, UNICEF për përmirësimin e gjendjes së nutricionit të fëmijët me ndërhyrje në sistem dhe ndërhyrje direkte me vitamina në zonat me treguesit më të ulët si Tropoja, Kukësi, Dibra dhe Puka.

Cilësia e shërbimeve të nënës dhe fëmijës në kujdesin parësor ndiqet në mënyrë të vazhdueshme nga strukturat e reja të monitorim-vlerësimit të ngritura së fundmi në qarqe. Për këtë janë përgatitur edhe 7 lista kontrolli të punës së këtyre shërbimeve lidhur me shëndetin e nënës dhe fëmijës, të unifikuara sipas rekomandimeve ndërkombëtare dhe përshtatur për sistemin tonë shëndetësor. Listat e kontrollit (bazuar mbi disa tregues të shëndetit të fëmijës si: vaksinimi, vdekjet 0-5 vjeç, shëndeti i të porsalindurit, ushqyerja me gji, etj) përmbajnë protokollin e vlerësimit të punës së personelit që punon në shërbimet e kujdesit të nënës dhe fëmijës, si p.sh mënyra si personeli ndjek rritjen dhe zhvillimin e fëmijës, vaksinimin, si këshillon nënën për kujdesin ndaj shëndetit të fëmijës, si ndiqet gruaja shtatzënë, etj.

Ka pasur ndërhyrje në trajnimin e stafit me çertifikime të personit për njohuritë rreth shëndetit të nënës dhe fëmijës si dhe përmirësim në sistemin e monitorimit.

Janë përgatitur protokollat për dhunën në familje dhe trajnimin e personelit shëndetësor si dhe janë përcaktuar kontrollet rutinë për gruan shtatzënë.

Instituti i Sigurimeve Shëndetësore ka futur në paketën bazë të sigurimeve shëndetësore (falas) kujdesin e nënës dhe fëmijës, kjo dhe në ofrimin e këtij shërbimi në spital.

Gjithashtu është përmirësuar cilësia e shërbimeve parësore për nënat të cilat drejtohen te mjeku i familjes dhe për gratë shtatzënë që depistohen që në 3 mujin e parë të shtazanisë.

Në muajin shkurt 2009, përfunduan protokollat e planifikimit familjar për shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor. Protokollat do të paratestohen në disa shërbime të planifikimit familjar në Tiranë dhe më tej do t'ju shpërndahen të gjitha rrethet.

Sipas Udhëzimit të Ministrisë së Shëndetësisë, shërbimet parandaluese të kujdesit shëndetësor për fëmijët, këshillimet e fëmijës, qendrat shëndetësore dhe ambulancat në fshat, kryejnë vizita të detyrueshme kontrolli të mirërritjes së fëmijës. Gjatë vitit të parë të jetës, në muajin e parë – 2 vizita në muaj, me tej një vizitë rregullisht në çdo muaj, një vizitë çdo muaj gjatë moshës 12-24 muajsh, një vizitë në çdo gjashtë muaj në moshën 2-6 vjeç. Në këto shërbime për fëmijët duke filluar nga viti 2008, në 12 qarqet e vendit kanë filluar të punojnë ekipet multidisiplinare me punonjës social e psikolog. Pas moshës 6 vjeç fëmijët duhet të ndiqen nga mjeku i shkollës, shërbim ky që nuk është i shpërndarë dhe rregulluar mirë në të gjitha rrethet e vendit. Për vitin 2009, në kuadrin e projektit kombëtar të bashkëpunimit me Qeverinë e Spanjës “Për reformimin e shërbimeve të nënës dhe fëmijës” do të fillojë puna për riorganizimin e këtij shërbimi.

Reformat në shëndetësi kanë ndikuar ndjeshëm në përmirësimin e së drejtës për kujdes shëndetësor. Objektivat e të drejtës për kujdes shëndetësor në dokumentin e Strategjisë Kombëtare për Fëmijë janë pjesë e Strategjisë së Reformës në Shëndetësi dhe nga nivelet ekzekutive të MSH njihen si pjesë e kësaj reforme dhe nuk ka shumë informacion për Strategjinë Kombëtare për fëmijët.

4.3 Rekomadime

Të vazhdojë përmirësimi i cilësisë së shërbimit parësor spitalor për nënën dhe fëmijën, sidomos shërbimi në zonat rurale.

Megjithë përpjekjet për shtrirjen e shërbimit stomatologjik në të gjithë Shqipërinë duhen forcuar përpjekjet për shtrirjen e këtij shërbimi në zonat rurale.

Të përmirësohet shërbimi stomatologjik në shkolla.

Të përcaktohet dhe të ngrihet sa më shpejt qendra e referencës në një nga maternitetet për parandalimin e transmetimit të virusit të HIV/AIDS nga nëna te fëmija.

Punonjësit e edukimit shëndetësor pranë Drejtorive të Shëndetit Publik duhet të punojnë me shkollat në drejtim të forcimit të grupeve multidisiplinare (punonjës social, psikolog, mjek, stomatolog).

Ekspertet e shëndetësisë të përfshihen në hartimin e kurrikulave dhe materialeve shkollore për probleme të lidhura me shëndetin.

Përsheptimi i punës për futjen e testit publik për analizën e HIV/AIDS.

Duhet forcuar më shumë kujdesi shëndetësor në institucionet fëmimore.

KAPITULLI V: E DREJTA E FËMIJËVE PËR PJESËMARRJE

E drejta e fëmijëve për pjesëmarrje është një e drejtë legjitime e tyre e cila sanksionohet që nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe deri në rregulloret e Qeverive të Nxënësve nëpër shkolla. Duke iu referuar Strategjisë Kombëtare të Fëmijëve, kjo e drejtë është një nga drejtimit kryesore të punës për përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijëve dhe vetënxitjes qytetare e demokratike. Po t'u referohemi të dhënave e shifrave ne 4 vitet e fundit, në përgjithësi procesi i pjesëmarrjes së fëmijëve në jetën e shkollës dhe komunitetit ka pësuar ndryshime pozitive.

Ndryshime pozitive kanë filluar që me legjitimitetin e qeverive të nxënësve në çdo shkollë të Shqipërisë dhe deri në angazhimin e nxënësve për të përmirësuar infrastrukturën e shkollës së tyre, për të ndihmuar nxënës në nevojë apo për t'u bërë pjesë e kontributit komunitar në raste të fatkeqësive natyrore e njerëzore. Dimensionin që ka marrë pjesëmarrja e fëmijëve në Shqipëri po zgjerohet dhe po i kushtohet rëndësi e veçantë, pavarësisht problemeve që shfaqen, por ajo që vlen të theksohet është ndërgjegjësimi më i madh që kanë fëmijët për të drejtat e tyre dhe ndjeshmëria në lidhje me zgjidhjen e problemeve në shkollë e komunitet.

5.1 Vlerësimi i objektivave të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët në lidhje me pjesëmarrjen e fëmijëve

Objektivi 1: Rritja e pjesëmarrjes aktive të fëmijëve në proceset vendimmarrëse

Pjesëmarrja aktive e fëmijëve në procese vendimmarrëse kërkon në radhë të parë një garantim të lirisë së fëmijëve për të shprehur lirshëm mendimin e tyre. Ky konsiderohet si hapi i parë në drejtim të vendimmarrjes aktive të tyre. Në këtë kuadër gjatë viteve 2005-2009, është vërejtur një angazhim më i madh i fëmijëve për të marrë pjesë dhe për të shprehur mendimin e shqetësimit e tyre. Nga ana tjetër ka një përkushtim dhe angazhim më të madh nga ana e shkollës apo organeve të tjera për t'iu përgjigjur më me seriozitet këtyre shqetësimeve dhe kërkesave, dhe për të ndihmuar në rritjen e ndërgjegjësimin të fëmijëve për të drejtat që kanë si dhe në zgjidhjen e problemeve të tyre në shkollë e komunitet.

Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve nuk është parë vetëm në kuadrin e shkollës por edhe jashtë saj. Angazhime të shumta ka patur edhe në bashkëpunim me pushtetin lokal dhe nën drejtimin e programeve të ndryshme të aplikuar nga organizata jofitimprurëse për angazhimin fëmijëve në përmirësimin e jetës së tyre.

Masa 1.1 Fuqizimi dhe rritja e numrit të shkollave që kanë strukturën e Qeverive të Nxënësve, dhe që është brenda kuadrit të Dispozitave Normative të MASH

Në kreun VIII të DNA, neni 37, pika 1, parashikohet se “Qeveria e Nxënësve” është një strukturë organizative e pavarur e nxënësve në shkollë. Ajo përfaqëson mendimin e nxënësve për çështjet e shkollës, mësimin dhe edukimit të tyre. Nëpërmjet “Qeverisë së Nxënësve” sigurohet pjesëmarrja aktive e nxënësve në proceset e ndryshme demokratike në shkollë dhe komunitet. Nisur nga përcaktimi ligjor, në çdo shkollë të vendit ngrihen qeveritë e nxënësve nëpërmjet një procesi zgjedhor të mirë përcaktuar dhe bazuar në një sistem zgjedhor me vota të fshehta. “Qeveria e nxënësve” ngrihet në bazë shkolle me pjesëmarrjen e gjithë nxënësve të shkollës dhe është çështje e iniciativës së lirë sipas kushteve dhe mundësive konkrete që ka shkolla.

Gjatë periudhës 2004 - 2009, është rritur numri i shkollave në të cilat funksionojnë

Në një shkollë në Shkodër, nxënësit bënë të mundur që pas kërkesave të tyre të fillonte një procedurë hetimi për mësuesen e cila nuk zhvillonte si duhet mësimin.

Qeveritë e Nxënësve. Kjo padyshim ka rritur pjesëmarrjen e nxënësve në vendimmarrje. Numri i programeve që përgatisin fëmijët për të marrë rol vendimmarrës për çështjet që u përkasin atyre është rritur, si dhe është përmirësuar edhe cilësia e programeve në lidhje me të drejtat e fëmijëve dhe pjesëmarrjen aktive të tyre.

Nga ana e pushtetit qendror, pothuajse çdo vit janë marrë masa dhe janë nxjerrë udhëzime, ku i vihet theks i veçantë problemeve edukative që lidhen me: njohjen dhe zbatimin e të drejtave të fëmijëve në shkollë dhe jashtë saj; sigurimin e pjesëmarrjes së nxënësve në vendimmarrje nëpërmjet fuqizimit të “Qeverive të Nxënësve”; rritjes së numrit të veprimtarive jashtëshkollore të nxënësve. Këto masa kanë synuar në krijimin e hapësirës së nevojshme që të drejtat e fëmijëve jo vetëm të mësohen por dhe të zbatohen¹⁶.

Për të siguruar një pavarësi dhe influencë më të madhe të QN, po rishikohen Dispozitat Normative të shkollës, që i njohin të drejtën QN për të vënë në lëvizje strukturat vendimmarrëse të shkollës, siç mund të jenë drejtorja e shkollës apo këshilli i mësuesve.

Në shumë prej shkollave në vend qeveritë e nxënësve mbështeten dhe ndihmohen nga organizata jofitimprurëse si: Save the Children, Eorld Vision, Shoqata Kombëtare “Edukim për Jetën”, etj... të cilat trajnojnë dhe ndihmojnë anëtarët e qeverive për të nxitur më shumë pjesëmarrjen e tyre dhe iniciativat.

Një tjetër strukturë organizimi për fëmijët në shkolla është Bordi i Shkollës, ku marrin pjesë prindër të zgjedhur me votim nga këshilli i prindërve të shkollës, përfaqësues të stafit të mësuesve dhe një ose dy nxënës.

Këshilli i klasës merret me çështje dhe probleme mësimore, edukative, mbarëvajtjes së mësimin, disiplinës, mjekësore, sociale, etj, që lidhen me klasën.

¹⁶ Raporti i Qeverisë Shqiptare për zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, gusht 2009

Pjesëmarrja e dy ose tre nxënësve të zgjedhur nga qeveria e nxënësve në Këshillin e Disiplinës organ këshillimor i drejtorit, që vepron në shkollë dhe merret me shqyrtimin e rasteve të shkeljes së disiplinës nga nxënësit, përbën shprehje të lirisë së organizimit të fëmijëve

Në kuadrin e forcimit të mbështetjes së qeverive të nxënësve, është bërë punë kualifikuese me mësues koordinatorë, drejtues shkollash dhe përfaqësues të Qeverisë së Nxënësve. Instituti i Kurrikulës dhe Trajnimit ka zhvilluar një sërë trajnimesh me drejtorët e shkollave lidhur me përdorimin e “Manualit të drejtorit dhe mënyrën e përdorimit të tij”. Në këtë manual një vend të veçantë zë dhe funksionimi i qeverisë së nxënësve dhe kushtet që duhet të krijohen në shkollë për mbarëvajtjen e punës¹⁷.

Fëmijët kanë marrë njohuri në çështje të ndryshme përfshirë dhe teknikat e organizimit dhe komunikimit, duke u bërë pjesë e marrjes së vendimeve në shkollë, por edhe në çështje të barazisë gjinore. Gjatë takimeve në shkolla të ndryshme, drejtorët janë konsultuar me anëtarë të qeverive të nxënësve për të diskutuar vendimet e marra për rregulloren e shkollës, përdorimin e uniformës, mbështetje për fëmijët në nevojë dhe planifikimin e aktiviteteve jashtë programit.

MASH gjithashtu, ka nxjerrë disa udhëzime për shkollat, ku i jep rëndësi vendosjes së një personi përgjegjës për monitorimin e qeverisë së nxënësve në mënyrë që të jenë aktivë në përgatitjen e pyetësorëve për dhunën në shkollë, procesin e hartimit të kurrikulave, luftën kundër korrupsionit, etj. 100 anëtarë të qeverive të nxënësve kanë marrë njohuri për pjesëmarrjen aktive.

Kuadri ligjor dhe ai administrativ në fushën e pjesëmarrjes së fëmijëve në mjedisin shkollor është i pasur dhe me një strukturë përfaqësimi nga poshtë-lart, gjë që e bën këtë, një sistem demokratik.

Masa 1.2. Institucionalizimi dhe njohja e statusit të qeverive të nxënësve nga institucionet në nivel vendor dhe qendror, duke u dhënë mundësi që të shprehen në të gjitha proceset vendimmarrëse që i referohen edukimit dhe çështjeve në interes të komunitetit

Pjesëmarrja e fëmijëve në nivel komunitar ka qenë dhe mbetet një sfidë përse i përket procesit të vendimmarrjes qendrore dhe lokale. Pjesëmarrja e tyre në vendimmarrjen në hartimin e politikave kombëtare dhe lokale është e rëndësishme sidomos kur këto prekin drejtpërsdrejti ose indirekt jetën dhe të drejtat e tyre. Statusi që gëzojnë qeveritë e nxënësve nëpër shkolla, mbetet i diskutueshëm dhe fëmijët nuk kanë gjithmonë forcën e duhur për të konkretizuar dhe institucionalizuar të drejtën e tyre për të marrë vendime e për të gjykuar në emër të zgjedhësve.

Pjesëmarrja e fëmijëve në hartimin e politikave lokale është shumë e pakët, megjithëse ata plotësojnë kriteret për të qenë grupe interesi. Fëmijët duhet të jenë pjesëmarrës jo

¹⁷ Raporti i Qeverisë Shqiptare për zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, gusht 2009

Bashkia e Tiranës ka mbështetur për 3 vite rresht Senatin e Fëmijëve të Tiranës, të cilët janë bërë pjesë e trajnimeve të përbashkëta me OJF, pjesë e aktiviteteve ndërgjegjësuese, etj.

“Zëri 16 +“ dhe qeveritë e nxënësve në Elbasan ftohen në takime me kryetarin e bashkisë ku parashtrijnë kërkesat e tyre, një pjesë e të cilave është marrë parasysh. Gjithashtu, ata janë të pranishëm në vendimet e Këshillit Bashkiak, ku është marrë mendimi i fëmijëve për rikonstrukcionin e bulevardit.

Insistimi i fëmijëve në një shkollë 9-vjeçare në Shkodër dhe kërkesat e shumta pranë Bashkisë, bënë të mundur ndërtimin e murit rrethues të shkollës.

vetëm në vendimmarrjen në familje e në shkollë por edhe në organizimin dhe planifikimin e jetës sociale në komunitetin ku jetojnë. Gjatë pesë viteve të fundit, është rritur pjesëmarrja e fëmijëve në ndërgjegjësimin apo në vendimmarrjen në lidhje me çështje që i prekin ata. Grupe fëmijësh dhe anëtarë të qeverive të nxënësve janë paraqitur në zyrat e pushtetit lokal për të shprehur kërkesat dhe shqetësimet e tyre. Vlen për t'u përmendur se këta fëmijë kanë qenë të mbështetur nga vetë pushteti lokal dhe nga OJF të cilat punojnë në kuadër të fuqizimit të rolit që duhet të kenë fëmijët në jetën sociale e politike të vendit.

Masa 1.3. Përfshirja e nxënësve në borde drejtuese /këshilla/ komisione në shkolla të mesme; universitete; bashki; qark; etj.

Përfaqësimi i fëmijëve në organe vendimmarrëse vendore është një çështje shumë e rëndësishme por e pazbatuar ende në praktikë. Strategjia Kombëtare e Rinisë 2007-2013¹⁸, vendos parime të cilat prekin drejtpërdrejtë parimin e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe detyrime ligjore në përcaktimin e pjesëmarrjes së të rinjve në bordet e shkollave dhe të këshillave të bashkisë si dhe të qarkut në jo më pak se 20%. Në disa borde shkollash, presidenti i qeverisë së nxënësve është automatikisht anëtar i bordit të shkollës, pavarësisht se pjesëmarrja nuk do të thotë e drejt e votës. Pjesëmarrja e fëmijëve nëpër këto borde, realizohet në të shumtën e rasteve me kërkesën e drejtorëve apo të drejtuesve më të lartë në nivel lokal, si përmbushje e detyrimit ligjor apo si përmbushje e vetë angazhimeve të ndërmarrja, por shumë rrallë si një kërkesë apo nevojë e vazhdueshme e fëmijëve dhe të rinjve. Ajo që vlen të theksohet, është ndërgjegjësimi edhe i administratës së shkollës, pushtetarëve lokalë e qendrorë për rëndësinë e përfshirjes së fëmijëve në këto borde apo grupe këshillimore.

¹⁸ VKM Nr. 782 Datë 16 Nëntor 2006 “Per miratimin e Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2007-2013”.

Objektivi 2: Rritja e pjesëmarrjes aktive të fëmijëve në procesin e monitorimit të strategjisë dhe të raportimit

Grupi i fëmijëve "Zëri 16+" i 3 rajoneve: Peshkopi, Durrës dhe Elbasan kanë bërë një raport monitorimi të zbatimit të politikave rajonale, ku grupi i fëmijëve ka ngritur shqetësimin në lidhje me disa çështje të buxhetimit, si në rajonin e Elbasanit.

Po këta fëmijë kanë marrë pjesë edhe në hartimin e raportit alternativ të zbatimit të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

Masa 2.1 Fëmijët/të rinjtë njihen si pjesë e monitorimit të zbatimit të strategjive dhe politikave rinore në nivel vendor dhe kombëtar

Vitet e fundit po njihet roli që duhet të kenë fëmijët si monitorues të strategjive dhe politikave të hartuara për ata vetë, krahas përfshirjes së tyre për hartimin e këtyre politikave. Pikëpamja e tyre si përfitues direkt të këtyre politikave është shumë e rëndësishme dhe objektive dhe një vlerësues shumë i mirë i mënyrës se si po zbatohen këto politika. Qeveria e Nxënësve dhe Parlamenti Rinor, si organizata kombëtare të fëmijëve,

kanë luajtur një rol të rëndësishëm në këtë pikë. Vihet re që është rritur roli dhe interesi i fëmijëve në mënyrën e shpenzimit të buxhetit për ata vetë, nëpërmjet takimeve me pushtetarë lokalë apo edhe qendrorë, pavarësisht se raste të tilla nuk janë të shumta.

Procesi i monitorimit realizohet edhe nëpër shkolla për mënyrën se si shpenzohet buxheti i akorduar për shkollat dhe nga fondi i kontributit, gjë që dëshmon për një rritje të ndërgjegjësimit dhe interesit në këtë fushë. Ky proces monitorimi dhe bashkëpunimi realizohet me ndihmën e OJF-ve që punojnë për rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje dhe që i angazhojnë ata vazhdimisht në veprimtari që synojnë forcimin e rolit të fëmijëve.

Pikëpamja e fëmijëve është shumë e rëndësishme dhe në shumë vlerësime të kryera, janë përfshirë edhe fëmijët si përfituesit direkt të ndërhyrjeve të planifikuara për ta. Grupe fëmijësh kanë marrë pjesë në përgatitjen e Raportit Alternativ, të hartuar nga Aleanca e Fëmijëve, duke i dhënë një tjetër dimension raportimit të zbatimit të të drejtave të tyre, e parë në këndvështrimin dhe sinqeritetin e fëmijëve.

Masa 2.2 Hartimi i buxhetit për arsimin dhe rininë në nivel prefekturë dhe në nivel qendror.

Hartimi i buxhetit për arsimin dhe rininë, konsiderohet si pjesa më e rëndësishme e zbatimit të politikave për fëmijët dhe të rinjtë. Hartimi i buxhetit gjatë këtyre viteve duhet parë në dy këndvështrime: së pari në drejtim të ndarjes së buxhetit apo planifikimit të buxhetit për fëmijët dhe të rinjtë apo edukimin; dhe së dyti në drejtim të rritjes së pjesëmarrjes së fëmijëve në hartimin e këtyre buxheteve. Në drejtim të ndarjes së buxhetit sipas programeve, buxhetet për fëmijët janë të ndara në dy ose tre programe të

ndryshme (si: programi i edukimit, programe sociale, etj), duke bërë të pamundur përcaktimin e qartë të buxhetit total për fëmijët. Fëmijët janë pjesë e buxheteve të tjera dhe nuk konsiderohen të ndarë që në fillim të planifikimit të buxhetit.

Fëmijët "Zëri 16 +" në Durrës shprehen të kënaqur me tre këndet e lojërave të ngritura për ta me si dhe investimet e kryera lidhur me rikonstrukcione shkollash apo kopshtesh, pasi kjo ishte rezultat i një kërkesë të vazhdueshme të tyre.

Përsa i përket pjesëmarrjes së fëmijëve në buxhetim, ajo realizohet në mënyrë indirekte nëpërmjet pjesëmarrjes së OJF-ve ose mbledhjes së nevojave nga shkollat apo komunitetet. Mbetet sfida

mënyra e përfshirjes së fëmijëve në hartimin e buxhetit, megjithëse rastet pozitive dhe nxitëse nuk mungojnë.

5.2 Gjetjet e studimit

Në shumë aspekte të intervistuarit kanë një perceptim pozitiv për mënyrën se si ka ndryshuar pjesëmarrja e fëmijëve në veprimtarinë e përditshme në shkollë por edhe në komunitet.

Kuadri ligjor i cili mbështet pjesëmarrjen e fëmijëve në veprimtarinë e shkollës dhe në procesin e vendimmarrjes është i plotësuar dhe demokratik.

Fëmijët janë ndërgjegjësuar më shumë për të drejtat që kanë dhe për mënyrën e përdorimit të tyre, duke treguar fuqinë që mund të kenë për të ndryshuar gjërat. Veprime të ndryshme të fëmijëve në qytete të ndryshme tregojnë për një rol aktiv që kanë ndërmarrë fëmijët në përmirësimin e jetës së tyre në shkollë.

Strukturat e ngritura nga fëmijët dhe të përbëra prej tyre, nuk janë shumë funksionale dhe nuk përbëjnë një strukturë efikase ku fëmijët të kenë besim të shprehin problemet e tyre.

Procesi i ankimimit për probleme të ndryshme nuk ndiqet nga stafi i shkollës ose keqpërdoret duke bërë të mundur rritjen e mosbesimit të efikasiteti i strukturave dhe procedurave të krijuara siç është "Kutia e Mendimit" e cila me vendim të MASH duhet të jetë e pranishme në çdo shkollë.

Organizatat jofitimprurëse, në bashkëpunim dhe me mbështetjen e shkollave, luajnë një rol shumë aktiv në forcimin e qeverive të nxënësve por edhe në rritjen e pjesëmarrjes së nxënësve të tjerë në veprimtarinë e shkollës dhe komunitetit.

Ka një rritje të dialogut ndërmjet fëmijëve dhe strukturave të qeverisë lokale kryesisht në lidhje me kërkesat dhe shqetësimet e tyre, por edhe me monitorimin e punëve të Bashkisë, të përkrahur dhe drejtuar nga organizata që punojnë për fëmijët.

Procesi i monitorimit realizohet edhe nëpër shkolla për mënyrën se si shpenzohet buxheti i akorduar për shkollat dhe nga fondi i kontributit, gjë që dëshmon për një rritje të ndërgjegjësimit dhe interesit në këtë fushë.

Fëmijët janë bërë shpesh pjesë e vlerësimeve dhe studimeve të kryera në lidhje me zbatimin e të drejtave të tyre, ku ata kanë shprehur mendimin dhe këndvështrimin e tyre.

Organizatat Jo Fitimprurëse që punojnë në shkolla dhe me fëmijët në përgjithësi kanë më shumë njohuri për SKF dhe planin e saj të veprimit, sesa përfaqësuesit e shkollave apo edhe vetë fëmijët. Këta të fundit në pjesën më të madhe të rasteve, i referohen pjesëmarrjes si një përmbushje të një detyrimi ligjor, i cili konsiston në formimin e qeverive të nxënësve dhe në angazhimin e fëmijëve në veprimtari të shkollës dhe në veprimtari ndërgjegjësuese, sesa si një objektiv të rëndësishëm në përmbushjen e detyrimeve të tyre si qytetarë aktivë e me të drejta.

5.3 Rekomandime

Qeveria e nxënësve, si organ legjitim i fjalës dhe organizimit të nxënësve brenda shkollës, të ketë pavarësi dhe status të veçantë nga drejtoria e shkollës. Në këtë kuadër, të rishikohen dispozitat normative, për ti dhënë më shumë pavarësi qeverive të nxënësve.

Pranë strukturave lokale në drejtoritë arsimore, duhet të ketë individë, të cilët janë përgjegjës për ecurinë e qeverive të nxënësve dhe ankesat e tyre, duke siguruar një proces të paanshëm dhe sa më demokratik.

Të organizohen më shumë veprimtari ndërgjegjësuese për të drejtat e fëmijëve jo vetëm brenda shkollës por edhe në komunitet, me iniciativën e vetë qeverive të nxënësve dhe të mbështeten këto iniciativa edhe në pikëpamjen financiare.

Të organizohen aktivitete me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira ndërmjet shkollave të ndryshme për sa i përket funksionimit të qeverive të nxënësve dhe pjesëmarrjes së tyre në jetën e komunitetit.

Të mbështeten financiarisht me fonde të buxhetit të shtetit, veprimtaria e qeverive të nxënësve në ato shkolla ku mungon kjo mbështetje. Fondet të përdoren për krijimin e gazetës, për realizimin e fletëpalosjeve apo aktiviteteve të tjera ndërgjegjësuese.

Strukturat e qeverisë lokale, duhet të kenë në përbërjen e tyre borde këshillimore të përbërë nga fëmijë, apo nga presidentët e qeverive të nxënësve të shkollave, si një detyrim moral dhe në zbatim të Konventës së Fëmijëve dhe kuadrit ligjor në Shqipëri për fëmijët, si dhe të krijohen kushtet për pjesëmarrje aktive të fëmijëve.

Të shtrihet veprimtaria e qeverisë së nxënësve edhe në komunitet, duke bërë të mundur sjelljen në vëmendje të problemeve që kanë fëmijët në komunitet. Në këtë kuadër të krijohen Senatet e Fëmijëve në nivel lokal, të cilat të kenë përfaqësitë e tyre pranë

strukturave të qeverive lokale të fshatit apo qytetit ku banojnë. Senati i Fëmijëve të jetë një strukturë e bazuar në zgjedhje të lira e demokratike dhe të funksionojë mbi bazën e qeverive të nxënësve.

Të njihet Strategjia Kombëtare për Fëmijët nga ana e fëmijëve dhe e stafit nëpër shkolla, duke e konsideruar atë si një udhërrëfyes në punën e tyre me nxënësit dhe për vetë nxënësit.

Të publikohen versione të thjeshtëzuara të SKF-së dhe në formate të manovrueshme për të lehtësuar procesin e njohjes së fëmijëve, mësuesve e prindërve me këtë dokument të rëndësishëm.

Të rritet efektiviteti i qeverisë së nxënësve në shkolla.

Të përfshihen më shumë fëmijët në hartim politikash dhe vendimmarrje për ta, nëpërmjet strukturave të tyre përfaqësuese.

VLERËSIME PËRFUNDIMTARE

Strategjia Kombëtare për Fëmijë dhe Plani i saj i Veprimit të miratuara nga Qeveria në vitin 2005, parashikojnë masat përkatëse për realizimin e të drejtave të fëmijëve, për periudhën 2005-2010. Gjatë pesë vjetëve të zbatimit të strategjisë, ndryshime të thella kanë ndodhur në mënyrën e perceptimit të të drejtave të fëmijëve, si nga qeveria ashtu edhe nga shoqëria. Përgjegjësitë e institucioneve, familjes dhe komuniteteve në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve janë rritur. Vlerësimi i ndërmarrë, gjetjet e të cilit paraqiten në këtë raport, dëshmon progresin gradual drejt realizimit të të drejtave të të gjithë fëmijëve në Shqipëri. Megjithatë, vlerësimi sjell informacion mbi çështje të cilat duhet të analizohen me përgjegjësi nga hartuesit e politikave që ndikojnë në realizimin e të drejtave të fëmijëve.

Shumica e të intervistuarve (81%) vlerësojnë se shoqëria civile ka qenë pak e përfshirë në hartimin, zbatimin apo monitorimin e strategjisë. Vetëm 28% e të intervistuarve mendon se pushteti vendor ka qenë i përfshirë në hartimin e strategjisë dhe se strategjia i përgjigjet nevojave lokale. Ndonëse strategjia ndikon në ndërgjegjësimin e komuniteteve, të intervistuarit mendojnë se komunitetet kanë luajtur rol të kufizuar ose nuk kanë qenë fare të përfshirë në zbatimin e strategjisë (72%). Si e tillë, strategjia është larg sigurimit të ndihmesës konkrete për zgjidhjen e të gjitha çështjeve kritike të fëmijëve (91%).

Të intervistuarit konsiderojnë si veçanërisht të rëndësishëm bashkëpunimin dhe koordinimin e të gjithë grupeve të interesit në nivel rajonal. Megjithatë, thuajse të gjithë theksojnë se mungesa e mbështetjes financiare si edhe problemet e decentralizimit vështirësojnë ndërmarrjen dhe realizimin e inisiativave të udhëhequra nga qeverisja vendore. Pjesëmarrësit vlerësojnë gjithashtu rolin e qarkut si strukturë koordinuese dhe monitoruese, por që duhet të ketë më shumë kompetenca ligjore.

Çështjes se sa ndikon strategjia në realizimin e të drejtave të veçanta, të intervistuarit iu përgjigjën në mënyra të ndryshme: të gjithë (100%) mendojnë se strategjia ndikon shumë pak ose aspak në realizimin e të drejtës për mbrojtje nga varfëria dhe përjashtimi social, vetëm 5% mendojnë se strategjia ndihmon në realizimin e të drejtës për mbrojtje shoqërore të fëmijëve; 26 % mendojnë se strategjia ndihmon në realizimin e të drejtës për kujdes shëndetësor dhe përmirësim të treguesve të shëndetit, ndërsa 84% mendojnë se strategjia ndikon në realizimin e të drejtës për arsim.

Këto rezultate, me gjithë kufizimet e vlerësimit (vetëm 5 nga 12 qarqet ishin objekt i vlerësimit) shtrojnë për diskutim disa çështje të rëndësishme për të ardhmen e zhvillimit të politikave të realizimit të të drejtave të fëmijëve. Përgatitja e Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2011–2016 duhet të marrë në konsideratë disa nga drejtimet që vijojnë:

1. Varfëria dhe përjashtimi social i fëmijëve duhet të jenë objekt i analizës dhe vendimmarrjes në strategjinë pasuese dhe planin saj të veprimit.

2. Strukturat e pushtetit vendor, veçanërisht qarku duhet të jenë të përfshira në procesin e hartimit, zbatimit dhe monitorimit. Përgjegjësitë e tyre si edhe mënyrat e raportimit duhet të përcaktohen në strategji.
3. Buxhetimi i politikave që realizojnë të drejtat e fëmijëve duhet të konsiderohet me prioritet si nga qeveria qendrore ashtu edhe nga qeveritë vendore. Veçanërisht domethënës dhe i rëndësishëm duhet të konsiderohet roli i qarkut, si strukturë koordinuese dhe monitoruese.
4. Shoqëria civile duhet të jetë pjesë aktive jo vetëm gjatë procesit të hartimit, por kryesisht gjatë procesit të zbatimit dhe monitorimit. Fëmijët gjithashtu duhet të jenë të përfshirë në përgatitjen dhe në zbatimin e strategjisë.
5. Institucionet në nivel qarku duhet të forcohen, veçanërisht në kuadrin e kompetencave të rritura në fushën e politikës sociale. Gjithashtu duhet të forcohet sistemi i mbledhjes, analizës dhe raportimi i të dhënave në nivel vendor dhe rajonal.
6. Politikat sektoriale të arsimit, kujdesit shëndetsor dhe mbrojtjes shoqërore duhet të koordinohen në nivel vendor nëpërmjet rritjes të përgjegjësive së qarkut.

KONKLUZIONE

Politikat sociale në fushën e të drejtave të fëmijëve, shpesh u adresohen problemeve më akute të krijuara nga mungesa e hapësirave ligjore. Këto ndryshime janë të domosdoshme dhe plotësojnë kuadrin ligjor për fëmijët. Ky kuadër në Shqipëri përfshin një kornizë ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare. Është e dëshirueshme që këto politika dhe inisiativa legislative të plotësohen dhe të kenë një karakter afatgjatë parashikues. Vlen të theksohet që përfshirja e fëmijëve në klauzola të ligjeve ose akteve nënligjore të tjera të veçanta është një tregues për “mainstreaming” e të drejtave të fëmijëve në legjislacionin kombëtar. Ligje dhe politika sociale që u adresohen posaçërisht fëmijëve karakterizohen nga parimet bazë të KDF dhe sidomos nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës.

Në politikat sociale ka zhvillime pozitive si p.sh baza ligjore për shërbimet alternative dhe dokumentet përkatëse. Dokumenti Strategjik i Kujdestarisë dhe dokumenti plotësues “Strategjia kombëtare për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, viktima të trafikimit” janë shembuj të një politike me karakter parashikues progresiv. Politikat në fushën sociale duhen konsideruar në vazhden e procesit të decentralizimit, impakti i të cilave në veçanti në fushën e shërbimeve sociale duhet ekzaminuar rast pas rasti për të parë influencën e tyre.

Institucionalizimi dhe infrastruktura në funksion të tij janë tërësisht të nevojshme në implementimin e politikave sociale për fëmijët, si në rastet kur kërkohen institucione të posaçme, ashtu dhe kur dispozitat për ta përfshihen brenda institucioneve të tjera dhe ku duhet të garantohet qëndrueshmëria institucioneve dhe evoluimi i tyre sipas nevojave të fëmijëve. Kjo jo vetëm në insitucionalizimin ligjor dhe financimin e institucioneve por edhe në bashkërendimin e punës, pavarësisht nga niveli qendror, rajonal apo vendor. Njëkohësisht formalizimi i statusit të strukturave të ngritura për fëmijët siç janë Njësitë për të Drejtat e Fëmijëve dhe Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe përfshirja e tyre në një sistem i cili do të garantojë evitimin e fragmerntarizimit është tregues qëndrueshmërie. Mekanizmat e referimit dhe të mbrojtjes duhet të trajtohen si pjesë e pandarë e implementimit të politikave. Kjo do të bëjë të mundur standartizimin e aktivitetit të tyre dhe do të ndikonte në njësimin e procedurave dhe protokolleve që ndiqen në veprimtarinë e tyre. Në të ardhmen detajimi nga ana ligjore e përgjegjësive do të jetë një ndihmë e vlefshme në angazhimin për këto përgjegjësi. Gjithashtu, varësia e përshtatshme dhe ndarja e kompetencave në përputhje me kapacitetet duhet të jetë në qendër të vëmendjes.

Në një vështrim të Strategjisë Kombëtare për Fëmijë dhe Planit të Veprimit elementë të tjerë janë përfshirja e e fëmijëve në studime statistikore dhe akumulim të dhënash. Në

këtë kuadër varfëria në përgjithësi dhe indikatorët e saj duhet të ekzaminohen në lidhje me fëmijët:

- Në kuadrin e të drejtës shëndetësore me të zgjeruar duke përfshirë dhe nevojat dietologjike, çrregullimet në ngrënie, promovimin e edukimit seksual;
- E drejta e mjedisit duhet të jetë e artikuluar në strategji;
- Lidhur me arsimin, diversiteti i potencialit të fëmijët dhe vështirësitë në mësim (learning disabilities) duhen konsideruar si për grupet e fëmijëve me AK po ashtu dhe për fëmijët që vijnë nga grupe të prekshme si Romët;
- Për keqtrajtimin e fëmijëve duhet që një autoritet kombëtar të sigurojë dhe ekzaminojë të dhënat dhe të ketë karakter politikëbërës;
- Evitimi i viktimizimit të fëmijëve në media;
- E drejta për siguri, semaforët dhe sinjalistika për shkollat;
- Për riatdhesimin e fëmijëve shqiptarë duhet një perspektivë e re në Strategji;
- Në tërësi, perspektiva e strategjisë duhet të ketë karakter pjesëmarrës dhe të dëgjohet zëri i fëmijëve nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në formulim si dhe të garantohet pjesëmarrja aktive në gjithë procesin e formulimit.

SHTOJCA 1

Profili i të intervistuarve

I. Shoqëria civile

Nr.	Rajoni/Qyteti	OJF/Pozicioni
1.	Tiranë	Fondacioni Terre des Hommes
2.	Elbasan	Mësuese dhe koordinatore e grupit të fëmijëve 16+
3.	Shkodër	Observatori për Fëmijët
4.	Durrës	Parlamenti Rinor
5.	Kukës	Kopshti nr. 1
6.	Durrës	Observatori për Fëmijët
7.	Shkodër	World Vision
8.	Elbasan	Mjeke Familjeje
9.	Elbasan	Nxënëse anëtare e "Grupit 16+"
10.	Elbasan	Nxënëse anëtare e "Grupit 16+"
11.	Durrës	Aleanca për Fëmijët

II. Punonjësit të administratës publike

Nr.	Rajoni/Qyteti	Institucioni/Pozicioni
1.	Elbasan	Drejtoria Arsimore Elbasan
2.	Tiranë	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
3.	Tiranë	Shërbimi Social Shtetëror
4.	Shkodër	Drejtoria Arsimore
5.	Tiranë	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
6.	Durrës	Drejtoria Arsimore
7.	Shkodër	Shërbimi epidemiologjik
8.	Durrës	Drejtoria e Shëndetit Publik
9.	Durrës	Drejtoria e Shëndetit Publik
10.	Tiranë	Instituti i Shëndetit Publik
11.	Durrës	Drejtoria e Shëndetit Publik
12.	Durrës	Drejtoria e Shëndetit Publik
13.	Durrës	Bashkia Durrës
14.	Durrës	Shërbimi Social Shtetëror
15.	Kukës	Shërbimi Social Shtetëror
16.	Tiranë	Ministria e Shëndetësisë

17.	Tiranë	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
18.	Durrës	Drejtorja e Shëndetit Publik
19.	Kukës	Shërbimi Social Shtetëror
20.	Durrës	Drejtorja e Shëndetit Publik
21.	Durrës	Drejtorja e Shëndetit Publik
22.	Durrës	Drejtorja e Shëndetit Publik
23.	Durrës	Drejtorja e Shëndetit Publik

SHTOJCA 2

Pyetësor për shoqërinë civile

Vlerësimi i ndikimit të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët dhe Planit Kombëtar të Veprimit për realizimin e të drejtave të fëmijëve.

Nëpërmjet këtij pyetësori synohet të mblidhet informacion cilësor i cili do të përdoret për të analizuar realizimin e Strategjisë Kombëtare për Fëmijët dhe Planit të Veprimit në nivel kombëtar dhe rajonal për periudhën 2006-2009, për të reflektuar mbi çështjet kritike të identifikura me qëllim përcaktimin e drejtimeve strategjike në lidhje me hartimin e politikave të të drejtave të fëmijëve në të ardhmen.

Informacion i përgjithshëm:

Rajoni/Qyteti:

Data:

Nr.i pjesmarrësve:

Informacion cilësor:

- Cili ka qënë angazhimi dhe përfshirja juaj në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Fëmijët dhe Planit të Veprimit në nivel kombëtar dhe rajonal për periudhën 2006-2009?
- Çfarë lloj shërbimesh keni realizuar në funksion të SKF/PKV?
- Në çfarë mase shërbimet që ju ofroni reflektojnë nevojat lokale?
- Mjetet dhe shkalla e përfshirjes së komunitetit në aktivitetet apo shërbimet që realizoni?
- A mendoni se Strategjia Kombëtare për Fëmijët dhe Plani i Veprimit mbulojnë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve?
- Cili është raporti që keni me autoritetet lokale, institucionet publike, vendimmarrësit dhe me aktorët e tjerë që merren me problematikën e të drejtave të fëmijëve?

- A keni marrë pjesë në hartimin e drafteve apo amendamenteve ligjore të cilat kanë në fokus të drejtat e fëmijëve?
- A ka çështje kritike të evidentuara nga ju në lidhje me realizimin e planit të veprimit në nivel rajonal?
- A keni marrë mbështetje financiare nga institucionet publike në lidhje me projektet për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Fëmijët?
- Cilat janë sugjerimet tuaja për drejtimet strategjike në të ardhmen?

Ju faleminderit!

Pyetësor për punonjësit lokal të administratës publike

Vlerësimi i ndikimit të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët dhe Planit Kombëtar të Veprimit për realizimin e të drejtave të fëmijëve.

Nëpërmjet këtij pyetësori synohet të mblidhet informacion cilësor i cili do të përdoret për të analizuar realizimin e Strategjisë Kombëtare për Fëmijët dhe Planit të Veprimit në nivel kombëtar dhe rajonal për periudhën 2006-2009, për të reflektuar mbi çështjet kritike të identifikura me qëllim përcaktimin e drejtimeve strategjike në lidhje me hartimin e politikave të të drejtave të fëmijëve në të ardhmen.

Informacion i përgjithshëm:

Rajoni/Qyteti:

Data:

Nr. i pjesmarrësve:

Informacion cilësor:

Seksioni 1: Ndikimi i strategjisë në lidhje me realizimin e të drejtës për mbrojtjen shoqërore

1.1 Ngritja e një rrjeti të qëndrueshëm për shërbimet komunitare për fëmijët.

- Në çfarë niveli mendoni se shërbimet e ngritura dhe të administruara nga njësitë vendore në fushën e mbrojtjes sociale për periudhën 2006-2009 në kuadër të decentralizimit të shërbimeve sociale, plotësojnë nevojat për to?
- Çfarë lloj shërbimesh komunitare janë mbështetur në rajonin tuaj nga projekti i Bankës Botërore "Për shpërndarjen e shërbimeve sociale", cila është qëndrueshmëria dhe vazhdimësia e tyre?
- Ku konsistojnë sfidat për administrimim dhe vazhdueshmërinë e këtyre shërbimeve?
- Cili është niveli i përhapjes së modelit "shtëpi-familje" dhe sa është shkalla e territorit të mbuluar nga kjo nismë?
- A ka pasur vlerësim të efektshmërisë së këtij modeli, cili ka qënë numri i përfituesve nga ky shërbim, dhe a ka vlerësim në lidhje me numrin e personave që kanë nevojë për këtë lloj shërbimi?

- Ku konsistojnë barrierat e identifikurara për zgjerimin e këtij modeli në përputhje me nevojat për këtë shërbim?
- Cilat janë shërbimet e reja ditore të ngritura bazuar në nevojat e identifikuara apo në planet e përkujdesit komunitar (në rajonet ku ato ekzistojnë)?

1.2 Mbrojtja e fëmijëve nga varfëria dhe përjashtimi shoqëror.

- A mendoni se mekanizmi ekzistues i mbrojtjes shoqërore siguron realizimin e të drejtave të fëmijëve për mbrojtje dhe kujdes?
- A janë vlerësuar nevojat për shërbimin e kujdestarisë për fëmijët në rajonin tuaj?
- Sa është niveli i angazhimit dhe i përgatitjes së pushtetit lokal për zbatimin e shërbimit të kujdestarisë për fëmijët?
- A ka filluar pilotimi i shërbimit të kujdestarisë në rajonin tuaj?
- Në qoftë se po, çfarë është realizuar në lidhje me këtë shërbim deri tani (ngritja e kapaciteteve të strukturave zbatuese, fushata publicitare, zgjedhja e familjeve kujdestare, vlerësimi i fëmijëve, etj.)
- Si e vlerësoni ndikimin e strategjisë në lidhje me përmirësimin e cilësisë së shërbimeve komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara (në lidhje me bërjen e programeve, evidentimin e problemeve, përmirësimin e infrastrukturës, zbatimin e decentralizimit, etj.)?
- Cili është aksesimi i fëmijëve romë në përdorimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse shoqërore?
- Cili ka qënë ndikimi i “njësive për mbrojtjen e fëmijëve” të ngritura në nivel lokal, në lidhje me identifikimin dhe menaxhimin e rasteve, vlerësimin e situatës së fëmijëve në rrezik, koordinimin dhe referimin e rasteve.
- Ku konsistojnë problemet e identifikuara nga këto njësi dhe çfarë sugjeroni për të ardhmen?
- Nga eksperiencia e inspektimeve, ku konsistojnë vështirësitë për zbatimin e standarteve të shërbimeve për fëmijët?
- A ka të dhëna në lidhje me punën e fëmijëve? Cili është numri i rasteve të raportuara në rajonin tuaj? A janë të përcaktuara kategoritë e fëmijëve që janë më të rrezikuara dhe cilat janë këto kategori?
- Cili është efektiviteti i modelit “Sistemi i monitorimit të punës së fëmijëve”. Çfarë është evidentuar në zbatimin e tij, raste konkrete?

- Cilat janë llojet e shërbimeve që aktualisht ofrohen për mbrojtjen e fëmijëve që janë viktime të dhunës?

Seksioni 2: E drejta për kujdes shëndetësor

2.1 Reduktimi i nivelit të vdekshmërisë së fëmijëve nën moshën 5 vjeç në 100,000 lindje të gjalla deri në 2015.

- A mendoni se niveli i reformave të ndërmarra gjatë periudhës 2006-2009 do të ketë ndikim në ndryshimin e treguesve të shëndetit në nivel kombëtar dhe specifikisht në rajonin tuaj?
- Si e vlerësoni cilësinë e shërbimeve për kujdesin e shëndetit të fëmijës në zonat fshatare dhe zonat e varfëra, si dhe çfarë ndryshimesh mund të tregoni gjatë periudhës 2006-2009?
- A mund të thoni se cili duhet të jetë raporti i shpenzimeve për shërbimet parandaluese në krahasim me raportin e shpenzimeve për trajtimin e sëmundjeve?
- Çfarë evidentoni në cilësinë e shërbimeve shëndetësore të ofruara për kujdesin shëndetësor parësor të nënës gjatë periudhës 2006-2009?

2.2 90% e popullsisë e edukuar mbi principet e kujdesit shëndetësor të gojës dhe 90% e grupmoshës 0-6 vjeç që do të përfitojë nga fluorizimi deri në vitin 2015.

- Në çfarë mase niveli i reformave të ndërmarra gjatë periudhës 2006-2009 arrin objektivin e edukimit të fëmijëve dhe të komunitetit me njohuri të kujdesit shëndetësor?
- Cili është mendimi juaj në lidhje me reformat e marra për shërbimin stomatologjik falas të fëmijëve deri në moshën 18 vjeç, dhe si mendoni për ndikimin që do të ketë ky shërbim?
- Si gjykoni për nivelin e infrastrukturës së shërbimeve stomatologjike në rajonin tuaj?

2.3 Sigurimi me vakcina dhe imunizimi me vakcina të detyrueshme për të mbajtur respektivisht nivelet 100% dhe mbi 95 %.

- Cili është niveli i përqindjes së vaksinimit në rajonin tuaj në krahasim me treguesin rajonal të vaksinimit?

2.4 Fëmijët dhe të rinjtë me HIV/SIDA.

- A mund të përshkruani llojet e shërbimeve që ofrohen në lidhje me problematikën e HIV/SIDA në rajonin tuaj (shërbime informuese, parandaluese, trajtim të rastit, shërbime mjeksore, etj...)?
- Cili është niveli i përfshirjes së pushtetit lokal në problematikën e HIV/SIDA në rajonin tuaj?

Seksioni 3: E drejta për arsim cilësor

3.1 Reformimi dhe fuqizimi i kapacitetit menaxhues të sistemit arsimor.

- Cili është ndikimi i reformave arsimore gjatë periudhës 2006-2009 për sigurimin e një sistemi arsimor cilësor dhe gjithëpërfshirës?
- Cili është ndikimi i politikave të sistemit arsimor për grupet të cilët kanë qenë të përjashtuara ose janë në rrezik për të qenë të përjashtuar, në rajonin tuaj?

3.2 Përmirësimi i cilësisë së procesit mësimor.

- Çfarë ndikimi kanë pasur reformat arsimore në përmirësimin e cilësisë së mësim marrjes/dhënies gjatë periudhës 2006-2009?
- Ku mendoni se janë përqëndruar më shumë këto reforma (në infrastrukturën e shkollës, përmirësimin e kurrikulave, aksesin në teknologji, rritjen e nivelit të mësuesve) dhe çfarë sugjeroni për të ardhmen?

Seksioni 4: E drejta e fëmijëve për pjesmarrje

4.1 Rritja e pjesmarrjes së fëmijëve në procesin e vendim-marrjes.

- A janë të mjaftueshme aktet ligjore që i japin të drejtë strukturave të nxënësve të influencojnë në strukturat vendim-marrëse të shkollës?
- Cila ka qenë pjesmarrja e nxënësve në hartimin e politikave lokale në rajonin tuaj?
- A mund të përshkruani shembuj të pjesmarrjes së fëmijëve në monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Fëmijët?
- A mund të jepni shembuj konkrete në lidhje me pjesmarrjen e fëmijëve në procese vendim-marrëse në shkolla?

- Çfarë aktivitete janë realizuar me qëllim rritjen e pjesmarrjes së fëmijëve në jetën shoqërore të rajonit/vendit?
- Cili është mendimi juaj në lidhje me përmirësimin e shërbimit psikologjik në shkollë, si një mjet shtesë në rritjen e procesit të nxënies të nxënësit?

Seksioni 5: E drejta për mbrojtje ligjore

5.1 Rritja e cilësisë së shërbimeve për një birësim sa më të përshtatshëm.

- Cili është roli i strukturave rajonale në ofrimin e shërbimeve cilësore në lidhje me birësimin e fëmijëve, dhe sa do ta influenconin ato në rritjen e cilësisë së këtij shërbimi?

5.2 Rritja e cilësisë dhe llojshmërisë së shërbimeve psiko–sociale për fëmijët në konflikt me ligjin?

- Si e vlerësoni rëndësinë e shtrirjes së shërbimeve psiko–sociale për fëmijët në nivel rajonal dhe si e mendoni ndikimin e këtij shërbimi?

5.3 Lufta kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit.

- A ka iniciativa lokale në lidhje me rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për trafikimin dhe rreziqet e tij?

5.4 Reduktimi i numrit të rasteve që përbëjnë sjellje kriminale dhe rrezikshmëri shoqërore.

- A ekzistojnë në rajonin tuaj shërbime të cilat mbështesin fëmijët të cilët janë dëmtuar nga aktivitetet kriminale apo dhuna në familje?
- Si e vlerësoni rolin që duhet të luajnë strukturat lokale në sigurimin e shërbimeve për kategoritë e mësipërme?

Ju faleminderit !

SHTOJCA 3

3.1 Kuadri ligjor ndërkombëtar

Konventa e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual”, miratuar me Ligjin Nr. 10071, datë 09.02.2009.

Protokolli Opsional i Konventës “Për të drejtat e fëmijës”, “Mbi implikimin e fëmijëve në konfliktet e armatosura”, miratuar me Ligjin Nr. 9833, datë 22.11.2007.

Protokolli Opsional i Konventës “Për të drejtat e fëmijës”, “Mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijët”, miratuar me Ligjin Nr. 9834, datë 22.11.2007.

“Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve, viktimat të trafikimit”, (ratifikuar me Ligjin Nr. 9544, datë 29.05.2006). Kjo marrëveshje ka si qëllim nxitjen e bashkëpunimit për të luftuar trafikimin dhe çdo formë të shfrytëzimit të fëmijëve.

Konventa e Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qënieve njerëzore” miratuar me Ligjin Nr. 9642, datë 20.11.2006.

Konventa e Hagës “Mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve”, miratuar me Ligjin Nr. 9446, datë 24.11.2005.

Konventa e Hagës “Mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, ekzekutimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”, miratuar me Ligjin Nr. 9443, datë 16.11.2005.

Konventa Europiane “Mbi marrëdhëniet me fëmijët”, Ligji Nr. 9359, datë 24.03.2005.

Konventa e Këshillit të Evropës “Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme”, Strasburg 24.11.1983, Ligji Nr.9265, datë 29.07.2004.

Karta Sociale Europiane (e ndryshuar), Ligji Nr. 8960, datë 24.10.2002.

Konventa e Kombeve të Bashkuara, kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe dy protokolle shtesë të saj: Protokolli i Palermos, i vitit 2000 “Për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave veçanërisht të femrave dhe fëmijëve”, në plotësim të konventës së OKB-së dhe “Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar” Ligji Nr. 8920 datë 11.07.2002.

Konventa Nr. 182, “Për Format më të këqija të punës së fëmijëve” dhe Rekomandimi Nr.190, “Format më të këqija të punës së fëmijëve”, Ligji Nr. 8774, datë 23.04.2001.

Konventa e Hagës “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit”, Ligji Nr. 8624, datë 15.06.2000.

Konventa Europiane “Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore”, Ligji Nr. 8137, datë 31.07.1996.

Konventa Nr. 138, “Për moshën minimale për t’u pranuar në punë” e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, Ligji Nr. 8006, datë 13.03.1996.

Konventa Nr. 111, “Për diskriminim në punë dhe profesion” e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, Ligji Nr. 8006, datë 13.03.1996.

Konventa Nr. 105, “Për zhdukjen e punës së detyruar” e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, Ligji Nr. 8006, datë 13.03.1996.

Konventa Ndërkombëtare e OKB-së mbi “Të drejtat e fëmijëve”, e ratifikuar nga Qeveria Shqiptare në shkurt 1992, e cila përcakton detyrimet e shtetit shqiptar në lidhje me respektimin e të drejtave të fëmijëve.

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, 1948, e cila reflekton të drejtat civile, politike, sociale e ekonomike.

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH-së dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, për ripranimin e personave dhe të Protokollit të saj.

3.2 Kuadri ligjor shqiptar

Kushtetuta e Shqipërisë, miratuar me Ligjin Nr. 8417, datë 21.10.1998 dhe shpallur me Dekret Nr. 2260, datë 28.11.1998. Neni 54 i Kushtetutës sanksionon të drejtën e fëmijëve për t’u mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë dhe veçanërisht moshën minimale për punën e fëmijës, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën ose zhvillimin e tij normal.

Dekreti i Presidentit të Republikës Nr. 6218, datë 7.7.2009, “Për krijimin e seksioneve penale për gjykimin e të miturve pranë Gjykatave të rretheve gjyqësore”.

Ligji Nr. 9928, datë 09.06.2008, “Për shërbimin shëndetësor stomatologjik” (botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 102, fq. 4494).

Ligji Nr. 9749, datë 04.06.2007, “Për Policinë e Shtetit” parashikon se nëse cënimi i rendit dhe sigurisë publike ka ardhur si pasojë e veprimeve të një personi të mitur nën 14 vjeç, punonjësi i policisë njofton prindin ose kujdestarin e të miturit nën 14 vjeç për ndërprerjen e veprimeve të paligjshme të të miturit.

Ligji Nr. 9695, datë 19.03.2007, “Për Procedurat e Birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, siguron kushtet e përshtatshme për respektimin e të drejtës së fëmijës për t’u rritur në një mjedis familjar.

Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, sanksionon krijimin e një mekanizmi apo rrjeti institucionesh të koordinuar, përgjegjës për mbrojtjen, mbështetjen, rehabilitimin e viktimave dhe parandalimin e dhunës në familje.

Ligji Nr. 9636, datë 06.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit” parashikon ndalimin e shitjes ose furnizimit për qëllime tregtimi të produkteve të duhanit personave nën moshën 18 vjeç.

Ligji Nr. 9631, datë 30.10.2006, “Për artin skenik” është ngritur Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë.

Ligji Nr. 9518, datë 18.04.2006, “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit” parashikon ndalimin e shitjes ose ofrimit falas të pijeve alkoolike të miturve, apo konsumimin e tyre në vende publike nga të miturit. Ky ligj parashikon ndalimin e përdorimit të pijeve alkoolike në shkollë dhe mjediset shkollore.

Ligji Nr.9398, datë 12.05.2005, “Për disa ndryshime në Ligjin Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

Ligji Nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” (i ndryshuar), siguron trajtimin në mënyrë të barabartë të shtetasve, përfshirë këtu edhe fëmijët, ndaj të cilëve ofrohen shërbimet.

Ligji Nr. 9205, datë 15.03.2004, “Për Mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë” mbron fëmijët në rastet kur ata dëshmojnë kundër autorëve të veprave penale.

Ligji Nr. 9106, datë 17.07.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë” Neni 35 përcakton shërbimet në spitalet publike që duhet të ofrohen në nivel bashkie si dhe shërbimet e pediatriës, pika “ç”.

Ligji Nr. 9098, datë 03.07.2003, “Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfituar azil në RSH-së”, parashikon procedurat për realizimin e të drejtave për arsimimin, punësimin, kujdesin shëndetësor e shoqëror, strehimin dhe bashkimin familjar të personave, që kanë përfituar azil në RSH-së.

Kodi i Familjes, Ligji Nr. 9062, datë 08.05.2003, i kushton kujdes të veçantë trajtimit dhe kujdesit të të miturve dhe detyrimeve të prindërve, ushtrimit të përgjegjësive prindërore për administrimin e pasurive që vijnë nga puna e të miturve, lejimit të punës së të miturve, kujdesit për ta në punë. Kodi përcakton edhe detyrimet institucionale të shtetit ndaj fëmijëve jashtë kujdesit prindëror si edhe mënyrën se si zbatohen ato. Në Kodin e

Punës një kapitull i veçantë i kushtohet mbrojtjes së të miturve, ku trajtohet moshë minimale e punës, punët e lehta dhe të vështira, punët e natës dhe kontrolli mjekësor.

Ligji Nr. 8876, datë 04.04.2002, “Për shëndetin riprodhues”, Neni 22 parashikon se veprimtaria e shërbimeve për kujdesin ndaj shëndetit riprodhues përfshin: a) kujdesin para, gjatë dhe pas lindjes; b) kujdesin për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës 0-6 vjeç; c) kujdesin për shëndetin e adoleshentëve.

Ligji Nr. 8872, datë 29.03.2002, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, nxënësve deri në moshën 18 vjeç u sigurohet e drejta e arsimimit dhe formimit profesional.

Ligji “Për gjendjen civile”, është ligji që rregullon në mënyrë më të plotë dhe të detajuar të drejtën për t’u regjistruar në momentin e lindjes, e drejtë nga e cila burojnë të drejtat e tjera si e drejta për arsim, kujdes shëndetësor, etj.

Ligji Nr. 8528, datë 23.09.1999, “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji”, ka për qëllim mbrojtjen e të drejtës së fëmijës për t’u ushqyer me gji.

Ligji Nr. 8517, datë 22.07.1999, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Ligji Nr. 8503, datë 30.06.1999, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

Ligji Nr. 8492, datë 27.05.1999, “Për të huajt”.

Ligji Nr. 8410, datë 30.09.1998, “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i cili respekton në mënyrë të paanshme, të drejtën për informacion, bindjet politike dhe besimet fetare, personalitetin, dinjitetin, jetën private të individit, si dhe të drejtat dhe liritë themelore të tij, duke përfshirë edhe respektimin në mënyrë të veçantë të të drejtave, interesave dhe kërkesave morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve.

Ligji Nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit” (i ndryshuar), përcakton të drejtat e fëmijëve jashtë kujdesit prindëror si dhe detyrimet e shtetit dhe të shoqërisë për të garantuar realizimin e këtyre të drejtave.

Ligji Nr. 8096, datë 29.04.1996, “Për kinematografinë”, parashikon transmetimin e filmave në mënyrë të diferencuar, sipas moshave të të miturve, si dhe përcakton oraret e shfaqjes se tyre.

Ligji Nr.8045, datë 07.12.1995, “Për ndërprerjen e shtatëzanisë” garanton respektimin e çdo qënieje njerezore, që në fillim të jetës.

Ligji Nr.7986, datë 13.09.1995, “Për Inspektoriatin Shtetëror të Punës” (i ndryshuar), përcakton të drejtën e inspektoriatit për të inspektuar punën e fëmijëve, duke marrë masa efikase në mbrojtjen e të miturve.

Ligji Nr. 7952, datë 21.06.1995, “Për sistemin arsimor parauniversitar” (i ndryshuar).

Ligji Nr. 3766, datë 17.12.1993, “Për Sigurimin Shëndetësor” (i ndryshuar), në Nenin 8, Pika 2, parashikon se shteti kontribuon për personat joaktiv si fëmijët, nxënësit dhe studentët me shkaputje nga puna, të pafatët (mendore dhe fizike si dhe nënat me leje lindjeje).

Ligji Nr.7703, datë 11.05.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, mbi bazën e të cilit fëmijët përfitojnë nga sigurimi i detyrueshëm kur ata janë të punësuar në rastet e pafatësisë së përkohshme në punë, për shkak të sëmundjeve, invaliditetit, humbjen e prindit, aksidentit në punë dhe sëmundjeve profesionale apo të papunësisë.

Vendime të Këshillit të Ministrave

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 80, datë 28.01.2008, “Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale”.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 195, datë 11.04.2007, “Standartet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi në qendrat rezidenciale”.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 659, datë 17.10.2005, “Standartet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijët në institucionet rezidenciale”.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 368, datë 31.05.2005, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Fëmijët”.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 538, datë 12.08.2004, për “Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2004 – 2015”.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 383, datë 19.06.2004, për “Miratimin e procedurave, tarifave dhe masën e mbulimit të shërbimeve ekzaminuese unikalë, terciare të përfshira në sigurimin shëndetësor”.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 633, datë 18.09.2003, “Strategjia Kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom”.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 419, datë 19.06.2003, “Për trajtimin e jetimëve me shërbim shëndetësor dhe me barna”.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 540, datë 31.10.2002, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensat e konvikteve, bursat e shtetit dhe pagesat e familjeve të nxënësve, studentëve, fëmijëve që pranohen në shtëpitë e fëmijës, në Institutin e fëmijëve që nuk

dëgjojnë, në Institutin e fëmijëve që nuk shikojnë dhe në Institutin e fëmijëve me prapambetje të lehtë mendore”.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 325, datë 23.06.2000, “Për krijimin e Qendrës Kombëtare për Mirëritjen, Zhvillimin dhe Rehabilitimin e Fëmijëve”, si njësi buxhetore e veçantë.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 248, datë 28.05.1999, i cili parashikon paraqitjen e një deklarate nga institucionet arsimore jopublike, me anë të së cilës marrin përsipër të respektojnë Konventen “Për të drejtat e fëmijëve” (CRC).

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 502, datë 05.08.1996, “Për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 396, datë 22.08.1994, “Për Arsimin 8-Vjeçar në Gjuhën Amtare të Personave të Pakicave”, synon në funksionimin e njësisive të shkollimit në gjuhën amtare pranë shkollave tetëvjeçare mbi bazën e kërkesave duke respektuar, kriteret përkatëse.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 384, datë 20.05.1996, “Për mbrojtjen e të miturve në punë”.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.396, datë 22.08.1994, “Për Arsimin 8-Vjeçar në Gjuhën Amtare të Personave të Pakicave”. Ky vendim ka si qëllim të konkretizojë në sferën arsimore politikën shtetërore për të krijuar kushtet e duhura për shprehjen, ruajtjen e zhvillimin e identitetit kulturor e gjuhësor të personave që iu përkasin pakicave si dhe nevojën e integritit të tyre në shoqërinë shqiptare.

Urdhër i Ministrit të Drejtësisë Nr. 4763, datë 08.06.2009, “Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Komitetit Shqiptar të Birësimeve”.

Udhëzim i MASH Nr.18, datë 21.04.2008, “Për funksionimin e Shërbimit Psikologjik Shkollor në arsimin parauniversitar”.

Udhëzim i MPÇSSHB Nr. 830, datë 14.4.2008, “Për zbatimin e standarteve të përkujdesit shoqëror për fëmijët në institucionet publike dhe jopublike”.

Qarkore e MASH Nr. 8373, datë 26.11.2006, për “Marrjen e masave për përmirësimin e punës edukative në shkollë dhe parandalimin e dhunës”.

Urdhër i Kryeministrit Nr. 139, datë 19.06.2006, “Për krijimin e Komiteteve Rajonale kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore”, përcakton se këto Komitete do të kontribuojnë në evidentimin e rasteve, parandalimin dhe zvogëlimin e numrit të trafikimit.

Urdhër i Ministrit të Shëndetësisë Nr. 115, datë 29.03.2006, “Karta e të drejtave të fëmijëve të shtruar në spital”.

Urdhër i Kryeministrit Nr. 203, datë 19.12.2005, “Për ngritjen e Njesisë Antitrafik pranë Koordinatorës Kombëtare për Antitrafikimin”, përcakton se Njësia Antitrafik harton masat dhe udhëzimet konkrete në organizmin dhe funksionimin efektiv të luftës kundër trafikimit.

Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, Miratuar nga Këshilli Kombëtar i Etikës dhe Deontologjisë, me Vendim të Këshillit të UMSH datë 29.03.2002.

Dispozitat Normative për Arsimin Parauniversitar Publik, MASH, 2002.

Rregullore e kujdesit shëndetësor në institucionet fëmimore, 1998.